

# Mekanizmat e referimit për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm

*Kapërcimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut*

Udhëzues për Evropën Juglindore



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë

Publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Vjenë, prill 2019

© OSCE 2019

Pamja dhe dizajni nga designMind, Marianne Michalakis.

Shtypur nga redhot 'n' cool

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij udhëzuesi nuk mund të riprodhohet, nuk mund të ruhet në asnjë sistem rikthimi dhe as të transmetohet në asnjë formë dhe në asnjë mënyrë - elektronike, mekanike, përmes fotokopjimit, regjistrimit apo formave të tjera - pa miratimin paraprak me shkrim të botuesve. Ky kufizim nuk vlen për prodhimin e kopjeve dixhitale ose të shtypura të këtij udhëzuesi për përdorim të brendshëm të OSBE-së dhe për përdorim personal ose edukativ, kur kjo bëhet për qëllime jofitimprurëse dhe jotregtare, me kusht që në kopje të shënohet se burim i tij është OSBE-ja .

ISBN 978-3-903128-33-0

Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale

Sekretariati i OSBE-së

Wallnerstrasse 6, A-1010 Vjenë, Austri

[www.osce.org/atu](http://www.osce.org/atu)

Botimi i këtij udhëzuesi u mundësua falë kontributit bujar të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Përmbajtja e tij, duke përfshirë pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit. Ky nuk është një dokument që ka për bazë konsensusin e 57shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Sekretariati i OSBE-së nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për saktësinë apo plotësinë e çfarëdo informacioni, për udhëzimet apo këshillat e ofruara, dhe as për gabimet e shtypit. Sekretariati i OSBE-së nuk mund të mbajë përgjegjësi për asnjë humbje apo dëm që mund të shkaktohet nga përdorimi i informacionit që gjendet në këtë publikim dhe as për përmbajtjen nga burimet e jashtme, duke përfshirë edhe faqet e jashtme të internetit, të cilave u referohet ky udhëzues.

 Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë

 U.S. Mission to the OSCE

---

## **Çfarë janë mekanizmat e referimit** për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm

*Kapërcimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut*

Udhëzues për Evropën Juglindore

---



# Përmbajtja

FALENDERIME	5
AKRONIMET DHE SHKURTESAT	6
FJALORTH	7
PARATHËNIE	10
PËRMBLEDHJE E SHKURTËR	12
<b>1. HYRJE</b>	<b>17</b>
<b>2. KONCEPTET KRYESORE: EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI QË ÇON NË TERRORIZËM DHE PARANDALIMI/ KUNDËRVËNIA NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT QË ÇON NË TERRORIZËM</b>	<b>23</b>
<b>3. PYETJET KRYESORE NË LIDHJE ME MEKANIZMAT E REFERIMIT PËR PARANDALIMIN/KUNDËRVËNIEN NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT QË ÇON NË TERRORIZËM</b>	<b>31</b>
<b>4. SFIDAT DHE PASOJAT E MUNDSHME NEGATIVE</b>	<b>45</b>
<b>5. ÇFARË DUHET MARRË PARASYSH GJATË NGRITJES SË MEKANIZMAVE TË REFERIMIT</b>	<b>59</b>
<b>6. ELEMENTËT KRYESORE TË PROCESIT TË MEKANIZMIT TË REFERIMIT</b>	<b>77</b>
<b>7. KONTEKSTI I EVROPËS JUGLINDORE</b>	<b>97</b>
<b>8. PËRFUNDIM</b>	<b>105</b>
SHTOJCË: SHEMBUJ PRAKTIKASH TË NDRYSHME	108
BIBLIOGRAFIA	116



## Falënderime

Njësia për Veprim Kundër Terrorizmit (NjVKT) e Departamentit të Kërcënimeve Transnacionale (DKTN) e OSBE-së dëshiron të falënderojë Erik Rosand, Drejtor i Projektit të Parandalimit dhe Kryetar i “PVE Solutions”, për rolin e tij në zhvillimin dhe hartimin e këtij udhëzuesi. Ky udhëzues dhe aktivitetet e lidhura me të janë projektuar, zhvilluar dhe zbatuar nga NjVKT/DKTN-ja nën drejtimin e Georgia Holmer, Këshilltare e Lartë për Çështjet kundër Terrorizmit dhe Agnieszka Hejduk, Ndihmëse Zyrtare e Programit.

NjVKT-ja u është po ashtu mirënjohëse për bashkëpunimin dhe komentet e ofruara Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Misionit në Bosnjë-Hercegovinë, Misionit në Kosovë, Misionit në Malin e Zi, Misionit në Serbi, Misionit në Shkup, Zyrës për Demokratizimin dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe subjekteve dhe institucioneve të tjera të OSBE-së që ofruan kontribute me rëndësi shumë të madhe. NjVKT-ja falënderon, gjithashtu, edhe Nigel Quinney për mbështetjen e tij në procesin e redaktimit.

NjVKT-ja u shpreh mirënjohje personave të mëposhtëm për ekspertizën teknike dhe sugjerimet e ofruara gjatë fazave të hulumtimit dhe rishikimit profesional të projektit:

### **Maartje BUTER**

“Safety House”, Hagë, Holandë

### **Garth DAVIES**

Universiteti “Simon Fraser”,  
Kolumbia Britanike, Kanada

### **John McCOY**

Organizata për Parandalimin e  
Dhunës, Alberta, Kanada

### **Khadije NASSER**

Instituti për Dialog Strategjik,  
Rrjeti i Qyteteve të Forta, Liban

### **D. Elaine PRESSMAN**

Instituti i Holandës për Psikiatrinë  
dhe Psikologjinë Ligjore dhe  
Universiteti “Carleton”, Otavë, Kanada

### **Werner PRINZJAKOWITSCH**

Rrjeti i Vetëdijësimit për  
Radikalizimin, Vjenë, Austri

### **Simon SMITH**

Programi PREVENT (PARANDALO),  
Komuna “Tower Hamlets” e Londrës,  
Mbretëria e Bashkuar

### **Sara THOMPSON**

Departamenti i Kriminologjisë,  
Universiteti “Ryerson”,  
Ontario, Kanada

### **Casey TISCHNER**

“RTI International”,  
Karolina e Veriut, SHBA

### **Stevan WEINE**

Qendra e Shëndetit Global,  
Universiteti “Illinois” në Çikago,  
Illinois, SHBA

### **Ariane WOLF**

Rrjeti për Parandalimin e Dhunës,  
Berlin, Gjermani

# Akronimet dhe shkurtesat

<b>NjVKT</b>	Njësia për Veprim Kundër Terrorizmit
<b>BH</b>	Bosnje-Hercegovina
<b>OShC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>KEDh</b>	Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>KR</b>	Kundërvënia ndaj Radikalizimit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>LHT</b>	Luftëtar i Huaj Terrorist
<b>FGKT</b>	Forumi Global Kundër Terrorizmit
<b>DOK KM</b>	Dokumenti i Këshillit Ministror
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>OJF</b>	Organizatë Jofitimprurëse
<b>MKR</b>	Mekanizëm Kombëtar Referimi
<b>ODIHR</b>	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>VEN KP</b>	Vendim i Këshillit të Përhershëm
<b>P/KEDhRÇT</b>	Parandalimi/Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm
<b>PEDh</b>	Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>RVR</b>	Rrjeti i Vetëdijesimit për Radikalizimin
<b>DKTN</b>	Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale i OSBE-së
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>EDhRÇT</b>	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi që Çon në Terrorizëm



## Fjalorth

Ky fjalorth shërben për të qartësuar shprehjet kryesore të përdorura në këtë udhëzues. Përkufizimet janë vetëm për qëllimet e këtij udhëzuesi dhe jo përkufizime zyrtare të OSBE-së.

**Komunitet** - gratë, burrat, grupet shoqërore dhe institucionet e vendosura në të njëjtën zonë, që ndajnë interesa të përbashkëta.

**Shoqëri civile** - grup i shumëllojshëm aktorësh, komunitetesh joqeveritare dhe shoqatash, formale apo joformale, me një spektër të gjerë rolesh, të cilët angazhohet në jetën publike me qëllim avancimin e vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta.

**Aktorë të shoqërisë civile** - anëtarë të komunitetit (gratë, të rinjtë, drejtuesit fetarë dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit), që mund të kontribuojnë për mirëqenien afatgjatë dhe të efektshme të shoqërisë.

**Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm** - veprimet proaktive dhe jodetyruese që i kundërvihen përpjekjeve të ekstremistëve të dhunshëm për radikalizimin, rekrutimin, mobilizimin e përkrahësve në akte të dhunshme dhe për adresimin e faktorëve specifikë që lehtësojnë dhe mundësojnë rekrutimin e ekstremistëve të dhunshëm.

**Kundërvënia ndaj terrorizmit** - politikat, ligjet dhe strategjitë e hartuara nga autoritetet shtetërore, të zbatuara kryesisht nga organet ligjzbatuese dhe agjencitë e shërbimeve të fshehta informative (të zbulimit), e nganjëherë edhe nga ushtria, të cilat synojnë asgjësimin ose kapjen e terroristëve, parandalimin e kompleteve terroriste dhe shpërbërjen e organizatave të tilla.

**“Luftëtar i huaj terrorist”** - përdoret zakonisht për t’iu referuar individëve që kanë udhëtuar nga vendet e tyre të origjinës në vende të tjera për të marrë pjesë në akte terroriste ose për t’i mbështetur ato, duke përfshirë edhe konfliktet e armatosura, veçanërisht në Irak dhe Siri, siç përkrahëhet në Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2014). Ndjaj këtij termi ka pasur edhe kundërshti për shkak të paqartësisë në interpretim dhe disa çështjeve që lidhen me të drejtat e njeriut.

**Ish-ekstremist i dhunshëm** - individ që është shkëputur nga rruga e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe që mund të luajë rol të dobishëm në ndërgjegjësimin dhe në paraqitjen e kundërnarrativave të besueshme.

**Perspektivë gjinore** - vetëdija dhe qasja ndaj nevojave, përvojave dhe statuseve të ndryshme të grave dhe burrave në bazë të kontekstit shoqëror dhe kulturor.

**Program ndërhyrjeje** - program për grupet e rrezikuara, me qëllim parandalimin e prirjeve radikale që çojnë në terrorizëm. Programet që i përkasin kësaj kategorie mund të përmenden si “rrugë dalje” ose “programe dalje”.

**Program parandalues** - program që adreson qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj EDhRÇT-së dhe kohezionin shoqëror. Këto programe kanë në fokus komunitetet e tjera jo radikale dhe paraqiten në forma të ndryshme.

**Faktor mbrojtës** - karakteristikat ose kushtet pozitive që mund t'i zbusin efektet negative të faktorëve të rrezikut dhe që kultivojnë individë, familje dhe komunitete të shëndetshme, duke rritur sigurinë dhe mirëqenien e personit dhe/ose të komunitetit. Këta faktorë mund të përfshijnë menaxhimin e pritshmërive, rrjetet familjare ose shoqërore pozitive, njohuritë fetare, edukimin drejt tolerancës dhe respektit të ndërsjellë, si dhe kushtet e barabarta të punës.

**Radikalizim që çon në terrorizëm** - proces dinamik, përmes të cilit individ pranon dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme dhe ndoshta legjitime të vepruari. Në fund, por jo detyrimisht, ky proces mund ta çojë individin drejt terrorizmit, apo veprimeve që mbështesin terrorizmin ose përfshirjen në të.

**Program rehabilitimi** - program me fokus individët e radikalizuar (duke përfshirë edhe autorët e veprave terroriste) ose familjet e tyre, në faza të ndryshme të radikalizimit. Këto programe përfshijnë edhe programet e shkëputjes së personave të radikalizuar në burgje dhe të kujdesit pas arrestit, të cilat fokusohen tek rehabilitimi dhe riintegrimi i autorëve të veprave terroriste, “luftëtarët e huaj terroristë” të kthyer dhe tek integrimi i tyre në shoqëri.

**Person i referuar** - individ i referuar në programe që përfshijnë disa agjenci ose disa palë të të interesuara; individ që shfaq dukshëm prirje drejt EDhRÇT-së ose një individ tashmë i radikalizuar. Këta individë mund të referohen nga programet tek agjencitë, institucionet apo organizatat dhe specialistët e ndryshëm për ndërhyrje apo për mbështetje të mëtejshme pas vlerësimit të rrezikut, dobësive dhe faktorëve individualë mbrojtës.

**Mekanizëm referimi** - mekanizëm formal ose joformal, i përbërë nga profesionistë të disiplinave dhe/ose agjencive dhe organizatave të ndryshme që synojnë identifikimin, vlerësimin, ofrimin e ndihmës dhe trajtimin të individëve që rrezikojnë të marrin rrugën e EDhRÇT-së ose të angazhohen në EDhRÇT.

**Vlerësim rreziku** - proces që përfshin mbledhjen sistematike dhe interpretimin e të dhënave për një individ të radikalizuar, vlerësimin konkret të mundësisë që ky individ të merret me akte të dëmshme, si dhe vlerësimin e natyrës dhe ashpërsisë së këtyre akteve.

**Mjet i vlerësimit të rrezikut** - instrument për mbledhjen sistematike dhe interpretimin e të dhënave të marra nga disa burime që ndihmojnë në marrjen e një vendimi jodiskriminues dhe të strukturuar në lidhje me prirjen e një individi për akte të dëmshme, si dhe për natyrën dhe ashpërsinë e këtyre akteve.

**Faktor rreziku** - çdo tipar, si p.sh. besimi, paraqitja, përvoja ose mjedisi rrethues, që lehtëson arritjen e një rezultati të matshëm (p.sh. prirjet e një individi drejt EDhRÇT-së).

**Qasje gjithëpërfshirëse** - qasje parandaluese/që mbështetet nga politikëbërësit dhe profesionistët, e cila parashikon role të ndryshme për sektorë të ndryshëm të shoqërisë civile në programet e parandalimit, ndërhyrjes, shkëputjes dhe rehabilitimit.

# Parathënie

Duke vlerësuar dinamikat e natyrës së terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në shtetet anëtare të OSBE-së del qartë se duhet të zhvillohen politika dhe programe të qëndrueshme dhe me ndikime të matshme për ta parandaluar dhe për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Sot, shumë vende po eksplorojnë platforma multidisiplinare që përfshijnë shumë agjenci që mbështesin individët me prirje të dukshme drejt EDhRÇT-së, në mënyrë që ata të orientohen drejt tolerancës dhe rrugëve paqësore. Këto ndërhyrje jopenale - shumë syresh të strukturuar rreth procesit të referimit - plotësojnë boshllëqet ekzistuese në përpjekjet afatgjata për arritjen e një kohezioni shoqëror dhe qëndrese ndaj EDhRÇT-së, si dhe masave të sigurisë kundër terrorizmit.

Zhvillimi i mekanizmave të referimit dhe i llojeve të tjera të ndërhyrjeve jopenale janë përpjekje komplekse që duhet të përgatiten dhe të zbatohen me kujdes. Nëse planifikohen mirë dhe nëse strukturohen e sigurohen burimet e nevojshme, këto përpjekje mund të ndihmojnë që komunitetet të bëhen më të sigurta, duke garantuar “përfshirjen e të gjitha organeve të pushtetit” në parandalimin e EDhRÇT-së. Megjithatë, për të garantuar mospenalizimin e padrejtë të individëve mes programeve të tilla, mosshkeljen e lirisë së shprehjes dhe privatësisë, mosstigmatizimin e komuniteteve të caktuara dhe uljen e stereotipeve gjinore, është e domosdoshme që të hartohen politikat e duhura dhe të vihen në dispozicion kapacitetet e nevojshme. Ky udhëzues u hartua për t'u ardhur në ndihmë politikëbërësve dhe studiuesve për të strukturuar përfitimet që sjellin këto ndërhyrje dhe për të reduktuar edhe rreziqet që mund të vijnë bashkë me to. Edhe pse nuk ka një model të vetëm mekanizmi referimi, ky udhëzues synon të ofrojë disa parime themelore që mbështesin çdo ndërhyrje për parandalimin e EDhRÇT-së.

Gjatë përgatitjes të këtij udhëzuesi është marrë parasysh konteksti i rajonit të Evropës Juglindore. Vitet e fundit, Evropa Juglindore ka shtuar politikat dhe kapacitetet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së si përgjigje ndaj çështjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin përmes zhvillimit të mekanizmave të referimit. Ky udhëzues përqendrohet në disa faktorë specifikë të rajonit që ndikojnë në përpjekjet për zhvillimin e mekanizmave të referimit në Evropën Juglindore dhe në konsultimet me aktorët/grupet e interesit nga rajoni.

Ky udhëzues është pjesë e një sërë të përgatitura nga Njësia për Veprim Kundër Terrorizmit (NjVKT) në Departamentin për Kërcënimet Transnacionale të Sekretariatit të OSBE-së. Vëllimi i radhës dedikuar rehabilitimit dhe riintegritimit të autorëve të veprave terroriste dhe familjeve të tyre përbën një përpjekje të veçantë në këtë fushë dhe një shqetësim për shtetet anëtare të OSBE-së. Shpresojmë që ky udhëzues dhe botimet e ardhshme të jenë burime të vlefshme për politikëbërësit dhe për profesionistët që punojnë për të nxitur qasje gjithëpërfshirëse dhe kuptimplota për parandalimin e EDhRÇT-së, dhe më gjerë, për promovimin e paqes dhe sigurisë.



**Rasa Ostrauskaite**

Koordinatorë e Aktiviteteve për Adresimin e Kërcënimeve Transnacionale  
Sekretariati i OSBE-së

# Përmbledhje e shkurtër

Shtetet anëtarë në zonën e OSBE-së janë të vëmendshme ndaj përdorimit të një qasjeje “gjithëpërfshirëse” në sfidën e **parandalimit dhe kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm, e cila e vë theksin te bashkëpunimi** mes shumë sektorëve dhe disiplinave të ndryshme. Mekanizmat e referimit për trajtimin e dhunës dhe ekstremizmit që çon në terrorizëm (EDhRÇT) në hapësirën jopenale shihen si elementë kyç të kësaj qasjeje.

Duke u nisur nga përvojat e mëparshme në zonën e OSBE-së dhe nga mësimet e nxjerra nga mekanizmat e referimit jashtë hapësirës së Parandalimit/Kundërvënies ndaj EDhRÇT-së (p.sh. mekanizmat e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore, ose mbrojtjes së fëmijëve të abuzuar dhe të keqtrajtuar), ky udhëzues **thekson përfitimet që vijnë nga mekanizmat e duhur të referimit**, si p.sh., adresimin e shqetësimeve, shenjave të rrezikut që shfaqin individë të caktuar në familje apo në komunitet përmes policisë; si dhe nxitjen e përfshirjes së ofruesve të kujdesit psikosocial dhe profesionistëve të tjerë jashtë strukturave të zbatimit të ligjit.

Udhëzuesi **merr në shqyrtim faktorët dhe sfidat kryesore të politikëbërësve dhe profesionistëve gjatë krijimit dhe funksionimit të këtyre mekanizmave**; udhëzuesi **diskuton pasojat e mundshme negative të mekanizmave të tillë**, duke theksuar respektimin e parimit të “mosshkaktimit të dëmit”. Këta faktorë përfshijnë (1) krijimin e mbështetjes nga komuniteti, pjesëmarrja e të cilit është kritik për efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e mekanizmit; (2) fokusimin në sjellje që mund të çojnë në EDhRÇT dhe jo në besime dhe ide të mbrojtura me ligj; (3) shmangien e stigmatizimit të një grupi të caktuar fetar ose etnik; (4) përcaktimin e një roli të qartë të organeve ligjzbatuese, veçanërisht në reduktimin e rreziqeve të kriminalizimit të padrejtë të individëve të referuar në mekanizmat kundër radikalizmit të dhunshëm; (5) përcaktimin e normave dhe qëndrimeve shoqërore rreth kujdesit psikosocial, si një element integral i mekanizmave të referimit; si dhe (6) mbështetjen e një numri të madh agjencish dhe organizatash përmes kapaciteteve institucionale ekzistuese, të cilat kanë nevojë të përshtaten dhe të fuqizohen veçanërisht për përballimin e sfidave në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Udhëzuesi i **trajton mekanizmat e referimit nga këndvështrimi i shëndetit publik, duke theksuar përfitimet që sjell kjo qasje në praktikë në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së**, duke e vlerësuar EDhRÇT-në si një fenomen shoqëror me ndikim të gjerë, që shkon përtej dëmeve fizike të shkaktuara nga një sulm i vetëm; si e tillë, ajo kërkon përfshirjen e një sërë aktorësh, si ofruesit e kujdesit psiko-social, mësuesit, drejtuesit fetarë dhe drejtuesit e tjerë komunitarë në ndërmarrjen e masave proaktive, parandaluese dhe mbrojtëse për individin, komunitetin dhe shoqërinë.

Udhëzuesi thekson se duke e trajtuar fenomenin (e për rrjedhojë edhe mekanizmat e referimit) nga këndvështrimi i shëndetit publik, mund të krijohen programe shumëplanëshe për shmangien e stigmatizimit dhe për shfrytëzimin e burimeve të shëndetit publik, duke lejuar angazhimin e profesionistëve të shëndetit mendor dhe punonjësit socialë.

Udhëzuesi paraqet forma dhe emërtesa të ndryshme për këta mekanizma referimi, duke ofruar disa modele (Shtojca e Udhëzuesit). Krahas dallimeve, udhëzuesi rendit disa **karakteristika të përbashkëta të mekanizmave të referimit si** (1) natyra e tyre vullnetare; (2) mbështetja e tyre në vlerësimet jodiskriminuese të rrezikut ose në mjete të tjera (të zbatuara përmes profesionistëve të trajnuar) për matjen e rreziqeve, nevojave dhe ndryshimeve në sjelljen e individëve të referuar, si dhe për hartimin e planeve të ndërhyrjes ose të mbështetjes, të përshtatura me nevojat individuale të çdo individi të referuar; (3) përfshirja e aktorëve të ndryshëm nga disiplina dhe agjenci të ndryshme; dhe (4) zhvillimi i kanaleve të reja të koordinimit dhe protokolleve të shkëmbimit të informacionit.

Krahas vlerësimit të kontekstit përkatës lokal, kulturor, shoqëror dhe historik të mekanizmave të referimit, udhëzuesi **analizon një sërë faktorësh të rëndësishëm dhe hapat që duhen të ndërmerren gjatë krijimit dhe funksionimit të këtyre mekanizmave, si:** (1) hartëzimi institucioneve vendore, grupeve të interesit, kapaciteteve kulturore dhe politike; (2) vlerësimi dhe prezantimi i objektit të punës së mekanizmit, duke pranuar se **një mekanizëm që i trajton të gjitha format e EDhRÇT-së si pjesë e përpjekjeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna është më i pranueshëm për komunitetet;** (3) qartësimi i mandatit të aktorëve të

mekanizmit, drejtimi i tij, rolet dhe përgjegjësitë e secilit; (4) mundësimi i shkëmbimit efektiv të informacionit mes profesionistëve, agjencive dhe organizatave të ndryshme që janë pjesë e mekanizmit; (5) integrimi i aspekteve gjinore dhe përfshirja e shoqërisë civile në mekanizëm; (6) qartësimi i rolit të qeverisë qendrore dhe vendore; dhe (7) përcaktimi i burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion të mekanizmit.

Njohja e përdoruesve kryesorë të këtij udhëzuesi - politikëbërësit dhe profesionistët në Evropën Juglindore – fuqizon **disa faktorë specifikë të rajonit që mund të ndikojnë në përpjekjet për të pasur mekanizma referimi efikase në rajon**. Për shembull, qeveritë në Evropën Juglindore e kanë parë shpesh EDhRÇT-në në aspektin e ekstremizmit të dhunshëm islamik, duke shpërfillur dhunën e evidentuar nga grupe të krahut të djathtë ekstremist, por ka edhe faktorë të tjerë si niveli i ulët i besimit të qytetarëve tek institucionet qeveritare, duke përfshirë edhe policinë; qeveri tejet të politizuara, duke përfshirë edhe qeverinë lokale; kapacitetet dhe ekspertiza e kufizuar e institucioneve, organizatave dhe e profesionistëve përkatës; një lloj ringjalljeje e orientimit fetar pas një gjysmë shekulli komunizëm dhe tradita laike, ndërthurur me tensione ndëretnike dhe fetare; mungesa e qëndrimeve të përbashkëta komunitare në lidhje me idetë ose sjelljet “ekstremiste” apo “radikale”; si dhe fakti që përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së në rajon mbeten të fragmentuara dhe jokohërente.

Edhe pse nuk ofron modele për çdo mekanizëm referimi, udhëzuesi përfundon duke sqaruar disa parime themelore që duhet të orientojnë çdo mekanizëm të tillë. Elementi kryesor i çdo modeli duket me shumë gjasë se lidhet me vendimin për ngritjen e një mekanizmi të tillë, nëse modeli i zgjedhur i përshtatet kontekstit dhe kulturës lokale, nëse bazohet në të dhëna dhe konsultime me palët lokale, nëse vlerëson kapacitetet dhe gatishmërinë e institucioneve, organizatave dhe aktorëve të tjerë që do të jenë pjesë e procesit.







# 1. Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë, në thelb, mohim i vlerave demokratike të tolerancës, respektit, përfshirjes dhe diversitetit, tek të cilat mbështetet puna e OSBE-së. Ndonëse secili nga të 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së përballen në mënyrën e vet me kërcënimet e terrorizmit transnacional, ato që të gjitha kanë konfirmuar përkushtimin e tyre për të parandaluar dhe për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm.

Shtetet e zonës së OSBE-së vazhdojnë të përballen me vështirësi shumëdimensionale në përpjekjet për reduktimin e faktorëve që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm; zbulimin dhe parandalimin e sulmeve brenda vendit dhe me menaxhimin e kthimit të “luftëtarëve të huaj terroristë” (“LHT”) nga zonat e konfliktit. Adresimi i aspekteve të ndryshme të kësaj sfide ka qenë prioritet për shtetet anëtarë që mbajnë kryesimin e OSBE-së, si Zvicra<sup>1</sup> Serbia,<sup>2</sup> Gjermania,<sup>3</sup> Austria,<sup>4</sup> Sllovakia dhe Italia. Gjatë Konferencës kundër Terrorizmit, në mars 2019 në Bratislavë, iu dedikua një seancë plenare rëndësisë së politikave dhe strategjive shumë-sektorale për parandalimin e EDhRÇT-së. Ky bashkëpunim është veçanërisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për programe kushtuar identifikimit, ndërhyrjes, ridrejtimit dhe mbështetjes së të rinjve të prekshëm nga radikalizimi, në rrezik radikalizimi ose që kanë shfaqur prirje apo interes drejt ekstremizmit të dhunshëm, por që nuk kanë kryer asnjë krim. Kjo është një fushë, së cilës shtetet e zonës së OSBE-së i kushtojnë vëmendje të shtuar.

1 Shih, për shembull, Kryesimi i OSBE-së, “Rekomandimet e Interlaken të Kryesimit të OSBE-së”, 29 prill 2014, <https://www.osce.org/cio/118146?download=true>.

2 Shih, për shembull, OSBE, “Deklarata ministrore për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm që çon në terrorizëm”, 4 dhjetor 2015, <https://www.osce.org/cio/208216?download=true>.

3 Shih, për shembull, OSBE, “Deklarata për përforcimin e përpjekjeve të OSBE-së për parandalimin dhe kundërvënien ndaj terrorizmit”, 9 dhjetor 2016, <https://www.osce.org/cio/288176?download=true>.

4 Shih, për shembull, Kryesimi i OSBE-së, Dokumenti i Perceptimit i Kryesisë, “Rekomandime nga “Konferenca kundër Terrorizmit” e OSBE-së e vitit 2017 për “Parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm”, maj 2017, <https://www.osce.org/secretariat/327731?download=true>.

## Termet “në rrezik nga” dhe “të prekshëm ndaj”

Termet “në rrezik nga” dhe “të prekshëm ndaj” në këtë udhëzues përdoren për t’iu referuar individëve me prirje për t’u angazhuar në aktivitete të dhunshme ekstremiste dhe që, për këtë arsye, kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje. Megjithatë, çdo vlerësim rreziku për veprime të dhunshme dhe arsyet përkatëse duhet të bazohen në tregues të dukshëm të sjelljes, si dhe të bëhet nga profesionistë të trajnuar klinikë, duke përdorur mjete të caktuara diagnostikuese. Në seksionin 6.2 shpjegohet se ende nuk ka mënyra që parashikojnë vlerësimin e sjelljeve të radikalizuara që sjellin dhunë, por ekziston vetëm një kuadër diagnostikues për vlerësimin e rrezikut. Mjetet e vlerësimit të rrezikut duhen marrë me kujdes, për të mos përfunduar në profilizime, stigmatizime të individëve, apo në shtyrjen e tyre drejt dhunës.

Për politikëbërësit dhe praktikantët, ndërhyrje të tilla të drejtuara nga aktorët lokalë, konsiderohen si masat më konkrete (dhe që ndërmerren më shpesh) për parandalimin/ kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Ato mund të përfshijnë paketa ndërhyrjesh të përshtatura sipas individit, si p.sh., mbështetje psikosociale, mentorim, strehim, debat teologjik ose ndihmë për punësim dhe arsimim, të cilat ndihmojnë në ndërprerjen e procesit të radikalizimit para se pikëpamjet të bëhen më të ngurta dhe para se individët të izoloohen.<sup>5</sup> Ndërhyrjet shpesh përfshijnë një ose më shumë aktorë lokalë, si punonjësit socialë, profesionistët që punojnë me të rinjtë dhe punonjësit e shëndetësisë; këshilluesit familjarë; familjarët; bashkëmoshatarët; mësuesit; organizatat lokale të shoqërisë civile (OShC-të); dhe, sipas rastit, edhe policinë.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së po përdorin një sërë mekanizmash dhe programesh - të reja dhe/ose ekzistuese - për t’u mundësuar këtyre profesionistëve dhe komuniteteve përdorimin praktik të aftësive, njohurive dhe kapaciteteve të tyre të veçanta për të identifikuar individët e prekshëm dhe për t’u ofruar atyre mbështetjen e nevojshme drejt një rruge jo të dhunshme para se të kryejnë ndonjë krim.

Interesimi i shtuar për këto lloje nismash shumëdisiplinare, të cilat shpesh ndërmerren në nivel lokal dhe përfshijnë disa agjenci njëherësh, pasqyron nga njëra anë një rritje të ndërgjegjësimit të politikëbërësve dhe profesionistëve se këto programe mund të plotësojnë boshllëqet në përpjekje për ndërtimin e kohezionit shoqëror dhe, nga ana tjetër më shumë rezistencë ndaj EDhRÇT-së

<sup>5</sup> Peter Neumann, *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Ide, Rekomandime dhe Praktika të Mira nga rajoni i OSBE-së*, OSBE, 28 shtator 2017, fq. 71-72, <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

dhe masa më të forta ndaj terrorizmit. Këto përpjekje shihen shpesh si “masa të buta” ose afatgjata për ndikimin e dallueshëm që kanë ndaj kërcënimeve, ndërkohë që masat e fokusuara te siguria shpesh konsiderohen si masa ndërhyrëse ose, më keq akoma, si masa ndëshkuese. Nismat shumëdisiplinare mund t'i shmangin këto perceptime negative.

Pavarësisht nevojës për mekanizma dhe programe lokale, shumëdisiplinare dhe mbështetëse ndaj parandalimit,<sup>6</sup> vënia e tyre në zbatim mund të jetë i vështirë. Disa nga këto vështirësi mund të jenë:

1. numri i madh i aktorëve, shpesh me pak ose aspak përvojë bashkëpunimi;
2. mungesa e besimit, duke përfshirë edhe mosbesimin tek policia dhe organet jopolicore, ose mosbesimi mes policisë dhe komunitetit;
3. vështirësia për të përcaktuar rolin që mund të luajë policia në ndërhyrje të natyrës jopenale, veçanërisht nëse komunitetet nuk kanë ndonjë eksperiencë të mirë me çështje të ndryshme të sigurisë;
4. vështirësia për arritjen e një ekuilibri mes privatësisë së informacioneve dhe nevojës për shkëmbimin e tyre, veçanërisht mes organeve policore dhe jopolicore;
5. ndjeshmëritë kulturore në lidhje me shëndetin mendor ose lloje të tjera të kujdesit psikosocial;
6. mungesa e një tipologjie shenjash ose faktorësh rreziku që mund të përdoren për të vlerësuar prirjet drejt terrorizmit ose ekstremizmit të dhunshëm; dhe
7. burimet dhe kapacitetet e kufizuara institucionale.

Duke pasur parasysh këto sfida, ky udhëzues është konceptuar si një mënyrë orientuese për ngritjen e mekanizmave të referimit bazuar tek të drejtat e njeriut dhe tek programet që mundësojnë qasje bashkëpunuese dhe shumëdisiplinare për identifikimin dhe ndërhyrjen tek ata individë që rrezikojnë të angazhohen në aktivitete të dhunshme.

Ky udhëzues është **shkruar për politikëbërësit** e angazhuar në hartimin e politikave, strategjive, planeve të veprimit dhe programeve për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Në mënyrë të veçantë, ky udhëzues evidenton rrethanat që duhen marrë parasysh për krijimin e një mekanizmi referimi apo një programi të ngjashëm. Udhëzuesi thekson disa sfida që duhen tejkaluar gjatë projektimit të një programi të tillë, si dhe mënyrat për kapërcimime tyre.

<sup>6</sup> Komisioni Evropian, Grupi i Ekspertëve të Komisionit të Nivelit të Lartë për Radikalizimin (GEKNL-R), *Raporti përfundimtar*, 18 maj 2018, fq. 8, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-security/20180613\\_final-report-radicalisation.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-security/20180613_final-report-radicalisation.pdf).

Ai ka, gjithashtu, për qëllim rritjen e vetëdijësimit për rëndësinë e bashkëpunimit mes politikëbërësve dhe profesionistëve gjatë zhvillimit dhe futjes në përdorim të këtyre programeve, si dhe identifikimin e mënyrave të forcimit të një bashkëpunimi të tillë.

Udhëzuesi u adresohet edhe **aktorëve lokalë** – si p.sh. autoriteteve në nivel bashkie dhe autoriteteve rajonale, profesionistëve lokalë, si dhe aktorëve të shoqërisë civile - të cilët mund të përfshihen në krijimin dhe zbatimin e këtyre programeve. Ai thekson çështje që duhen adresuar në faza të ndryshme të krijimit dhe funksionimit të këtyre mekanizmave.

Idetë e paraqitura në këtë udhëzim synojnë të nxisin diskutime mes aktorëve të përfshirë në shqyrtimin e efikasitetit të programeve të tilla. Në veçanti, udhëzuesi identifikon sfidat kyçe, me të cilat mund të përballen politikëbërësit dhe profesionistët, nëse vendosin t'i vënë në jetë këto programe. Udhëzuesi rendit, gjithashtu, edhe disa pasoja negative që mund të sjellin mekanizma të tillë dhe jep disa rekomandime se si mund të reduktohen këto pasojave.

Ky udhëzues bazohet në disa praktika ekzistuese dhe gjetje nga mekanizma referimi, apo programe të tjera për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Pas këtij sesioni hyrës, në sesionin e dytë diskutohet natyra dhe objekti i koncepteve kyçe të “ekstremizmit të dhunshëm” dhe “radikalizimit” dhe shpjegohet spektri i politikave dhe programeve përbërëse të parandalimit/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Në sesionin 3 shpjegohet koncepti i mekanizmit të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së dhe theksohen dhe shtjellohen përfitimet që sjellin modelet e ndryshme të këtyre mekanizmave.

Po ashtu, theksohen kontekste të tjera, ku përdoren mekanizmat e referimit dhe përshkruhen mësimet e nxjerra nga përpjekje të ngjashme për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Më pas, analizohet rëndësia që ka perspektiva e shëndetit publik për këta mekanizma dhe roli që duhet të luajnë organet ligjzbatuese në to.

Sesioni 4 fokusohet te zvogëlimi i dëmeve. Në të diskutohen disa nga sfidat që duhen kapërcyer dhe pasojat negative që duhen shmangur gjatë krijimit dhe funksionimit të mekanizmave të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Duke u bazuar në një sërë burimesh, sesioni 5 thekson disa nga çështjet kryesore që duhet të merren parasysh dhe hapat që duhen ndërmarrë gjatë krijimit dhe zbatimit të mekanizmave të referimit.

Sesioni 6 përshkruan komponentët themelorë të një mekanizmi referimi, duke ofruar udhëzime praktike se si vihet në përdorim secili prej tyre.

Rajoni specifik i Evropës Juglindore shqyrtohet në Sesionin 7. Në këtë sesion identifikohen faktorët dhe sfidat specifike të rajonit, duke përfshirë faktorët kulturorë, shoqërorë ose politikë, me të cilat ballafaqohen vendet pjesëmarrëse kur vendosin nëse duhen ngritur mekanizma të tillë referimi në vendet, qytetet dhe komunitetet e tyre.

Në këtë udhëzues përdoren informacione nga përvojat dhe mësimet e nxjerra nga një sërë nismash të shumë shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Udhëzuesi shoqërohet edhe me disa shtojca, ku përshkruhen lloje të ndryshme mekanizmash referimi që merren me rastet e EDhRÇT-së, duke theksuar se nuk ekziston ende një qasje e unifikuar dhe e përshtatshme për të gjitha situatat gjatë krijimit dhe funksionimit të mekanizmave të referimit.





# 2. Konceptet kryesore: EDhRÇT-ja dhe parandalimi/kundërvënien ndaj saj

## 2.1 Çfarë do të thotë ekstremizëm i dhunshëm, radikalizim dhe ekstremizëm i dhunshëm dhe radikalizim që çon në terrorizëm

OSBE-ja është tashmë e bindur se sa e nevojshme është që të tregohemi të kujdesshëm në përdorimin e disa termave në fushën e kundërvënies ndaj terrorizmit. OSBE-ja e përkufizon “**radikalizimin që çon në terrorizëm** – si një proces dinamik, përmes së cilit një individ pranon dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme dhe ndoshta edhe legjitime të vepruari. Mundet që ky proces ta çojë në fund individin edhe drejt terrorizmit, mbështetjes së terrorizmit, apo përfshirjes në të, por nuk ndodh domosdoshmërisht kështu”.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> OSBE, *Parandalimi i terrorizmit dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Qasja e policimit në komunitet*, shkurt 2014, <https://www.osce.org/secretariat/111438?download=true>.

Kështu, OSBE-ja përdor qëllimisht termin “**ekstremizëm i dhunshëm dhe radikalizim që çon në terrorizëm (EDhRÇT)**”, që nënkupton se jo çdo ekstremizëm i dhunshëm dhe radikalizim përfundon në terrorizëm.

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme ligjore në politika dhe dokumente studimore për “terrorizmin”, “radikalizimin” dhe “ekstremizmin e dhunshëm”. Këto përkufizime shërbejnë për qëllime të ndryshme, janë të paharmonizuara dhe janë bërë, herë pas here, pengesë në përpjekjet drejt bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar dhe promovimit të praktikave të mira.

Në fakt, vështirë se gjendet një përkufizim për “**ekstremizmin e dhunshëm**”; ai u referohet në përgjithësi akteve të dhunës që justifikohen ose shoqërohen me ideologji ekstremiste fetare, shoqërore ose politike. Koncepti i ekstremizmit të dhunshëm është më i gjerë sesa ai i terrorizmit për shkak se përfshin çdo lloj dhune, për sa kohë motivohet pikërisht nga ekstremizmi.<sup>8</sup>

Për ekstremizmin e dhunshëm nuk ka një përkufizim zyrtar as nga ana e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe as nga Bashkimi Evropian (BE). Megjithatë, sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së “Ekstremizmi i dhunshëm përfshin një kategori të gjerë manifestimesh, duke rrezikuar ndoshta edhe përzjerjen e termave (“ekstremizëm i dhunshëm” dhe “terrorizëm”) dhe duke çuar ndonjëherë edhe në marrjen e masave më të rrepta në luftën kundër terrorizmit, madje edhe ndaj akteve që nuk duhen klasifikuar si terroriste”.<sup>9</sup>

Termi “radikalizim” i referohet procesit, përmes të cilit individit pranon ose mbështet idetë ekstremiste. Radikalizimi zakonisht nuk shkaktohet nga një ndikim i vetëm, por nga një sërë faktorësh dhe dinamikash të ndryshme. Është një term që paraqitet me interpretime të ndryshme. Në disa raste, ky term përdoret në mënyrë të tillë që nënkupton një lidhje midis ideve radikale dhe dhunës. Kjo është problematike, sepse jo të gjithë ata që u përmbahen ideve radikale (ose ekstremiste) angazhohen në veprime të dhunshme apo ti mbështesin ato dhe sepse mundësia për të pasur ide pavarësisht natyrës së tyre është e mishëruar në të drejtën ndërkombëtare si një e drejtë themelore e njeriut.<sup>10</sup>

8 Shih Andrew Glazzard dhe Martine Zeuthen, “Ekstremizmi i dhunshëm”, GSDRC, shkurt 2016, [https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a0895ae5274a31e000002c/Violent-extremism\\_RP.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a0895ae5274a31e000002c/Violent-extremism_RP.pdf); dhe Neumann, *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit*.

9 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, *Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, Sesioni i shtatëmbëdhjetë, A/70/674, 24 dhjetor 2015, [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/70/674](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/70/674).

10 E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes mbrohet nga neni 19 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Ai përcakton se çdokush ka të drejtë të ketë mendimet e tij pa ndërhyrje. Për më tepër, liria e shprehjes mbron po ashtu edhe shprehjen e pikëpamjeve dhe të ideve që bezdisin, ofendojnë ose shokojnë (dhe që mund të godasin persona të caktuar si radikalë apo ekstremë).

## 2.2 Programet dhe strategjitë për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

Termi “**parandalim dhe kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm**”(parandalimi/kundërvënia ndaj EDhRÇT-së) i referohet një sërë politikash, programesh dhe ndërhyrjesh që kanë për qëllim parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit që çon në terrorizëm. Ky përkufizim i miratuar nga OSBE-ja thekson, nga njëra anë, lidhjen që ekziston ndërmjet radikalizimit dhe ekstremizmit; si dhe lidhjen ndërmjet akteve të dhunës dhe terrorizmit nga tjetra. Në këtë mënyrë, OSBE-ja nënvizon rëndësinë e mbrojtjes së lirive themelore, kur punohet për parandalimin e këtyre kërcënimeve ndaj me sigurisë.

Parandalimi/kundërvënia ndaj EDhRÇT-së dallohet nga lufta ndaj terrorizmit nga natyra e saj jodetyruese (p.sh. parandalimi nuk përfshin arrestimet, hetimet dhe ndjekjet penale) dhe, për këtë arsye, nuk ka në shënjestër drejtpërdrejt terroristët apo terrorizmin. Në fokus të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së është në fakt (1) parandalimi dhe kundërvënia ndaj proceseve të radikalizimit që mund të çojnë në terrorizëm; (2) trajtimi dhe zvogëlimi i ankesave dhe i kushteve strukturore, shoqërore, ekonomike dhe politike që mund të favorizojnë ekstremizmin e dhunshëm; (3) dhënia e ndihmës personave që i kanë hyrë rrugës së radikalizimit drejt terrorizmit, në mënyrë që të shpëputen prej tij dhe të riintegrohen në shoqëri; dhe (4) ndërtimi i qëndresës së komunitetit ndaj EDhRÇT-së.

Nga ana tjetër, kundërvënia ndaj terrorizmit i referohet “një sërë aktiviteteve, të ndërmarra kryesisht nga organet ligjzbatuese dhe agjencitë e shërbimeve të fshehta informative e, në raste të veçanta edhe nga ushtria, të cilat synojnë pengimin e kompleteve terroriste dhe shpërbërjen e organizatave terroriste”, apo edhe reagimeve të drejtësisë penale që heton për vepra penale dhe që çon para drejtësisë ata që kanë kryer krime terroriste.<sup>11</sup> Duke qenë se strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së projektohen dhe drejtohen kryesisht nga autoritetet shtetërore, në zbatimin e tyre marrin shpesh pjesë jo vetëm aktorët e qeverisë kombëtare, por edhe një spektër i gjerë aktorësh të tjerë si autoritetet lokale, dhe rajonale, shoqëria civile dhe sektori privat. Si të tilla, përpjekjet për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së mund të kuptohen më mirë si programe dhe politika që **plotësojnë** qasjet tradicionale të kundërvënies ndaj terrorizmit.

<sup>11</sup> Peter Neumann, *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Ide, Rekomandime dhe Praktika të Mira nga rajoni i OSBE-së*, OSBE, 28 shtator 2017, fq. 71-72, <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

Termtat e tjerë që përdoren në bashkësinë ndërkombëtare përfshijnë “kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, “parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm” dhe “parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm”. Parandalimi/kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm është një term i gjerë që përfshin aktivitetet që zbatohen nga aktorët qeveritarë dhe joqeveritarë dhe që kanë për qëllim parandalimin ose zbutjen e ekstremizmit të dhunshëm përmes masave jodetyruese, të cilat që të gjitha synojnë adresimin e faktorëve shtytës të ekstremizmit të dhunshëm. Organizatat për zhvillim dhe profesionistët kanë secili preferencat e veta kur vjen fjala te termtat që përdorin, “parandalim i ekstremizmit të dhunshëm” ose “kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm”. Për shembull, “parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm” përdoret më tepër nga OKB-ja dhe agjencitë për zhvillim. Me të nënkuptohet adresimi dhe zbutja e kushteve që mundësojnë terrorizmin, si dhe e shkaqeve themelore të terrorizmit, siç janë keqqeverisja, strukturat shoqërore përjashtuese dhe arsimimi i pamjaftueshëm.<sup>12</sup> Megjithatë, shpeshherë ka shumë pak dallim midis “parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm” dhe “kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm” sa u përket qëllimeve konkrete dhe veprimeve në terren.<sup>13</sup> Kështu, si parandalimi, ashtu edhe kundërvënia përmbajnë në thelb përpjekje proaktive dhe parandaluese. Sipas Programit për Zhvillim të OKB-së, kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm fokusohet tek aktivitetet e ekstremiste ekzistuese, kurse parandalimi synon moslejimin e përhapjes së mëtejshme të ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, në praktikë, nismat e ndërmarra i trajtojnë të dyja këto aspekte përmes qasjesh të kombinuara”.<sup>14</sup>

Spektri i aktivitetetve, programeve dhe i llojeve të angazhimeve që i takojnë parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së është i gjerë dhe përfshin përpjekjet në nivel komuniteti, përpjekjet individuale, si dhe ato lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.<sup>15</sup>

12 Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, *Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, Seanca e Shtatëmbëdhjetë, A/70/674, 24 dhjetor 2015, [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/70/674](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/70/674).

13 Instituti Mbretëror i Shërbimeve të Bashkuara i Britanisë së Madhe (RUSI) dhe CIVIPOL, *Udhëzimet Operative të BE-së për Përgatitjen dhe Zbatimin e Veprimeve të Financuara nga BE-ja për t’iu Kundërvënë Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm në Vendet e Treta*, Komisioni Evropian, nëntor 2017, [https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/eu-ct-cve-guidelines-20171213\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/eu-ct-cve-guidelines-20171213_en.pdf).

14 Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, *Udhëtimi drejt ekstremizmit në Afrikë: shtytësit, nxitësit, dhe pika e kthesës për rekrutim*, 2017, <http://journey-to-extremism.undp.org/content/downloads/UNDP-JourneyToExtremism-report-2017-english.pdf>.

15 Georgia Holmer dhe Peter Bauman, “Bërja e analizës gjithëpërfshirëse para se të veprohet: Mjetet analitike për t’i kuptuar dhe për t’i projektuar programet për parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gusht 2018, <https://www.usip.org/publications/2018/09/taking-stock-analytic-tools-understanding-and-designing-pcve-programs>.

Llojet konkrete të aktiviteteve që ndërmerren në nivel kombëtar përcaktohen përgjithësisht nga fushat prioritare të veprimit, të identifikuar në kornizat strategjike të secilit vend. Në fund, ajo që përcakton se çfarë qasjesh dhe programesh zgjedhim është natyra e kërcënimit, normat aktuale shoqërore dhe rrethanat politike, strukturat e qeverisjes, burimet, kapacitetet, vlerësimet e rrezikut dhe tradita.

Nganjëherë, politikëbërësit dhe profesionistët e angazhuar në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së kanë pasur vështirësi në vendosjen e kufirit midis programeve të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së dhe programeve të iniciuara në kuadër të fushave të mirëpërcaktuara, siç janë zhvillimi dhe zbutja e varfërisë, zgjidhja e konflikteve, ndërtimi i paqes, qeverisja dhe arsimimi. Të dyja këto lloje programesh janë të projektuara për t'iu kundërvënë faktorëve që mund të nxisin ekstremizmin e dhunshëm në vende të veçanta: mentorët e radikalizuar, rrjetet shoqërore ekstremiste, dëshira për hakmarrje, përpjekjet për status personal dhe një mori faktorësh të tjerë motivues, lehtësues dhe strukturorë. Përpjekje te tilla synojnë adresimin e individëve të identifikuar konkretisht si të rrezikuar ose si të predispozuar për t'u përfshirë në akte dhune.<sup>16</sup>

Programet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së ndahen në disa mënyra. E para, sipas **llojit**: programe për ndërgjegjësimin, ndërtimin e besimit, trajnimin, dialogun dhe komunikimet strategjike; sipas **përfituesve**: programe nga të cilat përfitojnë komunitetet/grupe të tëra ose individë; dhe (siç përshkruhet më poshtë) sipas **funksionit**: programe parandaluese, ndërhyrëse dhe rehabilituese. Disa programe mund të kryejnë edhe më shumë sesa një funksion njëherësh. Disa ekspertë sugjerojnë se kornizat për reduktimin e dhunës nga bandat dhe modelet e mbështetura tek perspektiva e shëndetit publik (që diskutohen në seksionin 3.5) mund të jenë të dobishme për zhvillimin dhe grupimin e programeve të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së.<sup>17</sup>

16 James Khalil dhe Martine Zeuthen, "Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe reduktimi i rrezikut: Udhëzues për projektimin dhe vlerësimin e programeve", Raporti i Whitehall, RUSI, 8 qershor 2016, [https://rusi.org/sites/default/files/20160608\\_cve\\_and\\_rr.combined.online4.pdf](https://rusi.org/sites/default/files/20160608_cve_and_rr.combined.online4.pdf).

17 David P. Eisenman dhe Louise Flavahan, "Kananat në minierën e qymyrit: Dhuna ndërpersonale, dhuna e bandave dhe ekstremizmi i dhunshëm përmes këndvështrimit parandalues të shëndetit publik," *Pasqyra Ndërkombëtare e Psikiatrisë* 29, nr. 4 (gusht 2017): 341-349, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/28805121>; dhe Youth Power, "Praktikat premtuese për angazhimin e të rinjve për paqe dhe siguri dhe për parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm", shtator 2017, <https://static.globalinnovationexchange.org/s3fs-public/asset/document/Peace%20and%20Security%20Brief%209-21-17%20PRINT%20FINAL-OK.pdf?dV0v5HTaHk3AnPea6AL3145G5XblJ2A0>.

**Programet parandaluese** janë programe të projektuara për t'i bërë komunitetet rezistente ndaj EDhRÇT-së dhe për të rritur kohezionin shoqëror kundër mesazhit tërheqës të EDhRÇT-së. Këto programe që synojnë komunitetet që nuk janë të radikalizuara për ushtrim dhune, paraqiten në forma të ndryshme. Për shembull, ato mund të përfshijnë ligjërata për paqe dhe tolerancë; promovimin e të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes; trajnimin profesional dhe mentorimin; ngritjen e vetëdijes për kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm në shkolla dhe lagje; fushata të informimit publik dhe debate në komunitet për tema të ndryshme; dialog brenda një bashkësie fetare dhe dialog ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare; programe për fuqizimin e të rinjve dhe grave; ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe të drejtuesve të komunitetit për t'u angazhuar në përpjekjet e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së; mesazhe përmes mediave dhe fushatave me kundërnarrativa; si dhe ndërtimi i besimit mes komuniteteve dhe organeve ligjzbatuese. Në kontekstin e shëndetit publik, kjo njihet si “parandalim primar”.

**Programet e ndërhyrjes** zakonisht merren me grupet e rrezikuara dhe tentojnë të ndërhyjnë në rrugën e një personi drejt radikalizimit terrorist përpara se ai të ketë kryer ndonjë krim. Programet që i përkasin kësaj kategorie njihen ndonjëherë edhe si “rrugë dalëse” ose “programe dalëse”. Këto programe janë zakonisht mbi baza vullnetare dhe përfshijnë dhënien e mbështetjes psiko-sociale, mentorimin, debatet teologjike/doktrinare, edukimin dhe trajnimin dhe mbështetjen për punësim, si dhe mekanizmat e referimit që janë edhe fokusi i këtij udhëzuesi.

Nga perspektiva e shëndetit publik, mekanizmat e referimit ose programet e ngjashme në fushën e ndërhyrjeve klasifikohen si “parandalim dytësor”. Këto programe projektohen për të identifikuar personat me rrezik të lartë të ekstremizmit të dhunshëm (të cilët paraqesin një ose më shumë faktorë rreziku për ushtrim dhune) dhe për t'i ndihmuar këta persona, duke adresuar sjelljet e tyre para se të ushtrorjnë realisht dhunë.<sup>18</sup>

18 Stevan Weine dhe të tjerët, *Shfrytëzimi i programit me synim parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit të dhunshëm: Një vlerësim formativ në Los Anxheles*, Universiteti i Illinoisit në Çikago dhe Universiteti i Kalifornisë, Los Anxheles, 2016, [https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/862\\_OPSR\\_TP\\_LA-Formative-Evaluation\\_180817-508.pdf](https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/862_OPSR_TP_LA-Formative-Evaluation_180817-508.pdf).

**Programet e rehabilitimit** kanë zakonisht për synim individët e radikalizuar që mund të ushtrojnë dhunë (duke përfshirë edhe autorët e akteve terroriste) dhe ndoshta familjet e tyre në faza të ndryshme të radikalizimit. Këto lloje programesh përfshijnë edhe programet e shkëputjes nga radikalizimi në burgje dhe programet e kujdesit pas arrestimit, të cilat fokusohen në rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprave terroriste dhe “luftëtarëve të huaj terroristë”, si dhe në rikthimin e tyre në shoqëri.<sup>19</sup> Disa programe ofrojnë aktivitete edukuese dhe trajnim profesional, këshillim, mundësi punësimi dhe dialog mbi ideologjitë relevante.

---

19 Një udhëzues i paradokohshëm i OSBE-së dhe ODIHR-it i përshkruan disa nga sfidat ligjore, konceptuale dhe të të drejtave të njeriut në adresimin e çështjes së “luftëtarëve të huaj terroristë”. Shih OSBE-në dhe ODIHR-in, *Udhëzime për adresimin e kërcënimeve dhe sfidave të “luftëtarëve të huaj terroristë” brenda kornizës së të drejtave të njeriut*, 2018, <https://www.osce.org/odihr/393503?download=true>.





# 3. Pyetjet kryesore në lidhje me mekanizmat e referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

## 3.1 Çfarë janë mekanizmat e referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së?

Mekanizmat e referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së janë zakonisht programe, platforma ose iniciativa që përfshijnë shumë agjenci me natyrë shumëdisiplinare, të cilat:

1. Përfshijnë përfaqësues nga një numër i madh agjencish komunale ose agjencish të tjera qeveritare, organizatash komunitare dhe OSHC që punojnë në disiplina të ndryshme, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, rininë, sportin dhe, nëse gjykohet me vend, edhe përfaqësues të policisë dhe institucioneve korrektuese;

2. Marrin referime nga anëtarët e komunitetit ose subjektet qeveritare për individë të identifikuar si më të predispozuar për t'u përfshirë në dhunë ekstremiste ose që janë në fazat e hershme të saj, por që ende nuk e kanë kaluar pragun kriminal;
3. Vlerësojnë faktorët e rrezikut, faktorët mbrojtës, si dhe pikat e dobëta të individit të referuar për të përcaktuar masat më të përshtatshme që duhen marrë; si dhe
4. Parashikojnë, ofrojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë ndërhyrjet e personalizuara ose planet mbështetëse që adresojnë faktorët e rrezikut dhe dobësitë e atyre që konsiderohen më të rrezikuar ose më të prekshëm nga EDhRÇT-ja dhe ndihmojnë individët e referuar, duke i drejtuar drejt një rrugë jo të dhunshme.

Këta mekanizma u dedikohen familjeve të shqetësuara ose anëtarëve të komunitetit që dyshojnë për radikalizimin e personave të caktuar. Në vend të thirrjes apo raportimit në polici, masa që mund të rrezikojnë ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme dhe të ashpra nga ana e tyre, mekanizmat e referimit ofrojnë një rrugë alternative. Këta mekanizma synojnë ndalimin dhe shmangien e procesit të radikalizimit që në fazat e hershme, duke mundësuar mobilizimin e palëve të interesit që mund të jenë në pozitë më të mirë “për të bërë ndërhyrje efektive dhe parandaluese, sepse kanë kompetenca të caktuara, ekspertizë, besueshmëri të perceptuar ose legjitimitetin që nuk e ka policia”.<sup>20</sup> Ato mund të ndihmojnë në zvogëlimin e këtij dallimi kur identifikohet ndonjë rast shqetësues, por kur veprimi i organeve ligjzbatuese nuk është i përshtatshëm për shkak se individi nuk dyshohet të ketë kryer ndonjë krim dhe kur përfshirja e organeve ligjzbatuese mund të jetë bllokuese.

Mekanizmat e referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së kanë për qëllim të plotësojnë programet ose politikat për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, bazuar në grupe të gjera ose të fokusuara komunitare, si dhe të përcaktojnë masat e synuara kundër terrorizmit, bazuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në zonën e OSBE-së janë ngritur një sërë mekanizmash referimi. Disa drejtohen nga qeveritë - kombëtare ose lokale - ndërsa të tjera nga organizatat joqeveritare (OJQ). Disa drejtohen nga strukturat policore, ndërsa në disa të tjera këto struktura përfshihen pak ose aspak. Disa fokusohen vetëm në parandalimin e EDhRÇT-së, ndërsa disa të tjera e përfshijnë EDhRÇT-në si një nga format e ndryshme të dhunës.

20 OSBE, *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*.

Disa mekanizma konsistojnë në ekipe që funksionojnë në distancë, ndërsa të tjerë funksionojnë në mënyrë të integruar; disa funksionojnë në një zyrë të caktuar e disa mbliidhen sipas nevojës për adresimin e kërcënimeve konkrete që mund të paraqiten.

Në parim, mekanizmat e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së kanë disa elementë të përbashkët:<sup>21</sup>

1. Pjesëmarrjen vullnetare;
2. Mekanizmat e referimit mbështeten në vlerësimin e rrezikut ose në mjete të tjera të ngjashme për vlerësimin e nevojave dhe ndryshimit në sjellje që referohen në mekanizëm dhe që i nënshtrohen planit të mbështetjes; këto vlerësime bëhen zakonisht nga profesionistë të profilizuar;
3. Mekanizmat e referimit përfshijnë aktorë nga shumë disiplina dhe/ose agjenci qeveritare – dhe, për pasojë, ato kërkojnë kanale të reja koordinimi dhe protokolle për shkëmbimin e informacionit;
4. Natyra shumëdisiplinare e mekanizmave të referimit lejon adresimin e ndërhyrjeve të përshtatura ose planeve me mbështetje të gjerë kundrejt faktorëve që i bëjnë disa njerëz të predispozuar ndaj EDhRÇT-së; dhe
5. Efektiviteti i tyre varet nga përkushtimi, aftësitë dhe përvoja e anëtarëve të përfshirë në adresimin e rasteve/individëve të referuar, si dhe nga niveli i ndërveprimit midis profesionistëve dhe agjencive të përfshira në mekanizëm, si dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe ndërveprimit me komunitetet lokale.

## 3.2 Cilat janë modelet e ndryshme të mekanizmave të tillë?

Pavarësisht disa karakteristikave të përbashkëta në funksionimin e mekanizmave të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, ato mund të ndryshojnë nga forma dhe madhësia. Këto dallime mund të lidhen me strukturën e mekanizmit (mekanizma që funksionojnë nga lart-poshtë<sup>22</sup> dhe mekanizma që funksionojnë në nivel lokal<sup>23</sup>); me zbatuesit kryesorë

21 Peter Neumann, *Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Ide, Rekomandime dhe Praktika të Mira nga rajoni i OSBE-së*, Peter Neumann, 28 shtator 2017, <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

22 Shih, për shembull, programin Channel të Mbretërisë së Bashkuar, <https://www.gov.uk/government/publications/channel-guidance>.

23 Shih, për shembull, Florian Qehaja, Skënder Perteshi dhe Mentor Vrajolli, *Përcaktimi i gjendjes së përfshirjes së institucioneve dhe të komunitetit në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë*, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, shkurt 2017, <http://www.qkss.org/en/Reports/Mapping-the-state-of-play-of-stitutional-and-community-involvement-in-counterling-violent-extremism-in-Kosovo-864>.

(që mund të jenë subjekte shtetërore që operojnë në nivel kombëtar, bashki/komuna apo autoritete të tjera lokale, organe lokale ligjzbatuese ose OJQ); me llojin e ofruesve të shërbimeve lokale dhe partnerëve të tjerë të përfshirë (si p.sh. mësues, punonjës socialë, profesionistë të shëndetit mendor, profesionistë që punojnë me të rinjtë, drejtues fetarë dhe drejtues të tjerë të komunitetit, OSHC dhe policia); me fokusin e strukturës (pra, nëse fokusohen vetëm tek parandalimi i terrorizmit<sup>24</sup> apo më gjerë, tek të gjitha format e dhunës).<sup>25</sup> Si rregull, shërbimet e fshehta informative nuk janë partnerë standard, por ata angazhohen në rrethana të caktuara dhe të kufizuara, duke vendosur rast pas rasti.

Vendet pjesëmarrëse të OSBE-së, si Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Finlanda, Franca, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia dhe Mbretëria e Bashkuar kanë platforma referimi, ku marrin pjesë shumë agjenci. Shumë prej këtyre programeve organizohen në nivel bashkie/komune ose në forma të tjera lokale, aty ku gjenden shumica e ofruesve të informacionit dhe realizuesve të ndërhyrjeve. Mekanizmat e referimit mund të gjenden të përshkruar përmes disa termave, si p.sh., “tryeza të dedikuara situatave konkrete” (Kanada), “info-shtëpitë” (Danimarkë), “shtëpitë e sigurisë” (Holandë), “tryezat partnere” (Belgjikë) dhe “panelet” (Mbretëria e Bashkuar).

### 3.3 Cilat janë disa prej përfitimeve nga përdorimi i mekanizmave të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së?

Si pjesë të ndërhyrjeve gjithëpërfshirëse, mekanizmat e referimit për trajtimin e rasteve/individëve që shfaqin sjellje apo prirje për EDhRÇT-së, ofrojnë disa përfitime në parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Këta mekanizma përmirësojnë përpjekjet e shumë aktorëve për të ndihmuar në identifikimin e individëve me prirje për EDhRÇT dhe garantojnë mbështetjen e nevojshme që në fazat e hershme për parandalimin dhe përgjigjen ndaj radikalizimit drejt dhunës. Mekanizmat e referimit mundësojnë mobilizimin e aktorëve lokalë që janë në pozitë më të mirë për të ofruar ndërhyrje efektive dhe parandaluese falë aftësive të veçanta, ekspertizës, besueshmërisë së perceptuar,

24 Komisioni Evropian, “Modeli Aarhus: Parandalimi i Radikalizimit dhe i Diskriminimit në Aarhus”, [https://ec.europa.eu/home-affairs/node/7423\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/node/7423_en).

25 Shih, për shembull, FOCUS-Toronto, <https://www.toronto.ca/community-people/public-safety-alerts/community-safety-programs/focus-toronto/>.

ose legjitimitetit të munguar të policisë apo aktorëve të tjerë. Siç theksohet në udhëzuesin e OSBE-së për policimin në komunitet, këta mekanizma “kapërcejnë pengesat në identifikimin e rasteve shqetësuese që duhen adresuar në mënyrë proaktive kur veprimi i organeve ligjzbatuese nuk justifikohet ose kur përfshirja e policisë mund të vlerësohet si bllokuese ose jondihmuese”.<sup>26</sup>

Në këtë aspekt, mobilizimi i këtyre aktorëve vlerësohet i rëndësishëm për adresimin e pengesave të identifikuara. Siç theksohet në memorandumin “Praktikat e mira Rabat-Washington”, botuar nga Forumi Global kundër Terrorizmit (FGKT) në shtator 2018 (*i cili rekomandon krijimin e mekanizmave shumëdisiplinarë të referimit nga shtetet anëtare*), ka pasur raste kur familjet, mësuesit apo punonjësit socialë kanë vërejtur shenja të radikalizimit që çojnë drejt dhunës dhe i kanë raportuar dyshimet e tyre pranë autoriteteve lokale, por nuk është ndërmarrë asnjë veprim i mëtijshëm për adresimin e këtyre rasteve. Në situata të tjera, anëtarët e familjes kanë vendosur të mos i raportojnë dyshimet e tyre për shkak të frikës nga kundërpërgjigjet e ashpra të organeve ligjzbatuese.<sup>27</sup>

Nëse mekanizmat e referimit projektohen siç duhet - duke përfshirë hartimin e procedurave të qarta të referimit ndaj strukturave ligjzbatuese për raste të jashtëzakonshme (p.sh. kur ekziston një rrezik i menjëhershëm për shkak të dëmi) - ofrojnë mjaft përfitime:

1. Rritjen e mundësisë që familjet dhe anëtarët e tjerë të shqetësuar të komunitetit t'i referojnë individët që shfaqin shenja radikalizimi drejt EDhRÇT para se këta individë të përfshihen në akte dhune;
2. Ndërtimin e besimit mes komuniteteve dhe qeverisë;
3. Nxitjen e përfshirjes së një spektri profesionistësh, të cilët mund të ngurrojnë të angazhohen me iniciativën e tyre në ndërhyrje politikisht të ndjeshme që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm;
4. Promovimin e qasjes multidisiplinare dhe mundësimin e shkëmbimit të informacioneve mes agjencive dhe organizatave të ndryshme për individët e referuar (brenda parametrave të mbrojtjes së të dhënave dhe standardeve të privatësisë);
5. Ofrimin e një vlerësimi rreziqesh të pështatur sipas aktiviteteve të personave të prekshëm dhe nevojave të tyre, në krahasim me programet e tjera të ndërhyrjes për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së me një palë të vetme të interesuar; dhe ►

26 OSBE, *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*, fq. 165-166.

27 Forumi Global kundër Terrorizmit (FGKT), *Iniciativa për ta adresuar terrorizmin e zhvilluar në vend: Praktikat e mira të Rabat-Washington mbi Parandalimin, Zbulimin, Ndërhyrjen dhe Reagimin ndaj Terrorizmit të zhvilluar në vend*, shtator 2018, fq. 1. [https://www.thegcft.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Rabat-Washington-Good-Practices\\_ENG.pdf?ver=2018-09-21-122245-707](https://www.thegcft.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Rabat-Washington-Good-Practices_ENG.pdf?ver=2018-09-21-122245-707).

6. I mundësojnë individit të referuar që të shfrytëzojë një gamë shërbimesh të ndryshme, duke e rritur aftësinë e tij/ saj për të përfituar nga një plan gjithëpërfshirës mbështetjeje, krahasuar me ndërhyrje të zbatuara nga një agjenci apo organizatë. Me këtë pranohet fakti se procesi i radikalizimit drejt dhunës është i ndërlikuar dhe se asnjë agjenci apo organizatë nuk është në gjendje që të trajtojë e vetme çdo rrezik të shumëfishtë, ose të zvogëlojë faktorët e rrezikut.

Mosadresimi i rreziqeve të ndërlidhura gjatë krijimit të mekanizmave të referimit mund të shkaktojë dëme afatgjata dhe të ndikojë negativisht mbi problemin.

## 3.4 Në cilat kontekste të tjera përdoren mekanizmat e referimit dhe si mund të dallohen ata nga mekanizmat e përfshirë në parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm

Në kontekstin e krijimit të mekanizmave të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, është e rëndësishme të theksohen arsyet, qëllimet dhe format e ndryshme të tyre. Zakonisht, ata janë përdorur kur ka pasur nevojë për një grup gjithëpërfshirës shërbimesh që përfshin agjenci dhe/ose disiplina të ndryshme për adresimin e nevojave të individëve të prekshëm.

### 3.4.1 Trafikimi i qenieve njerëzore

Në vitin 2004, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) hartoi një udhëzues për krijimin dhe zbatimin e **mekanizmave kombëtarë të referimit (MKR) në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbështetjen e viktimave**.<sup>28</sup> Elementi thelbësor i mekanizmave të tillë përfshin procesin e identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit

<sup>28</sup> OSBE dhe ODIHR, *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit - Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar: Doracak praktik*, 13 maj 2004, <https://www.osce.org/odihr/13967>. Ky doracak ofron udhëzime se si të dizajnohen dhe të zbatohen mekanizma dhe struktura të qëndrueshme për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe për mbështetjen e viktimave. Ai gjithashtu ofron udhëzime se si të monitorohet dhe të ndërtohet kapaciteti i mekanizmave dhe i strukturave të tilla. Doracaku është duke u përditësuar dhe është planifikuar të ribotohet në vitin 2019.

nga grupe shumëdisiplinare palësh të interesuara, kombëtare dhe lokale, qeveritare dhe joqeveritare, si dhe mundësimin e bashkëpunimit për garantimin e shërbimeve të specializuara për viktimat.

Ky udhëzues u bazua në Planin e Veprimit të OSBE-së për Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore. I miratuar nga Këshilli Ministror në vitin 2003, ky udhëzues rekomandonte që “shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së të krijojnë mekanizma kombëtarë referimi, duke ndërtuar partneritete mes shoqërisë civile dhe organeve ligjzbatuese, për krijimin e udhëzimeve për identifikimin e personave të trafikuar, krijimin e ekipeve ndërsektoriale dhe shumëdisiplinare për hartimin dhe monitorimin e politikave”.<sup>29</sup>

Siç përcaktohet në udhëzues, MKR-të

*janë korniza bashkëpunimi, përmes të cilave aktorët shtetërorë përmbushin detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, duke koordinuar përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile. Qëllimet themelore të një MKR-je janë sigurimi i respektimit të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe ofrimi në mënyrë efektive i shërbimeve për viktimat e trafikimit. Përveç kësaj, MKR-të mund të veprojnë për të ndihmuar në përmirësimin e politikave dhe procedurave kombëtare në një spektër të gjerë çështjesh që lidhen me viktimat, si rregullat e qëndrimit dhe riatdhesimit, kompensimin e viktimave dhe mbrojtjen e dëshmitarëve. MKR-të mund të krijojnë plane kombëtare veprimi dhe mund të vendosin standarde për të vlerësuar nëse janë përmbushur qëllimet.*<sup>30</sup>

Edhe pse MKR-të ndryshojnë për nga madhësia dhe struktura, udhëzuesi rekomandon që ato të “projektohen për ta formalizuar bashkëpunimin mes agjencive qeveritare dhe grupeve joqeveritare që merren me personat e trafikuar”. Në dallim nga mekanizmat e referimit që trajtojnë çështjet e EDhRÇT-së, me qasje lokale (edhe kur janë pjesë e një qasjeje kombëtare), mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar veprojnë në nivel kombëtar (dhe nganjëherë edhe lokal). Ato zakonisht udhëhiqen nga një koordinator kombëtar (shpeshherë zyrtar i lartë qeveritar) dhe një tryezë përfaqësuesish të lartë të agjencive qeveritare dhe shoqërisë civile, të cilët hartojnë rekomandime për politikat dhe procedurat kombëtare që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit.

29 OSBE, “Plani i Veprimit për Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, Seksioni V, Neni 3, korrik 2003.

30 OSBE dhe ODHR, *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit*, fq. 15.

### 3.4.2 Dhuna me bazë gjinore

Ka disa mekanizma referimi për **parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore (DhBGj)** dhe dhunës në familje, e cila, sikundër në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore, vlerësohet si problem shumëdimensional që kërkon përgjigje gjithëpërfshirëse, të koordinuara dhe të individualizuara.<sup>31</sup> Gratë si viktimat e dhunës me bazë gjinore kanë nevojat të shumta që lidhen me kujdesin shëndetësor, strehimin e sigurt, këshillimin psikosocial, mbrojtjen përmes urdhrave gjyqësorë dhe ndihmën juridike. Një agjenci e vetme qeveritare ose një OJQ e vetme nuk mund t'i ofrojë të gjitha këto shërbime e, për këtë arsye, nevojitet “një përgjigje shumësektoriale që koordinon të gjithë ofruesit e shërbimeve” për të ndihmuar “në garantimin e një mbështetjeje gjithëpërfshirëse për ata që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore”.<sup>32</sup> Në kontekste të tilla, në shumë vende në mbarë botën, janë ngritur sisteme referimi që i lidhin subjektet dhe mandatet e ndryshme përmes bashkëpunimit me qëllim mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të dhunës me bazë gjinore, parandalimin e DhBGj-së dhe ndjekjen penale të dhunuesve. Ata zakonisht përfshijnë organizata qeveritare, joqeveritare dhe, herë pas here, edhe organizata ndërkombëtare, profesionistë të tjerë dhe ofrues shërbimesh nga fusha e shëndetit mendor dhe shërbimeve sociale.

### 3.4.3 Mbrojtja e fëmijëve të preکشëm

Një tjetër fushë ku mekanizmat e referimit janë të zakonshëm është **mbrojtja e fëmijëve të preکشëm**.<sup>33</sup> Fëmijët dhe familjet e prekura nga dhuna, sëmundjet dhe vështirësitë e tjera përballen me probleme të shumta. Në raste të tilla, referimi përfshin “procesin e njohjes së rrezikut ose shqetësimit për një fëmijë ose një familje, duke vendosur për marrjen e masave të caktuara dhe ofrimin e informacioneve ose referimet e klientit pranë shërbimeve të identifikuar”.<sup>34</sup> Referimet zakonisht bëhen përmes linjave telefonike të ndihmës ose nga ofruesit e shërbimeve mes njëri-tjetrit.

31 Rrjeti WAVE dhe Qendra Evropiane e Informacionit kundër Dhunës (WAVE) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Zyra Rajonale për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, *Forcimi i Përgjigjeve të Sistemit Shëndetësor ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore: Paketë me burime*, <http://www.health-genderviolence.org/programming-for-integration-of-gbv-within-health-system/practical-steps-and-recommendations-for-in-0>. Për një pasqyrë të këtyre programeve në Ballkanin Perëndimor, shih UN Women, Programi Rajonal për Ndalimin e Dhunës ndaj Grave në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi, <http://eca.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/regional-programme-in-the-western-balkans-and-turkey>.

32 WAVE dhe UNFPA, *Forcimi i Përgjigjeve të Sistemit Shëndetësor ndaj Dhunës me Bazë Gjinore*.

33 Keetle Roelen, Siân Long, dhe Jerker Edström, *Rrugët drejt mbrojtjes - Mekanizmat e referimit dhe menaxhimi i rasteve për fëmijët e preکشëm në Afrikën Lindore dhe Jugore: Mësimet e nxjerra dhe mënyrat për të shkuar përpara*, Instituti i Studimeve Zhvillimore Qendra për Mbrojtjen Sociale, qershor 2012, <http://www.socialserviceworkforce.org/system/files/resource/files/Pathways%20to%20protection%20E2%80%93%20referral%20mechanisms%20and%20case%20management%20for%20vulnerable%20children%20in%20Eastern%20and%20Southern%20Africa.pdf>.

34 Agjencia për Ndihmë dhe Zhvillim e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID), PEPFAR dhe 4Children, “Mekanizmat e referimit për fëmijët e mbetur jetimë ose të predispozuar ndaj HIV-i (OVC)”, 2018, [https://ovcsupport.org/wp-content/uploads/2018/03/18OS-34655\\_ Referrals-Mech\\_FINAL.pdf](https://ovcsupport.org/wp-content/uploads/2018/03/18OS-34655_ Referrals-Mech_FINAL.pdf).



### 3.4.4 Mësime nga fushat e tjera

Edhe pse çdo mekanizëm referimi duhet të jetë specifik për kontekstin, duke vlerësuar fokusin, specifikat kulturore e shoqërore, kapacitetet dhe nevojat e komuniteteve dhe individëve përfitues, përvoja na jep disa rekomandime për t'u mbajtur parasysh në fazat e krijimit dhe funksionimit të mekanizmave të referimit të EDhRÇT-së si:

1. Investimet në mekanizmat e referimit duhet të plotësojnë mekanizmat ekzistues që shërbejnë për përcaktimin dhe realizimin e ndërhyrjeve ose planeve mbështetëse në ndihmë të personave të referuar; kjo përfshin agjencitë psiko-sociale, shërbimet këshillimore dhe mbrojtjen sociale;
2. Anëtarët e mekanizmit dhe komunitetet përkatëse duhet të kuptojnë qartë atë çka synon të arrijë programi; anëtarët e mekanizmit të referimit duhet të kuptojnë të gjithë njëloj funksionimin e këtij mekanizmi;
3. Mandatet dhe protokollet e qarta janë të rëndësishme pasi në to përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të mekanizmit dhe adresohen informacionet mes tyre;
4. Burimet financiare dhe njerëzore dhe zërat e dedikuar buxhetorë për mbështetjen dhe funksionimin e qëndrueshëm të mekanizmit janë të domosdoshme;
5. Nismat komunitare duhet plotësojnë shërbimet e individualizuara përmes mekanizmit të referimit; dhe
6. Nevojitet identifikimi dhe përcaktimi i një personi kontakti për lehtësimin e komunikimit brendapërbrenda mekanizmit dhe mes mekanizmit dhe individëve të prekur e familjeve të tyre.<sup>35</sup>

## 3.5 Perspektiva e shëndetit publik në investimet për parandalimin

Gjithnjë e më tepër po pranohet fakti se kundërvënia ndaj terrorizmit dhe parandalimi i tij nuk kufizohen vetëm me qasjet dhe mjetet tradicionale të zbatimit të ligjit dhe ndjekjes penale. Përkundrazi, ato duhet të plotësohen me përpjekje gjithëpërfshirëse dhe parandaluese, ku të angazhohen aktorë nga autoritetet vendore joligjzbatuese dhe nga shoqëria civile, të cilat përfshijnë partneritete të gjera mes tyre (autoritetet qeveritare dhe shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal). Qëllimi i këtyre përpjekjeve nuk duhet të jetë vetëm ndërtimi i shoqërive dhe komuniteteve të qëndrueshme ndaj EDhRÇT-së, por edhe orientimi i individëve të rrezikuar dhe të predispozuar për EDhRÇT-së drejt një rruge paqësore.

35 Po aty.

Me njohjen dhe vlerësimin e shkallës së dëmit që mund të shkaktojë EDhRÇT-ja në shoqëri, krahasuar me atë çfarë shkakton një ekstremist i vetëm apo një sulm terrorist, qasjet parandaluese ndaj EDhRÇT-së po evidentojnë gjetje që lidhen me shëndetin publik, si një mundësi për promovimin e sjelljeve dhe mjediseve të shëndetshme. Mes tyre, theksohet rëndësia e identifikimit të ndërhyrjeve praktike mbrojtëse për menaxhimin e kërcënimeve të mundshme me ndikim në jetën e përditshme të individëve.<sup>36</sup> Perspektiva e shëndetit publik ofron mundësi për programe shumëplanëshe, shmangie dhe reduktim të stigmës, si dhe shfrytëzim maksimal të burimeve në dispozicion (gjë që nuk përftohet nga qasjet e ndjekura nga strukturat ligjzbatuese). Këto burime përfshijnë profesionistët e shëndetit mendor, punonjësit socialë dhe punëtorët e tjerë të kujdesit shëndetësor, të cilët angazhohen gjithnjë e më shumë në reduktimin e dhunës në komunitetet e tyre.


Duke pasur parasysh këto përfitime, modeli i shëndetit publik me tre sisteme, i paraqitur në Figurën 1, ka gjetur zbatim në shumë ndërhyrje për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Siç është shpjeguar në raportin e Konsorciumit Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit të Universitetit të Merilendit (2016), parandalimi parësor përfshin:

*strategjitë komunitare që zbusin rrezikun e ndryshueshëm (p.sh. disponueshmërinë e mediave të dhunshme ekstremiste) dhe shfrytëzojnë faktorët mbrojtës (p.sh. mbështetjen e prindërve, rrjetin shoqëror, menaxhimin e pritshmërive, njohuritë fetare dhe arsimimin), të lidhura empirikisht ose teorikisht me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Parandalimi dytësor përfshin strategji të drejtuara drejt individëve, të identifikuar përmes karakteristikave që lidhen me rrezikun e lartë për ekstremizëm të dhunshëm, si ekspozimi ndaj ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm ose afërsia me ndonjë rrjet shoqëror të radikalizuar. Parandalimi terciar përfshin strategji të drejtuara drejt individëve që kanë pranuar përkrahjen e ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm ose janë në kontakt me ekstremistë të dhunshëm, por që nuk janë përfshirë në planifikimin apo kryerjen e akteve të dhunës.<sup>37</sup>*

36 Stevan Weine dhe David Eisenman, "Si mund t'i përmirësojë shëndeti publik iniciativat për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm", Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (START), Universiteti Merilend, 5 prill 2016, <https://www.start.umd.edu/news/how-public-health-can-improve-initiatives-counter-violent-extremism>.

37 Po aty.

Figura 1. Modeli i Shëndetit Publik për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm



Burimi: Jonathan Challengren e të tjerë, Kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Aplikimi i Modelit të Shëndetit Publik, udhëzuesi i parë. (Universiteti Xhorxhtaun, Qendra për Studime të Sigurisë, Grupi i Punës për Çështjet Kritike të Sigurisë Kombëtare, 2016), <http://georgetownsecuritystudiesreview.org/wp-content/uploads/2016/10/NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.pdf>. Terminologjia e përdorur në figurë nuk përputhet domosdoshmërisht me atë të OSBE-së.

Mekanizmat e referimit të Parandalimit/Kundërvënies ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm që fokusohen në aktorë dhe veprimtari jokriminale gjenden në **hapësirën e parandalimit dytësor**. Ata kanë për qëllim nxitjen e identifikimit të shenjave të hershme të rrezikut nga familja, miqtë dhe mësuesit dhe garantimin e referimit pranë profesionistëve të trajnuar në agjencitë dhe organizatat e besueshme lokale (ofruesit e shërbimeve sociale dhe të shëndetit mendor), të cilët i ofrojnë ndihmën e duhur individit në rrezik para se ai/ajo të ushtrojë dhunë ekstreme.

## 3.6 Cili është roli i organeve ligjzbatuese?

Mekanizmat e referimit vihen në lëvizje për shkak të nevojave urgjente të sigurisë. Megjithatë, këta mekanizma duhet të demonstrojnë përkushtim dhe të kontribuojnë në ndërtimin e komuniteteve të shëndetshme dhe të qëndrueshme; në fund të fundit, EDhRÇT-ja nuk është thjesht një kërcënim ndaj sigurisë, por një fenomen shoqëror që, nëse mbetet i patrajtuar, mund të ketë ndikim të gjerë mbi individët, familjet, komunitetet dhe shoqëritë. Si të tillë, për të pasur sukses, mekanizmat e referimit mbështeten në një grup të larmishëm aktorësh nga komuniteti dhe aktorësh të tjerë që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese. Siç u tha më sipër, organet lokale ligjzbatuese mundet, në rrethana të përshtatshme, të luajnë rol në mekanizma të tillë. Në disa raste, policia mund të jetë burimi i shumicës së referimeve; për këtë dhe për arsye të tjera, mund të jetë e nevojshme që policia të përfshihet në vlerësimin e rreziqeve ose dobësive të individit të referuar për EDhRÇT. Megjithatë, roli i policisë, në rastet kur policia duhet të luajë një rol specifik, duhet të kalibrohet me kujdes, në bazë të një numri faktorësh, siç diskutohet në seksionin 4.2.





# 4. Sfidat dhe pasojat e mundshme negative

Bazuar në përvojën e shteteve anëtare të OSBE-së me krijimin e mekanizmave të referimit që merren me rastet e EDhRÇT-së mund të thuhet se funksionimi i këtyre mekanizmave kërkon adresimin e disa sfidave të rëndësishme për shmangien e një sërë pasojash të mundshme negative.

## 4.1 Krijimi i mbështetjes së komunitetit dhe shmangia e stigmës

Aktorët e përfshirë në krijimin e një mekanizmi referimi duhet të marrin parasysh nevojën për sigurimin e një mbështetjeje të gjerë të grupeve të ndryshme të interesit që konsiderohen thelbësore për suksesin e mekanizmit. Ky grup përfshin komunitetet, familjet, mësuesit, të rinjtë dhe punonjësit socialë, drejtuesit e komunitetit si mbështetje gjatë referimit të individëve në mekanizëm. Këtu përfshihen edhe agjencitë dhe organizatat që vlerësojnë rreziqet dhe nevojat e individëve të referuar, si dhe/ose identifikojnë dhe ofrojnë ndërhyrje të përshtatura, plane më të gjera mbështetëse dhe çdo mënyrë tjetër të përshtatshme veprimi.

Në vlerësim të këtyre sfidave, vëmendje duhet t'i kushtohet **objektit të aktivitetit** të mekanizmit dhe mënyrës së **prezantimit** të tij. Për shembull, aktorët e përfshirë në krijimin e tij duhet të shohin mundësinë e zgjerimit të fokusit të programit për të adresuar jo vetëm EDhRÇT-në, por të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm. Në fakt, fokusi mund të zgjerohet edhe më tej për të adresuar një grup më të gjerë çështjesh të lidhura me dhunën dhe/ose çështje të masave mbrojtëse që paraqesin shqetësim për komunitetin përkatës.

Një program me bazë të gjerë ka mundësi të pranohet më shumë se një program që fokusohet vetëm tek EDhRÇT-ja, duke përcjellë në këtë mënyrë stigmën dhe rrezikun e shtuar ndaj individëve të një feje të caktuar, të një grupimi etnik, të një grupim tjetër identiteti, të etiketimit të tyre si “të radikalizuar”, “ekstremistë të dhunshëm”, ose “terroristë”.<sup>38</sup>

Një qasje e tillë mund të krijojë hezitim tek familjet për shkak të stigmës që krijohet përmes një rasti të mundshëm të EDhRÇT-së pranë mekanizmit; e, për pasojë, mosreferim të individëve që shfaqin shenja rreziku për ekstremizëm të dhunshëm apo terrorizëm ose që janë të predispozuar ndaj tyre. Për më tepër, kjo qasje i ofron mundësi më të mirë mekanizmit që të shfrytëzojë institucionet dhe ekspertizën ekzistuese, veçanërisht shërbimet e shëndetit mendor dhe të mbrojtjes sociale, të cilat mund të jenë më pak të gatshme të marrin pjesë në një mekanizëm që perceptohet si një lloj forme për garantimin e “sigurisë” së një komuniteti të caktuar dhe ku një pjesëmarrje e tillë mund ta dëmtojë punën e tyre.<sup>39</sup>

Po kështu, vendimi në lidhje me prezantimin e kësaj nisme bëhet në bazë të informacioneve që tregojnë për shkallën e mbështetjes, të pjesëmarrjes dhe të besimit reciprok të palëve relevante të interesuara.

Një tjetër mënyrë për të shmangur stigmatizimin dhe për të garantuar mbështetjen nga komuniteti të një mekanizmi referimi lidhet me masat që duhen marrë për adresimin e problemeve dhe nevojave të **individëve të predispozuar për EDhRÇT më shumë sesa thjesht të individëve që i shprehin bindjet ideologjike, politike ose fetare si të drejta themelore.**

Është thelbësore të bëhet dallimi efektiv ndërmjet këtyre dy grupimeve, gjë që përfshin disa hapa:

38 Qendra e Ekselencës së Rrjetit të Vetëdijesimit për Radikalizimin të BE-së (RVR), “Doracak mbi mënyrën e krijimit të një strukture me shumë agjenci që përfshin sektorët e kujdesit shëndetësor dhe social”, 18-19 maj 2016, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/fran-papers/docs/ex-post-paper-handbook-ran-hsc-18-19-may-2016-copenhagen-dk\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/fran-papers/docs/ex-post-paper-handbook-ran-hsc-18-19-may-2016-copenhagen-dk_en.pdf).

39 Kjo qasje konsiderohet si një “praktikë e mirë” e FGKT-së. Praktika e mirë 5 në Praktikën e mira mbi Parandalimin, Zbulimin, Ndërrhyrjen dhe Reagimin ndaj Terrorizmit të zhvilluar në vend të Rabat-Washington parashikon që Shtetet mund të duan t’i përfshijnë çështjet e EDhRÇT-së në programe dhe strategji të gjera të parandalimit të krimit që “inkurajojnë bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe organeve ligjzbatuese për të adresuar shqetësimet e sigurisë të qytetarëve. . . . Kjo qasje mund të ndihmojë në shmangjen e dublikimit të shërbimeve, optimizimin e përdorimit të burimeve dhe forcimin e sigurisë. Gjithashtu, hartimi i programeve dhe i shërbimeve si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për trajtimin e kriminalitetit, mund të ndihmojë në zvogëlimin e stigmatizimit që shoqëron shpeshherë aktivitetet e terrorizmit dhe mund ta rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve, aty ku është e përshtatshme. Përveç kësaj, përfshirja e veprimtarive anti-terroriste si pjesë e një programi më të madh kundër krimit mund të ndihmojë për të inkurajuar angazhimin e aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë anëtarët e komunitetit lokal, si dhe sektorin privat”. Shih FGKT, *Iniciativa për ta adresuar terrorizmin e zhvilluar në vend*.



1. Ngritjen e vetëdijes së komuniteti përkatës për shenjat e mundshme të paralajmërimit të hershëm mbi rrezikun e prirjeve të individëve për EDhRÇT dhe për të mirat e referimit të këtyre individëve në mekanizëm;<sup>40</sup>
2. Kryerjen e një vlerësimi paraprak në lidhje me qartësinë e rasteve të referuara që prej fillimit<sup>41</sup>; ky vlerësim do të mundësonte shfrytëzimin e burimeve njerëzore dhe financiare të mekanizmit për ata individë që duhet të përfitojnë ndërhyrje apo mbështetje prej tij. Me qëllim sigurimin e një trajtimi të vazhdueshëm të rasteve, ky vlerësim mund të kryhet nga i njëjti specialist ose nga një zyrë e vetme;
3. Konsolidimin e mjeteve (ose mbështetjen e atyre ekzistuese) dhe kriterëve të reja për anëtarët e mekanizmit të referimit në vlerësimin e rreziqeve dhe nevojave që paraqesin individët e referuar, duke përdorur faktorët e rrezikut dhe ata mbrojtës. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të sigurohet që çdo mjet i tillë të ketë të integruar edhe perspektivën gjinore (për vlerësimin e roleve gjinore), për shmangien e çdo profilizimi të mundshëm apo çdo formë diskriminuese, të ndaluara nga e drejta ndërkombëtare<sup>42</sup>;
4. Marrjen e masave për trajnimin e duhur dhe garantimin e përvojës përkatëse për profesionistët e përfshirë në vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, në mënyrë që të garantohet përdorimi i drejtë i mjeteve vlerësuese dhe të mundësohet sa më shumë shmangia nga përdorimi i “listave të kontrollit” gjatë vlerësimit;<sup>43</sup>
5. Garantimin e shërbimeve dhe mbështetjes financiare për adresimin e nevojave të ndryshme të individëve të referuar për vlerësim; dhe
6. Shmangien e trajtimit të individëve të referuar si terroristë të mundshëm ose të dyshuar.

40 Praktika e mirë 4 e Praktikave të mira të Rabat-Uashington të FGKT e përforcon këtë pikëpamje. Ajo njeh faktin se si anëtarët e komunitetit “mund të vërejnë shenja të paralajmërimit të hershëm dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar në largimin e individëve nga rruga e radikalizimit drejt dhunës” dhe si mund të kenë nevojë subjektet relevante qeveritare dhe ato joqeveritare të rrisin angazhimin e tyre në komunitet dhe të rrisin aktivitetet e vetëdijesimit të komunitetit për rreziqet potenciale dhe shenjat paralajmëruese të EDhRÇT-së.

41 Në shkencat shoqërore, rasti i “rrejshëm pozitiv” është një gabim në raportimin e të dhënave, në të cilin rezultati i testit tregon në mënyrë të gabuar praninë e një gjendjeje, kur në realitet ajo nuk është e pranishme.

42 Rezoluta nr.2396 (2017) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Siç është diskutuar më vonë në udhëzues, dhe siç njihet nga Grupi i Punës për Kujdesin Shëndetësor dhe Social të RVR-së të BE-së dhe ekspertët e tjerë, ka shumë pak (në qoftë se ka) mjete për vlerësimin e rreziqeve që janë specifike për EDhRÇT-në që janë testuar. Zakonisht, mjetet e vlerësimit të rrezikut si për terroristët, ashtu edhe për autorët e veprave të ekstremizmit të dhunshëm në ambient burgu zbatohen në hapësirën jopenale, parandaluese. Shih RVR e BE-së, “Vlerësimi i rrezikut për aktorët e vetëm”, Takimi i RVR H&SC i mbajtur më 11-12 dhjetor 2017 në Mehelen të Belgjikës, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran\\_h-sc\\_risk\\_assessment\\_lone\\_actors\\_11-12\\_12\\_2017\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_h-sc_risk_assessment_lone_actors_11-12_12_2017_en.pdf)

43 Këshilli i Sigurimit i OKB-së, Komiteti kundër terrorizmit, *Shtojca e vitit 2018 për Parimet Udhëzuese të Madridit të vitit 2015*, *Parimi Udhëzues 5*, [https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/12/2018-Addendum-to-the-2015-Madrid-GuidingPrinciples\\_as\\_adopded.pdf](https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/12/2018-Addendum-to-the-2015-Madrid-GuidingPrinciples_as_adopded.pdf).

## 4.2 Përcaktimi i rolit të përshtatshëm të organeve ligjzbatuese

Siç theksohet në udhëzimin e OSBE-së për qasjen e policimit në komunitet në adresimin e EDhRÇT-së, parandalimi/kundërvënia ndaj EDhRÇT-së kërkon përgjigje të sofistikuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila duhet të përfshijë jo vetëm veprimin efektiv të drejtësisë penale (në respektim të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit) ndaj atyre që nxisin dhe rekrutojnë për akte terroriste; përkundrazi, kjo qasje duhet të ketë dhe përpjekje shumëdisiplinare për parandalimin e sjelljeve radikale që çojnë në dhunë.<sup>44</sup> Në këtë udhëzues theksohet roli kryesor i policisë në përgjigjen e drejtësisë penale ndaj EDhRÇT-së, si një rol i **përcaktuar me kujdes, në përpjekje proaktive parandaluese dhe në vlerësim të rrezikut për kriminalizim të sjelljeve dhe ideve jopenale, gjë që është e palejueshme**. Ky rol bëhet veçanërisht i rëndësishëm gjatë procesit të mbledhjes së deklaratave ndaj atyre individëve të dyshuar dhe shmangies së fajësimit të një komuniteti të tërë.

Policia mund të jetë e para në identifikimin e individëve të rrezikuar për t'u përfshirë në radikalizimin e dhunshëm (individë që ende nuk kanë kryer asnjë krim) për shkak të referimeve të mësuesve apo anëtarëve të shqetësuar të familjes. Megjithatë, punonjësit e policisë zakonisht nuk kanë trajnimin e duhur për t'u përfshirë në hapësirën jopenale (duke përfshirë edhe aspektin e kujdesit psikosocial). Për më tepër, përfshirja e tyre aktive në programe dhe sidomos drejtimi i këtyre programeve me natyrë jopenale mund të cenojë besueshmërinë dhe efektivitetin e tyre.

Për shembull, në varësi të kontekstit lokal, anëtarët e familjes mund të vendosin të mos raportojnë dyshimet e tyre në një mekanizëm që udhëhiqet nga policia, duke dashur të mbrojnë të afërmit e tyre, të rrezikuar nga hetimi policor ose duke dashur shmangien e stigmës brenda komuniteteve. Me pak fjalë, mundësia e referimit për trajtimin e individëve të rrezikuar pranë mekanizmave në të cilët marrin pjesë strukturat policore, mund të reduktohet për shkak të frikës së hetimit dhe ndjekjes penale ndaj këtyre sjelljeve radikale.<sup>45</sup>

Në praktikë, **roli i policisë në mekanizma të tillë ndryshon** në varësi të shumë faktorëve, si për shembull:

<sup>44</sup> OSBE, *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*.

<sup>45</sup> Instituti i Uashingtonit për Politikën e Lindjes së Afërt Mposhtja e ekstremizmit të dhunshëm të frymëzuar ideologjikisht: *Strategji për të ndërtuar të komunitete të forta dhe për ta mbrojtur shtetin amerikan*, mars 2017, <https://www.washingtoninstitute.org/uploads/Documents/pubs/Transition2017-CVE-6.pdf>.

1. Niveli i besimit ndërmjet organeve ligjzbatuese dhe komuniteteve lokale, veçanërisht në komunitete që janë përballur me sfida apo konflikte ndërmjet shumicës dhe pakicës;
2. Numri i përvojave negative që komuniteti ka pasur me policinë, veçanërisht kur ajo dekurajon pjesëmarrjen e profesionistëve nga organet joligjzbatuese, për shkak të elementëve të shumtë të sigurisë;
3. Pengesat në bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe komunitetit për shkak të ndërmarrjes së veprimeve hetuese penale në hapësirën jopenale dhe mundësia e stigmatizimit dhe diskriminimit të këtyre komuniteteve. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme në rastet e funksionimit të një mekanizmi referimi që lidhet me EDhRÇT-në në kontekste të vështira komunitare, sidomos pas konflikteve;
4. Vlerësimi i nivelit të decentralizimit të organeve ligjzbatuese në një komunitet të caktuar dhe zbatueshmëria e parimeve të policimit në komunitet.
5. Roli që kanë luajtur historikisht forcat e policisë në organizimin e takimeve ndërmjet aktorëve qeveritarë (që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese) dhe aktorëve të komunitetit;
6. Ekzistenca e protokollëve transparentë për shkëmbimin e informacioneve për mbrojtjen e privatësisë së individit dhe të dhënave personale, si dhe reduktimi i shqetësimit të keqpërdorimit të të dhënave nga policia; dhe
7. Përcaktimi i saktë i procedurave të referimit të informacionit tek policia, (p.sh. përcaktimi qartë i rasteve kur ekziston rreziku i menjëhershëm dhe dyshimi i arsyeshëm për një akt të rëndë ose kur një raportim i tillë është i detyrueshëm ligjërisht).

Nuk ka një model të unifikuar që të përshkruajë përfshirjen e policisë në mekanizmat e referimit që trajtojnë rastet e EDhRÇT-së. Për shembull, në Danimarkë, Finlandë dhe Norvegji, policia luan rol qendror përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me shkollat, shërbimet sociale komunale dhe me ofruesit e shërbimeve të shëndetit mendor. Po kështu, çdo qytet në Holandë ka një “shtëpi sigurie”, ku zyrtarë të qeverisë lokale, shërbimet e mirëqenies sociale dhe agjencitë e strehimit, punonjësit që punojnë me të rinjtë dhe policia diskutojnë së bashku për individët që tërheqin vëmendjen. Pozicioni i policisë lidhet me referimin e informacionit tek autoritetet përkatëse nëse një individ i referuar paraqet kërcënim ndaj sigurisë kombëtare. Roli i kufizuar i policisë lehtëson marrëdhëniet me komunitetet fetare, drejtuesit e komunitetit dhe qendrat rinore. Shtëpitë e sigurisë kanë marrëveshje të nënshkruara ligjore me agjencitë pjesëmarrëse për shkëmbimin e informacionit me interes, duke kapërcyer barrierat ndërmjet profesionistëve që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese dhe policisë.<sup>46</sup>

46 OSBE, “Radikalizmi drejt Terrorizmit: Çfarë duhet bërë? Vepro herët”, Siguria e Komunitetit Numri 2/2015, <https://www.osce.org/magazine/211761>.

Në Mbretërinë e Bashkuar, pas marrjes së një referimi, policia ka përgjegjësi ligjore të vlerësojë nëse ekziston ndonjë lidhje me veprime terroriste apo jo; ajo gjithashtu, merr pjesë në procesin shqyrtues për këtë referim dhe për të shmangur gabimet apo qëllimet dashakeq të këtij referimi. Megjithatë, vendimi për referimin e mëtejshëm të rasteve që kalojnë fazën paraprake nuk merret nga policia, por nga i ashtuquajti “Paneli i Ndërhyrjeve” (*Channel, ang*), i cili përbëhet nga disa agjenci dhe kryesohet nga autoritete lokale (shih Shtojcën për përshkrimin e programit *Channel*). Strategjia kombëtare e parandalimit e Britanisë së Madhe “UK PREVENT” në të cilën përfshihet edhe ky program është në proces të pavarur shqyrtimi, si një formë e rëndësishme mbikëqyrjeje për ligjshmërinë e vlerësimit të rasteve.

Në Kanada, Shërbimi Policor i Torontos, diskuton mes të tjerash me shoqërinë civile dhe agjencitë e qeverisjes lokale mbi mekanizmin lokal të referimit që përfshin EDhRÇT-në, duke synuar të forcojë rolin që luajnë aktorë të tillë në këta mekanizma.<sup>47</sup> Në Edmonton, mosbesimi te policia nga ana e komunitetit somalez çoi në drejtimin e mekanizmit përkatës lokal nga një OJF, pavarësisht pjesëmarrjes së strukturave policore në vlerësimin e individëve të referuar. Po kështu, në Otava, pavarësisht iniciativës dhe drejtimit fillestar të programit “Tryezat e ndërhyrjes së hershme” (Multiagency Early Risk Intervention Tables - MERIT) nga ana e policisë, pas shtimit të veprimtarive që lidheshin me parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, drejtimin e këtij programi e ka marrë një punonjës social i cili ka arritur të adresojë me kujdes edhe këto çështje.<sup>48</sup> Ky ndryshim u bë pas një vlerësimi të hollësishëm të impaktit që mund të kishte tek besimi i komuniteteve kjo përfshirje nga strukturat e policisë.

Në Kalgari, policia lokale dhe shërbimet e mbrojtjes ngritën mekanizmin e referimit të njohur me emrin “ReDirect” (me fokus në rastet e EDhRÇT-së) në mbështetje të kërkesave të komunitetit mysliman. Gradualisht, strukturat policore kanë luajtur një rol të reduktuar, pavarësisht se shumica e referimeve ende vijnë nga policia.<sup>49</sup>

Në Montreal, Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë (QPRÇDh), një organizatë joqeveritare, vepron në mënyrë plotësisht të pavarur nga policia, për arsye të nivelit të ulët të besimit tek pjesëmarrja e policisë në hapësirën jopenale.

47 Shih FOCUS-Toronto.

48 Shërbimi Policor i Otavës, “Tryezat e ndërhyrjes së hershme me shumë agjenci” (Multiagency Early Risk Intervention Tables - MERIT), <https://www.ottawapolice.ca/en/news-and-community/MERIT.aspx>.

49 Peter Ottis, “Premtimet dhe kufizimet e përdorimit të programeve komunale të policimit në komunitet për t’iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm: Programi Re-Direct i Kalgari si studim rasti”, tezë masteri, Universiteti Norvegjez i Shkencave Jetësore, 2016, [https://brage.bibsys.no/xmlui/bitstream/handle/11250/2443196/The\\_Promises\\_and\\_Limitations\\_of\\_Using\\_Municipal\\_Community\\_Policing\\_Programs\\_to\\_Counter\\_Violent\\_Extremism.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://brage.bibsys.no/xmlui/bitstream/handle/11250/2443196/The_Promises_and_Limitations_of_Using_Municipal_Community_Policing_Programs_to_Counter_Violent_Extremism.pdf?sequence=1&isAllowed=y).

Kështu, kjo qendër ka përgatitur protokolle për transferimin e rasteve në polici; e, për pasojë, gjatë vitit 2017 numërohen 24 raste të tilla të transferuara në polici (nga 349 referime gjithsej).<sup>50</sup>

Nga shembujt e mësipërm arrihet në përfundimin se përfshirja aktive e organeve ligjzbatuese në mekanizmat e referimit që trajtojnë rastet e EDhRÇT-së garantohet në ato vende ku shkalla e besimit te policia është e lartë dhe ku parimet e policimit në komunitet mbrohen dhe respektohen nga strukturat policore. Atje ku ky besim mungon - gjë që shpesh ndodh në komunitete pas konflikteve të ndjeshme dhe përvojave negative lidhur me sigurinë - kjo përfshirje e policisë mund të mos mirëpritet. Për ta reduktuar këtë qasje, duhen parë disa mundësi. Për shembull, mund të ngrihet një mekanizëm, ku të paktën në fazën fillestare, nuk përfshihet policia, por mbështetet nga agjenci dhe organizata që gëzojnë besimin e komunitetit të synuar; nëse është e nevojshme dhe me vend, policia mund të përfshihet në një fazë të mëvonshme, kur mekanizmi të jetë në funksionim të plotë. Një tjetër mundësi do të ishte që të vendoset që në momentin e ngritjes së mekanizmit se sa do të përfshihet policia. Kjo do ta bënte të qartë se si do të bëheshin referimet nga organet ligjzbatuese, do të pengonte pjesëmarrjen e policisë në diskutimin e rasteve individuale, me përjashtim rasteve që përbëjnë rrezikshmëri të lartë për dhunë ose rrezik ndaj sigurisë kombëtare.<sup>51</sup>

## 4.3 Kapërcimi i pengesave që lidhen me normat dhe qëndrimet shoqërore rreth kujdesit psikosocial

Një ndër arsytet pse mekanizmat e referimit po bëhen një mjet gjithnjë e më popullor për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së është aftësia e tyre për të mbledhur një spektër të gjerë profesionistësh për vlerësimin e nevojave dhe dobësive, shpesh të ndërlikuara dhe të shumta ndaj individëve të predispozuar për t'u përfshirë në dhunë ekstremiste; si dhe ofrimin të shërbimeve të mëtejshme "të përshtatura" për adresimin e këtyre nevojave.

50 Qendra për Parandalimin e Radikalizimit drejt Dhunës, *Raporti vjetor: Parandalimi i radikalizimit që çon në dhunë*, 2017, fq. 3, <https://indd.adobe.com/view/0fd55b6b-49d4-4306-9a06-9b5619063b35>.

51 Kjo është qasja që zbatohet nga "Community Connect", mekanizmi i referimit që organizohet nga Spitali i Fëmijëve në Boston. Shih Eric Rosand, "Qasje multidisiplinare dhe me shumë agjenci për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Një histori suksesi që paraqitet në parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm", në Institutin për Ekonomi dhe Paqe, *Indeksi Global i Terrorizmit 2017: Matja dhe Kuptimi i Ndikimit të Terrorizmit*, 2018, fq. 72, <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/Global-Terrorism-Index-2018-1.pdf>.

Ekspertiza e shëndetit mendor, si dhe llojet e tjera të ekspertizës dhe mbështetjes psikosociale, e cila ofrohet goftë nga mjekët psikiatër, psikologët, këshilltarët familjarë apo specialistët e traumave, shpeshherë konsiderohet pjesë thelbësore e këtyre programeve.

Edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë shkak-pasojë midis sëmundjeve mendore dhe ekstremizmit të dhunshëm, ka prova që dëshmojnë se në shumë raste të rinjtë që radikalizohen deri në dhunë kanë aftësi jo të mira përshtatjeje psikologjike. Kjo mbështetet nga studimet e fundit. Për shembull, një analizë policore e 500 rasteve të trajtuara nga programi *Channel* i Mbretërisë së Bashkuar për vitin 2016 zbuloi se 44 për qind e individëve të studiuar u vlerësuan se mund të kishin dobësi të shëndetit mendor ose çrregullime psikologjike.<sup>52</sup> Për aspekte që lidhen me kujdesin shëndetësor dhe social, Grupi i punës i Rrjetit të Vetëdijësimit për Radikalizmin (RVR) i BE-së i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit që duhet të luajnë profesionistët e shëndetit mendor në këta mekanizma referimi.<sup>53</sup>

Ndonëse nevoja për ndërhyrje në aspektin e shëndetit mendor dhe përfitimet prej tyre në fushën e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së janë të njohura, barrierat kulturore për të kërkuar ndihmë profesionale nga këta profesionistë të shëndetit mendor ose të kujdesit social vazhdon të ekzistojë në disa shoqëri dhe komunitete. Krahas këtyre barrierave, është evidentuar edhe mungesa e gatishmërisë, kapacitetet e kufizuara të profesionistëve të shëndetit mendor për t'u angazhuar në rastet e EDhRÇT-së.

Barrierat kulturore, siç shpjegon psikiatri Stevan Weine, mund të ndryshojnë.<sup>54</sup> Ndër të tjera, ato mund të përfshijnë stigmën (për shkak të sëmundjeve mendore dhe kulturës); mungesën e njohurive (disa të rinj dhe familjet e tyre mund të mos i njohin fare shërbimet e shëndetit mendor dhe se si mund t'i adresojnë problemet e tyre); ose frikën (disa prindër mund të kenë frikë se fëmija i tyre do të “merret” nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve nëse ata shfrytëzojnë shërbimet e shëndetit mendor).

Barriera të tilla (nëse ekzistojnë) së bashku me komponentë të konsiderueshëm të shëndetit mendor (nëse ka) mund të rezultojnë sfidues në programet që fokusohen te parandalimi/kundërvënja ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm ose në mekanizma shumëdisiplinarë referimi.

52 Vikram Dodd, “Studimi i policisë lidh radikalizimin me problemet e shëndetit mendor”, *Guardian*, 20 maj 2016, <https://www.theguardian.com/uk-news/2016/may/20/police-study-radicalisation-mental-health-problems>. Sipas një ish-shefi të një ekipi lokal të programit PREVENT në Mbretërinë e Bashkuar, një pjesë e konsiderueshme e këtyre rasteve kanë të bëjnë me rastet e tipit të autizmit, ku disa janë të lidhura me skizofreninë, çrregullimin bipolar dhe kushtet e shëndetit mendor për shkak të abuzimit me substancat, ku të gjithë këta individë tashmë janë të njohur për agjencitë relevante të shëndetit mendor ose agjencitë e tjera mbështetëse për arsye të tjera që nuk kanë të bëjnë me radikalizimin, ekstremizmin e dhunshëm ose terrorizmin.

53 Po aty.

54 Stevan Weine dhe të tjerët, “Mbështetja e qasjes multidisiplinare ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Integrimi i shëndetit mendor në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe çfarë duhet të dinë organet ligjzbatuese”, START, Universiteti i Merilendit, 2015, <https://www.start.umd.edu/publication/supporting-multidisciplinary-approach-violent-extremism-integration-mental-health>.

Përpjekjet për kapërcimin e këtyre pengesave duhet të përfshihen, sipas mundësisë, në çdo strategji për ngritjen e një mekanizmi referimi për EDhRÇT-në.<sup>55</sup> Veçanërisht atje ku stigma shoqërore lidhet me trajtimin e shëndetit mendor, aktorët joformalë, si anëtarët e familjes, drejtuesit fetarë dhe drejtuesit e tjerë të komunitetit ose mentorët, kanë një rol të rëndësishëm në mekanizma të tillë, sidomos në komunitetet që mbështesin ndërhyrjet familjare, ndërhyrjet komunitare ose ndërhyrjet e drejtuara nga OJQ-të dhe jo ato që drejtohen nga aktorë qeveritarë.

## 4.4 Kapacitetet e kufizuara institucionale dhe nevoja për trajnim të specializuar

Në pjesën më të madhe, mekanizmat e referimit që merren me rastet e EDhRÇT-së në zonën e OSBE-së, shfrytëzojnë kapacitetet institucionale ekzistuese për adresimin e çështjeve të EDhRÇT-së, si ato të policisë, shërbimet e shëndetit mendor, mirëqenies sociale, agjencive të tjera qeveritare dhe OJQ komunitare dhe të tjera të përfshira në këto programe. Pavarësisht qëllimit të krijimit dhe funksionimit të mekanizmave të referimit apo shtimit të ndërhyrjeve ndaj EDhRÇT-së përmes programeve ekzistuese<sup>56</sup> shumëdisiplinare<sup>57</sup>, sfida kryesore qëndron tek garantimi i aftësive profesionale dhe efektivitetit të programeve të zbatuara nga profesionistë të trajnuar në fushën e EDhRÇT-së dhe/ose garantimi i shkallës së duhur të ndërgjegjësimit për trajtimin e duhur të rasteve të EDhRÇT-së.

Për shembull, profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me individët që rrezikojnë të radikalizohen derisa të bëhen të dhunshëm, duhet ta kuptojnë EDhRÇT-në, elementet e tij ideologjikë; predispozitat e mundshme; faktorët që i bëjnë individët, familjet dhe komunitetet më të qëndrueshëm ndaj EDhRÇT-së; si dhe ndërhyrjet e mundshme për adresimin e dobësive dhe për ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj këtij fenomeni. Këtyre profesionistëve mund t'u nevojitet trajnim për të komunikuar me anëtarët e familjeve; për të angazhuar të rinjtë që manifestojnë ndjenja të përjashtimit social, marxhinalizimit ose padrejtësisë; për të ndërmarrë vlerësime të rrezikut; ose për të dalluar simbolet që përdoren nga grupe të dhunshme ekstremiste për rekrutimin e anëtarëve të rinj.

55 RVR-ja e BE-së, *Deklarata e RVR-së për Praktikën e Mira për Angazhimin me Luftëtarët e Huaj për Parandalimin, Ofrimin e Ndihmës, Rehabilitimin dhe Riintegrimin*, 2014, <https://www.icct.nl/download/file/RAN-Declaration-Good-Practices-for-Engagement-with-Foreign-Fighters.pdf>.

56 Siç ishte rasti me iniciativën e tilla si Programi "Channel" i Mbretërisë së Bashkuar, "shtëpitë e sigurisë" në Hollandë, Rrjeti për Menaxhimin e Ekstremizmit dhe Radikalizimit të Dhunshëm në Belgjikë, dhe Qendra për Veprim dhe Parandalim kundër Radikalizimit në Bordo të Francës.

57 Shih, për shembull, programet në Danimarkë, Finlandë dhe Norvegji. Më shumë hollësi janë dhënë në shtojcën e këtij raporti.

E njëjta qasje trajnuese mund të përdoret edhe për profesionistët e shëndetit mendor në lidhje me mënyrën e realizimit të ndërhyrjeve të individët që kanë shenja dhe simptoma traume ose në konsultimet me drejtuesit fetarë ose me ekspertët e kulturave të ndryshme për ta kuptuar më mirë kontekstin e individit.<sup>58</sup> Punonjësit socialë mund të kenë nevojë për trajnim dhe njohuri për zhvillimin e bisedave të vështira; për të kuptuar dhe për të analizuar kulturat e ndryshme si bashkësi kuptimesh, ndikimesh dhe dallimesh; për të analizuar rreziqet dhe nevojat; si dhe për t'u angazhuar dhe mobilizuar në komunitete.<sup>59</sup> Anëtarët e komunitetit mund të kenë nevojë për udhëzime bazë në identifikimin dhe raportimin e shenjave të EDhRÇT-së.<sup>60</sup>

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për adresimin e këtyre nevojave të veçanta në të gjithë zonën e OSBE-së. Për shembull, **Qendra VINK (Njohuri - Integrim) në Kopenhagë** ofron trajnime dhe këshilla për mësuesit, punonjësit socialë dhe punonjësit e tjerë komunalë që janë në kontakt me individët e rrezikuar nga radikalizmi deri në dhunë. Kjo qendër ofron këshillime telefonike për mënyrat efektive të trajtimit të rasteve specifike. Dhjetë ekspertët e VINK-ut kanë krijuar përvojë në realizimin e ndërhyrjeve dhe në punën me të rinjtë e marxhinalizuar që shfaqin shenja të sjelljeve së dhunshme ekstremiste.<sup>61</sup>

Për plotësimin e një boshllëku të identifikuar në strategjinë kombëtare për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm të vitit 2015 të Suedisë, **Këshilli Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies i Suedisë** përgatiti një udhëzues për mbështetjen e punonjësve socialë, si punonjësit e vijës së parë që takohen dhe komunikojnë me të rinj të prekshëm nga radikalizmi që çon drejt dhunës.<sup>62</sup> Ky udhëzues i këshillon punonjësit të përdorin strukturat ekzistuese dhe jo të krijojnë të reja. Në të theksohet nevoja për njohuri specifike në lidhje me njohjen dhe analizën e sjelljeve të këtyre individëve; vendet ku mund të hasen sjellje të ekstremizmit të dhunshëm; si dhe simbolet, veshjet, sjelljet dhe mënyra e funksionimit të grupeve të dhunshme ekstremiste përkatëse.

58 Universiteti i Merilendit dhe Konsorciumi Kombëtar për Studimin e Terrorizmit dhe Përgjigjet ndaj Terrorizmit (START), "Mbështetja e qasjes multidisiplinare në adresimin e ekstremizmit të dhunshëm: Çfarë roli mund të luajnë profesionistët e shëndetit mendor?", tetor 2015, [https://www.start.umd.edu/pubs/START\\_LessonsLearnedfromMentalHealthAndEducation\\_MentalHealthSummary\\_Oct2015.pdf](https://www.start.umd.edu/pubs/START_LessonsLearnedfromMentalHealthAndEducation_MentalHealthSummary_Oct2015.pdf).

59 Partneriteti për Mbrojtjen e Fëmijëve i Hertfordshire (PMFH), "Roli i Punonjësit Social në Trajtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm", fq. 5. [http://hertsscb.proceduresonline.com/pdfs/role\\_së\\_violent\\_extreme.pdf](http://hertsscb.proceduresonline.com/pdfs/role_së_violent_extreme.pdf).

60 Anne-Sophie Hemmingsen, *Hyrje në qasjen daneze për t'iu kundërvënë dhe për ta parandaluar ekstremizmin dhe radikalizimin*, Instituti Danez për Studime Ndërkombëtare, 2015, <https://www.ft.dk/samling/20151/almdel/reu/bilag/248/1617692.pdf>.

61 Qyteti i Kopenhagës, "Më pak radikalizim përmes një përpjekjeje efektive dhe koherente: Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për Parandalimin e Radikalizimit", gusht 2015, <https://www.kk.dk/sites/default/files/uploaded-files/Abridged%20version.%20Less%20radicalisation%20through%20an%20effective%20and%20coherent%20effort..pdf>.

62 Komunikimi i qeverisë suedeze 2014/15:144, "Veprimet për ta bërë shoqërinë më të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm", 13 gusht 2015, <https://www.government.se/contentassets/ef243295e51d4635b4870963b18bfa89/actions-to-make-society-more-resilient-to-violent-extremism-2014-15-144.pdf>.



Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë (QPRÇDh), Montreal ka hartuar programe trajnimi për gjyqtarët, këshillat e shkollave dhe për institucionet komunale. Në këto trajnime ofrohen informacione për EDhRÇT-në dhe identifikohen përgjigjet e përshtatshme që mund të japin profesionistët përballë individëve që shfaqin shenja të EDhRÇT-së.<sup>63</sup>

Në **Mbretërinë e Bashkuar, Ministra e Punëve të Brendshme** ka hartuar një udhëzim për autoritetet lokale, praktikantët dhe profesionistët e përfshirë në panelet e programit “*Channel*”. Ndër të tjera, ky udhëzim shpjegon “se pse njerëzit mund të jenë të prekshëm ndaj përfshirjes në terrorizëm dhe përshkruan treguesit që mund të ndihmojnë në identifikimin e kësaj prirjeje”; ai ofron, gjithashtu, informacion mbi mbështetjen që mund të ofrohet për mbrojtjen e personave që rrezikojnë të bëhen pjesë e terrorizmit. Gjithashtu, janë hartuar udhëzime të fokusuara në sektorë të caktuar për mësuesit, punonjësit socialë dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor, si dhe trajnime *online* dhe trajnime të tjera për profesionistët e vijës së parë.<sup>64</sup> Investimet në trajnimin në lidhje me parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së-në për punonjësit socialë dhe për profesionistët e tjerë jashtë organeve ligjzbatuese, të përfshirë në programin “*Channel*”, bazohen në vlerësimin e përfitimeve që sjell përfshirja e punonjësve ose ekipeve sociale profesionale dhe të përkushtuara në trajtimin e rasteve të EDhRÇT-së.<sup>65</sup>

Në **Finlandë**, qeveria, në bashkëpunim me universitetet lokale, ka investuar në hartimin e udhëzuesve dhe trajnimeve për përmirësimin e aftësive të mësuesve, punonjësve socialë dhe shëndetësorë, si dhe anëtarëve të tjerë të ekipeve në nivel komunal përmes zbatimit të projektit “*Anchor*” për gjetjen dhe adresimin e shqetësimeve në lidhje me dhunën ekstremiste.<sup>66</sup>

Më gjerësisht, **grupet e punës së RVR-së** ofrojnë udhëzime dhe trajnime për sektorët e ndryshëm të punonjësve të vijës së parë, përfshirja e informuar dhe aktive e të cilëve në mekanizmat e referimit është kritike për aftësinë e tyre të vlerësimit të nevojave të individëve të identifikuar dhe të ofrimit të ndërhyrjeve të përshtatura për çdo individ.<sup>67</sup>

63 Qendra për Parandalimin e Radikalizimit drejt Dhunës, *Raporti vjetor: Parandalimi i radikalizimit që çon në dhunë*.

64 Për udhëzimet për punonjësit shëndetësorë dhe socialë në Mbretërinë e Bashkuar, shih NHS, “Korniza e Trajnimeve dhe Kompetencave të programit PREVENT”, 2017, <https://www.england.nhs.uk/wp-content/uploads/2017/10/prevent-training-competencies-framework-v3.pdf>; dhe Hertfordshire, “Roli i punonjësit social”.

65 Intervistë me e-mail me një ish-koordinator lokal të programit PREVENT në Mbretërinë e Bashkuar, janar 2019.

66 Ministria Daneze e Imigracionit dhe Integritimit, “Përpjekjet për ta parandaluar ekstremizmin në vendet nordike: Hartëzimi”, dhjetor 2017, <http://uim.dk/publikationer/efforts-to-prevent-extremism-in-the-nordic-countries/@@download/publication>.

67 Grupet e tilla të punës të RVR-së të BE-së i përfshijnë ato që janë të fokusuara te të rinjtë, familjet dhe komunitetet; autoritetet lokale; dhe në kujdesin shëndetësor dhe social. Shih Komisioni Evropian, Migracioni dhe Çështjet e Brendshme, “Grupet Punuese të RVR-së”, [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran_en).

Megjithatë, pjesa më e madhe e këtij trajnimi të specializuar për EDhRÇT-në zhvillohet në mjedise ku ekzistojnë tashmë kapacitetet themelore institucionale të agjencive ose të organizatave lokale (p.sh. shërbimet sociale dhe agjencitë e shërbimeve të shëndetit mendor); ku ka një histori pozitive bashkëpunimi midis shumë agjencive, duke përfshirë edhe bashkëpunimin midis organeve ligjzbatuese dhe atyre joligjzbatuese; si dhe atje ku ka të paktën një dozë besimi mes policisë lokale dhe komunitetit. Shtetet duhet të marrin në konsideratë çdo rast kur këto kapacitete mungojnë me qëllim plotësimin e tyre për mirëfunksionimin e mekanizmave të referimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së.

Për shembull, këta mekanizma kërkojnë kapacitete të caktuara në fushën e shëndetit mendor në nivel komunitar, për kryerjen e punës që bëhet në spitale ose në klinikat private psikiatrike; por në disa vende, këto kapacitete ose janë të kufizuara, ose nuk ekzistojnë fare. Edhe pse ndërtimi i një sistemi të tillë kërkon kohë dhe burime, si dhe përkushtim nga Ministria e Shëndetësisë (ose ministria ekuivalente), mund të ndërmerren hapa për krijimin e kapaciteteve të nevojshme në fushën e shëndetit mendor për mbështetjen e mekanizmave multidisiplinare të referimit. Këta hapa përfshijnë:

1. Identifikimin e një ekipi të vogël profesionistësh të shëndetit mendor ose krijimin e një njësie të lëvizshme që mund të operojë në disa bashki/komuna ose në një rajon të tërë, si dhe ofrimin e trajnimit dhe mentorimit për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së për ata profesionistë ose atë njësi që bën ndërhyrje në bazë;
2. Ndërtimin e një rrjeti profesionistësh të shëndetit mendor në rajon për të ndihmuar në identifikimin e dobësive të shëndetit mendor në komunitet dhe për projektimin dhe realizimin e ndërhyrjeve tek individët që shfaqin shenja dhe simptoma, aty ku është e përshtatshme. Anëtarët e trajnuar të këtij rrjeti mund të vendosen në baza *ad hoc* (aty ku ka nevojë) në mbështetje të përpjekjeve të një mekanizmi të caktuar. Për profesionistët e gatshëm të marrin rol drejtues në këto ekipe ose njësi të lëvizshme do të nevojitej një trajnim më i hollësishëm.<sup>68</sup>

Duke pasur parasysh stigmën e lartpërmendur në lidhje me shëndetin mendor dhe trajtimet e tjera psikosociale në disa komunitete apo ngurrimin e disa profesionistëve të shëndetit mendor për të marrë pjesë në iniciativat për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, çdo trajnim i tillë do të duhej të plotësohej me fushata ndërgjegjësuese të fokusuara tek komuniteti për të luftuar stigmën dhe paragjykimet. Projektimi i programeve komunitare për parandalimin e dhunës, të cilat përfshijnë edhe EDhRÇT-në si një prej çështjeve që trajtojnë, mund të ndihmojë në kapërcimin e hezitimit për të marrë pjesë në mekanizmat e referimit.

68 Intervistë me Stevan Weine, profesor i psikiatrisë, Drejtor i Mjekësisë Globale dhe Drejtor i Qendrës për Shëndetin Global, Universiteti i Illinoisit në Çikago, tetor 2018.





# 5. Çfarë duhet marrë parasysh gjatë zhvillimit të mekanizmave të referimit

Çdo mekanizëm referimi për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së duhet të projektohet me kujdes, duke marrë parasysh kontekstet përkatëse lokale, kulturore, shoqërore dhe historike. Megjithatë, siç paraqitet në kutizën e mëposhtme dhe siç përshkruhet në këtë pjesë të raportit, ekzistojnë një sërë elementesh dhe çështjesh të rëndësishme që duhet të merren parasysh gjatë zhvillimit dhe vënies në funksion të një mekanizmi të tillë.

## Rruga për zhvillimin e një mekanizmi referimi për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së

- ▶ Hartëzimi i kontekstit përkatës
- ▶ Shqyrtimi i objektit të punës dhe prezantimi i tij
- ▶ Qartësimi i mandatit, drejtimit, roleve dhe përgjegjësi
- ▶ Mundësimi i shkëmbimit efektiv të informacionit
- ▶ Garantimi i një pjesëmarrjeje të larmishme
- ▶ Garantimi i orientimit të duhur strategjik dhe mbikëqyrja e politikave
- ▶ Integrimi i perspektivës gjinore
- ▶ Përfshirja e shoqërisë civile
- ▶ Qartësimi i rolit të qeverisë qendrore
- ▶ Identifikimi i vendit dhe shpeshëtisë së mbledhjeve
- ▶ Operimi në nivel lokal
- ▶ Vlerësimi i burimeve dhe kostove
- ▶ Përfshirja e një procesi shqyrtimi sistematik të pavarur

## 5.1 Hartëzimi i kontekstit përkatës

Para se të merret një vendim për krijimin e një mekanizmi referimi, duhet të përgatitet harta e burimeve dhe kapaciteteve të institucioneve, organizatave dhe aktorëve relevantë që do të përfshihen në vënien në funksion të një mekanizmi të tillë për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së. Vendimi se çfarë forme duhet të ketë ky mekanizëm (p.sh. nëse do të udhëhiqet nga komuna/bashkia apo ndonjë OJQ) duhet të merret në bazë të informacioneve të përftuara nga hartëzimi i bërë.<sup>69</sup>

Në vend që të ndërtohet një mekanizëm referimi nga e para, projektuesit e tij duhet të identifikojnë çdo kornizë, program, institucion, marrëdhënie dhe kapacitet tjetër ekzistues të përshtatshëm. Në marrjen e këtij vendimi merret parasysh fakti se, sidomos kur burimet dhe kapacitetet institucionale mund të jenë të kufizuara apo kur EDhRÇT-ja mund të mos konsiderohet edhe aq prioritet në bashki/komuna, sa konsiderohet në shkallë vendi, krijimi i një mekanizmi të pavarur referimi për EDhRÇT-në mund të mos jetë rruga më efikase dhe më efektive.<sup>70</sup>

Hartëzimi duhet të përfshijë një sërë **konsultimesh me palët e interesuara** me qëllim që:

1. Të kuptohen pakënaqësitë dhe problemet që çojnë drejt EDhRÇT-së; komunitetet mbi të cilat ato ndikojnë; si dhe vetëdija ekzistuese në nivel komuniteti për këto dobësi. Kjo njohje ndihmon ata që mendojnë të ngrenë një mekanizëm referimi për identifikimin jo vetëm të dobësive të dukshme të EDhRÇT-së në komunitetet relevante, por edhe të faktorëve mbrojtës që duhen forcuar me qëllim zvogëlimin e atyre dobësive. Përveç kësaj, njohja e situatës e rrit mundësinë e përdorimit të mekanizmit nga anëtarët e komunitetit. Zakonisht, pavarësisht dëshirës dhe përpjekjeve të anëtarëve të komunitetit për të paraqitur referime në mekanizëm, shumica dërrmuese e referimeve vijnë nga profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me palët - e zakonisht kjo është policia;
2. Të shihet se cilat janë ndërhyrjet, programet dhe shërbimet ekzistuese në fushën e parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, duke përfshirë linjat telefonike; sa efektive janë ato; dhe cilat prej tyre janë në dispozicion për fëmijët e cilat për gratë dhe të rriturit;

69 Qendra e Ekselencës së RVR-së të BE-së, "Doracak për krijimin e një strukture me shumë agjenci që përfshin sektorin e shëndetësisë dhe të kujdesit social", Dokument Ex Post 18-19 maj 2016, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/ex-post-paper-handbook-ran-hsc-18-19-may-2016-copenhagen-dk\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ex-post-paper-handbook-ran-hsc-18-19-may-2016-copenhagen-dk_en.pdf).

70 Për shembull, Mbretëria e Bashkuar është duke bërë përpjekje për ta futur programin Channel në procese më të gjera dhe më kryesore.

3. Të shihet se cilët profesionistë dhe anëtarë të komunitetit (p.sh. punonjësit socialë, mësimdhënësit, punonjësit e kujdesit shëndetësor, drejtuesit fetarë, mentorët) janë në pozitë më të mirë për të ofruar ndërhyrje ose shërbime për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së për adresimin e dobësive të ndryshme;
4. Të identifikohen vendimmarrësit lokalë, politikanët, drejtuesit dhe personat që kanë çfarëdolloj fuqie formale ose joformale, orientimi, inkurajimi dhe/ose bashkëpunimi i të cilëve mund të luajë rol të rëndësishëm në përfitim të mbështetjes për një mekanizëm referimi në komunitetin përkatës;
5. Të identifikohen kapacitetet (dhe gatishmëria) E ndërhyrësve ose të ofruesve të shërbimeve për trajtimin e spektrit të dobësive dhe të përcaktohet nëse ata kanë nevojë për trajnim të specializuar në fushën e EDhRÇT-së për ta bërë këtë në mënyrë më efektive. Në këtë mënyrë, mësohet, për shembull, nëse punonjësit socialë dhe profesionistët e shëndetit mendor mund të kenë shqetësime në lidhje me trajtimin e individëve me rrezik të lartë dhe angazhimin në një fushë shumë të lidhur me sigurinë, dhe nëse duhet të adresohen këto shqetësime dhe si mund të bëhen me cilësinë e duhur;
6. Të përcaktohet se cilët profesionistë dhe organizata që punojnë drejtpërdrejt me komunitetet mund të jenë të gatshëm të marrin pjesë në një mekanizëm referimi që merret me raste të EDhRÇT-së, qoftë si “anëtarë” ose sipas nevojës (*ad hoc*), dhe nëse do të ishin të gatshëm të marrin pjesë vullnetarisht (*pro bono*) apo nëse do të kërkonin shpërblim për këtë punë shtesë;
7. Të vlerësohen kapacitetet dhe programet institucionale ekzistuese, bashkëpunimet mes policisë dhe aktorëve që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese, veçanërisht për të përcaktuar nëse çështjet e EDhRÇT-së mund të përfshihen në mekanizmin ekzistues apo në ndonjë program tjetër të ngjashëm; apo nëse duhet të ndërmerren nisma për ngritjen e një mekanizmi të pavarur referimi për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së;
8. Të përcaktohet se deri në çfarë shkalle mund të përdorin anëtarët e komunitetit një mekanizëm referimi - duke përfshirë këtu njohjen e çdo faktori nxitës apo frenues (p.sh., struktura, objekti i punës ose mënyra se si prezantohet mekanizmi). Në këtë kontekst, konsultimet, ku komunitetet përkatëse duhet të përfshihen si partnerë më tepër sesa si shënjestër, mund të tregojnë se me çfarë lloji angazhimi ndërjegjësuës apo angazhim në shkallë komuniteti duhet të plotësohen përpjekjet për ngritjen e një mekanizmi referimi. Kjo mund të përfshijë, për shembull, hartëzimin e përparësive krahasuese të mekanizmave të referimit që përfshijnë zhvendosjen e përgjegjësisë për menaxhimin e të rinjve të rrezikuar nga policia tek aktorë të tjerë, si dhe vlerësimin nëse këta të rinj i kanë hyrë rrugës së EDhRÇT-së dhe nëse kanë nevojë për orientime për t'u rezistuar prirjeve të tilla; si dhe ofrimin e trajnimeve bazë për

- anëtarët e komunitetit për mënyrën e identifikimit të shenjave të para të EDhRÇT-së;
9. Të identifikohen politikat dhe kornizat ligjore relevante ekzistuese që tregojnë nëse të miturit dhe të rriturit mund të trajtohen ndryshe brenda këtyre kornizave dhe si mund të bëhet kjo.  
Këto korniza duhet të përfshijnë ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë dhe protokollet e shkëmbimit të informacioneve midis policisë, agjencive dhe profesionistëve që nuk vijnë nga fusha e zbatimit të ligjit duhet të rishikohen rregullisht dhe në mënyrë të pavarur për të qenë në përputhje me ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë;
  10. Të përcaktohen faktorët lokalë, kontekstualë dhe kulturorë që do të duhet të merren parasysh gjatë projektimit të një mekanizmi referimi.  
Këta faktorë mund të përfshijnë treguesit që tregojnë nëse ekzistojnë stigma që lidhen me kërkimin ose marrjen e trajtimit nga profesionistët e shëndetit mendor ose profesionistët e tjerë të kujdesit psiko-social, si dhe rolin që luajnë qasjet e bazuara tek arti dhe teatri që janë të orientuara drejt komunitetit në ofrimin e kujdesit psiko-social në vend të trajtimit profesional në fushën e shëndetit mendor; dhe
  11. Të merren vendime të informuara nëse duhet zgjedhur një qasje kombëtare, lokale apo rajonale për krijimin e çfarëdolloj mekanizmi të tillë referimi dhe të tregohet kujdes që ky mekanizëm të strukturohet dhe të prezantohet në mënyrë të tillë (shih më poshtë) që të përshtatet shumë mirë me komunitetet që mbështet dhe me të cilat duhet të bashkëpunojë për të qenë efektiv.

## 5.2. Shqyrtimi i objektit të punës dhe prezantimi i tij

Duhet vlerësuar me vëmendje nëse mekanizmi duhet të fokusohet në çështje stigmatizuese të EDhRÇT-së dhe t'u përshtatet atyre apo ta përfshijë EDhRÇT-në si një ndër problemet e tjera që trajton lidhur me dhunën dhe sigurinë e komunitetit përkatës. Këto shqetësime mund të përfshijnë dhunën e bandave, vetëvrasjet, abuzimin me drogat ose dhunën me bazë gjinore.

Një mekanizëm i fokusuar ngushtë në një çështje të vetme si EDhRÇT-ja, edhe pse komplekse, mund të ndihmojë në tërheqjen e burimeve dhe të një mbështetjeje të nivelit të lartë, duke qenë se shumica e fondeve për nismat e parandalimit, ndërhyrjeve dhe shtysat politike për to vijnë nga komuniteti kundër terrorizmit dhe komuniteti më i gjerë i sigurisë. Megjithatë, siç u përmend më lart, **një strukturë më e gjerë, e fokusuar në disa lloje çështjesh sociale ose në parandalimin e krimit në përgjithësi dhe që nuk është e përshtatur vetëm për EDhRÇT-në mund të ketë një sërë përfitimesh që nuk duhen neglizhuar.** Këto përfitime përfshijnë:



1. Me anë të një qasjeje më të gjerë ulen gjasat që individët që referohen në mekanizëm të etiketohen dhe të stigmatizohen si “ekstremistë të dhunshëm”, “terroristë” apo “të radikalizuar”;
2. Individët e referuar ka më shumë gjasa të jenë më të gatshëm të punojnë si vullnetarë dhe të bashkëpunojnë, pasi mund t'i identifikojnë më lehtë përfitimet nga pjesëmarrja në program;
3. Miratimi i një strukture më të gjerë e zvogëlon mundësinë që ata që tregojnë dobësi ndaj EDhRÇT-së të marrin trajtim preferencial kundrejt atyre që tregojnë shenja të formave të tjera të sjelljeve të dhunshme;
4. Profesionistët lokalë që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese, si p.sh. mësimdhënësit, punonjësit socialë dhe punonjësit e shëndetësisë, si dhe drejtuesit e komunitetit, të cilët mund të kenë rezerva për t'u përfshirë në një iniciativë me fokus të ngushtë, të lidhur me atë që ata e perceptojnë si çështje të sigurisë kombëtare, ka më shumë gjasa që t'i referojnë individët, të shkëmbejnë informacione dhe të marrin pjesë në forma të ndryshme në një mekanizëm me strukturë më të gjerë;<sup>71</sup> dhe
5. Integrimi i EDhRÇT-së në një mekanizëm që trajton një grup më të gjerë çështjesh do ta lehtësonte shfrytëzimin e marrëdhënieve dhe burimeve institucionale ekzistuese, si dhe të kapaciteteve të tjera të aktorëve relevantë. Kështu, një qasje e integruar mund të lejojë përdorim më efikas të burimeve sesa qasja e dedikuar vetëm ndaj Parandalimit/Kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, veçanërisht në një kontekst, ku mund të mos ketë numër të mjaftueshëm rastesh për ta justifikuar fokusimin e burimeve të kufizuara në një çështje të vetme.<sup>72</sup>

Profesionistët dhe autoritetet e përfshira në krijimin e mekanizmave të referimit dhe të trajtimit individual të shenjave të rrezikut për EDhRÇT duhet të marrin masat që këta mekanizma, sikurse politikat dhe programet me fokus parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së në nivel lokal, të përshtaten dhe të emërtohen në mënyrë të tillë që t'u përshtaten më shumë shqetësimeve lokale dhe jo vetëm atyre qeveritare apo të donatorëve ndërkombëtarë.

Një qasje e tillë ka më shumë gjasa të tërheqë pjesëmarrjen, mbështetjen dhe besimin e aktorëve lokalë. Përdorimi i termave si “ekstremizëm i dhunshëm”, “radikalizim”, “terrorizëm” dhe “parandalim/kundërvënia ndaj EDhRÇT-së” -

71 RVR-ja e BE-së, “Parandalimi i Radikalizimit drejt Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm: Qasjet dhe praktikat”, udhëzuesi i vitit 2018, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-best-practices/docs/creating\\_counter\\_violent\\_extremism\\_infrastructures\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/creating_counter_violent_extremism_infrastructures_en.pdf).

72 Projekti i Parandalimit dhe RUSI, “Seminar mbi të menduarit multidisiplinar dhe veprimin novator: Bashkëpunimi rreth axhendës së parandalimit/kundërvënies së ekstremizmit të dhunshëm, Përmbledhje e shkurtër”, Universiteti i Oksfordit, 20-21 qershor 2018, [http://www.organizingagainste.org/wp-content/uploads/2018/07/31Jul18\\_OxfordSummary.pdf](http://www.organizingagainste.org/wp-content/uploads/2018/07/31Jul18_OxfordSummary.pdf).

edhe pse mbizotërojnë në diskutimet qeveritare dhe ndërmjet qeverive, mund t'i largojë komunitetet për shkak të perceptimit se përfituesit e programeve të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së, duke përfshirë edhe mekanizmat e referimit, përbëjnë kërcënim për mirëqenien e komunitetit.<sup>73</sup>

### 5.3. Qartësimi i mandatit, drejtimit, roleve dhe përgjegjësi

Duke pasur parasysh diversitetin e palëve të interesuara që përfshihen në një mekanizëm referimi, është e rëndësishme të shpjegohet dhe të kuptohet çdo element kyç që ka të bëjë me këtë mekanizëm: Cili është qëllimi i tij? Cili është fokusi i tij (p.sh., format e ndryshme të dhunës apo format e ndryshme të EDhRÇT-së, apo qoftë edhe një formë e vetme e EDhRÇT-së)? Kush do të jetë i përfshirë dhe çfarë roli do të ketë secili? Cili do të jetë procesi i mbikëqyrjes dhe i shqyrtimit dhe si do të funksionojë ai? Këto elemente duhet të shtjellohen në aktin themelues, në përshkrimin e aktiviteteve dhe detyrave të mekanizmit, në një sërë protokollesh, ose në një format tjetër të përshtatshëm dhe transparent.<sup>74</sup>

**Dokumenti i themelimit** duhet të përfshijë një skemë organizative që e bën të qartë se cila organizatë apo individ është aktori kryesor. Mësimi i nxjerrë nga mekanizmat e ndryshëm me shumë agjenci dhe mekanizmat multidisiplinarë, si dhe programet e tjera relevante është se “procesi duhet të drejtohet dhe të koordinohet nga një organizatë, e cila merr edhe përgjegjësinë për programin dhe për rezultatit e tij”.<sup>75</sup>

Kjo organizatë ose ky individ, ndër të tjera, mund të koordinojë procesin e shkëmbimit të informacionit dhe të vendimmarrjes në lidhje me rastet individuale dhe të ketë përgjegjësinë përfundimtare për programin dhe rezultatet e tij. Një organizatë e tillë mund të jetë komuna ose bashkia (p.sh., zyra e kryetarit të komunës/bashkisë ose shërbimi i ndihmës sociale), një agjenci qeveritare kombëtare, policia lokale ose një OJQ. Në disa raste, janë angazhuar

73 Eric Rosand e të tjerë, *Udhërrëfyes për përparim: Gjendja e axhendës globale për parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm*, Projekti i Parandalimit dhe RUSI, shtator 2018, [http://www.organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2018/09/GCCS\\_ROADMAP\\_FNL.pdf](http://www.organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2018/09/GCCS_ROADMAP_FNL.pdf).

74 Për të parë një shembull, shihni modelin MERIT të Otavës, aktin e themelimit dhe përshkrimin e aktiviteteve dhe detyrave të mekanizmit, <http://globalcommunitysafety.com/sites/default/files/merit-founding-charter-and-terms-of-reference.pdf>.

75 Magnus Ranstorp e të tjerë, *Parandalimi dhe kundërvënja ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Një plan fillestar për vlerësimin e shpejtë të provave dhe analizave për ekzaminimin e planeve të veprimit të autoriteteve lokale dhe elementeve të programit*, Universiteti Suedez i Mbrojtjes, shtator 2016, [http://cradpdf.drdc-rddc.gc.ca/PDFS/unc274/p805336\\_A1b.pdf](http://cradpdf.drdc-rddc.gc.ca/PDFS/unc274/p805336_A1b.pdf).

“zyrtarë të posaçëm referimi” për menaxhimin e procesit të referimit dhe të vlerësimit,<sup>76</sup> në raste të tjera, subjektet kanë siguruar me fondet e veta punësimin e një punonjësi që menaxhon mekanizmin.<sup>77</sup>

Vendimi se cila organizatë është në pozitën më të mirë për ta drejtuar mekanizmin duhet të merret në bazë të informacioneve nga konsultimet e sipërpërmendura me palët e interesuara dhe duke pasur parasysh se cila organizatë ka mundësi të krijojë besimin më të madh mes profesionistëve, praktikantëve dhe anëtarëve të komunitetit përkatës.

Përveç identifikimit të organizatës drejtuese, duhet menduar edhe për emërimin e një “menaxheri rastesh” për koordinimin e rasteve individuale, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e ndërhyrjeve apo planeve më të gjera të mbështetjes që do të shërbejnë edhe si pikë e dedikuar kontakti me personin e përfshirë në mekanizëm, familjen dhe komunitetin në përgjithësi. Menaxheri i rastit ka të ngjarë të ndryshojë nga një rast në tjetrin, në varësi të numrit dhe llojit të rasteve.

## 5.4. Mundësimi i shkëmbimit efektiv të informacionit

Efektiviteti i mekanizmave të referimit varet nga shkalla e profesionalizmit të vlerësimeve gjithëpërfshirëse të individëve që mund të konsiderohen se janë të rrezikuar nga EDhRÇT-ja.<sup>78</sup> Aktorët e ndryshëm kanë informacione specifike për individë të caktuar, të cilat mund të rishikohen gjatë vlerësimit dhe të përfshihen gjatë përgatitjes së planit të ndërhyrjes/mbështetjes. Megjithatë, kufizimet dhe qëllimet profesionale dhe etike mund të mos e lejojnë shkëmbimin e informacionit. Disa aktorë mund të hezitojnë të shkëmbejnë informacion me agjencitë dhe organizatat me të cilat nuk bashkëpunojnë zakonisht dhe/ose me të cilat nuk kanë bashkëpunim mbi baza ligjore (p.sh. me policinë); ata mund të shqetësohen edhe rreth shkeljes së të drejtës së privatësisë ose mbrojtjes së të dhënave personale.

76 Shih, për shembull, Namur, Belgjikë, <https://observatoirevivreensemble.org/en/protocol-for-the-prevention-of-radicalization>.

77 Qendra e Kanadasë për Angazhimin e Komunitetit dhe Parandalimin e Dhunës, “e cila udhëheq përpjekjet e Qeverisë së Kanadasë në kundërvënien ndaj radikalizimit”, ka siguruar fonde për një sërë njësisish të qeverisë vendore në të gjithë Kanadanë për t’u mundësuar shtimin e numrit të punonjësve të përshtatshëm dhe komponentëve të parandalimit/kundërvënies ndaj EDhRÇT-së në një mekanizëm ekzistues referimi me mandat më të gjerë. Shih <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/bt/cc/index-en.aspx>.

78 Marije Meines, *Strategjia Lokale: Elemente të një plani lokal efektiv të veprimit për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm*, Qendra e Ekselencës e RVR-së të BE-së, 2017, [https://www.cidob.org/content/download/67479/2055336/version/3/file/99-104\\_MARIJE%20MEINES.PDF](https://www.cidob.org/content/download/67479/2055336/version/3/file/99-104_MARIJE%20MEINES.PDF).

E drejta e privatësisë është e mbrojtur me ligjet për të drejtat të njeriut, ndërsa grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave duhet t'u përmbahet parimeve të caktuara, të rëndësishme dhe brenda parametrave të caktuar.<sup>79</sup> Po kështu, policia mund të ngurrojë ose të mos jetë në gjendje të ndajë informacione me aktorët e tjerë, qofshin ata qeveritarë apo joqeveritarë që tradicionalisht nuk kanë akses në informacione të ndjeshme ose të klasifikuara si "sekret".

Prandaj, miratimi i udhëzimeve, protokolleve, marrëveshjeve dhe proceseve të qarta dhe të pavarura të mbikëqyrjes dhe rishikimit, si dhe i kornizave të tjera për lehtësimin e shkëmbimit të njohurive, ekspertizës dhe për mbrojtjen e informacionit do t'i mundësojë ekipeve të punës që t'i vlerësojnë rastet konkrete në mënyrë efektive dhe të sigurt.<sup>80</sup> Këto korniza mund të ndihmojnë në mbrojtjen e privatësisë së individëve dhe të të dhënave personale dhe ato mund të zbusin shqetësimet për përdorim flagrant të të dhënave nga policia për qëllime hetimore ose të ndjekjes penale. Këto korniza mund të përcaktojnë qartë rastet kur informacioni mund t'i referohet policisë (p.sh. kur ekziston rreziku për dëme të menjëhershme, urgjente).<sup>81</sup> Garantimi i një qartësie të tillë në menaxhimin e informacionit për rastet e referuara në mekanizma, krahasuar me atë informacion që përdor policia për hetime penale, mund t'i nxisë anëtarët e komunitetit që t'i referojnë individët në mekanizëm dhe, njëkohësisht, të inkurajojnë pjesëmarrjen e profesionistëve jashtë organeve ligjzbatuese.

Siç njoftohet nga RVR-ja e BE-së, çdo kornizë e tillë mund të ndihmojë "për të bërë dallimin midis informacioneve të klasifikuara dhe informacioneve delikate që mund të ndahen me të tjerë me shumë kujdes".<sup>82</sup> Megjithëse informacioni i llojit të parë nuk mund të ndahet me anëtarët e ekipit që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese (përveçse kur ata janë të pajisur me lejet (certifikatat) e nevojshme të sigurisë), informacioni i llojit të dytë mund të ndahet në rrethanat e duhura.

Për shembull, ato mund të bëhen mjaft të përgjithshme - por megjithatë të dobishme - për t'u ndarë me anëtarët e ekipit që nuk vijnë nga organet

79 OSBE, *Udhëzuesi i OSBE-së për policimin me bazë inteligjencën*, Seri publikimesh nga DKTN/NjÇSP, vëllimi 13, korrik 2017, <https://www.osce.org/chairemanship/327476>.

80 Për një shembull të udhëzimeve të tilla, shih Zyrën për Siguri dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit, Ministra e Punëve të Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar, Qeveria e LM, *Programi Channel: Mbrojtja e njerëzve të rrezikuar nga përfshirja në terrorizëm*, Shtojca A, tetor 2012, <https://www.npcc.police.uk/documents/TAM/2012/201210TAMChannelGuidance.pdf>. Po ashtu, shih Hemmingsen, Hyrje në qasjen daneze të kundërvënies ndaj ekstremizmit dhe parandalimit të tij, fq.15. Shkëmbimi i informacionit midis policisë, shkollave dhe shërbimit për kujdes social - tre shtyllat e mekanizmeve të referimit të udhëhequra në nivel lokal në Danimarkë - rregulluar me seksionin 115 të Ligjit të Administrimit të Drejtësisë të Danimarkës, i cili përcakton se "autoritetet mund të ndajnë informacione për një individ nëse kjo është e nevojshme për bashkëpunimin në parandalimin e krimit ose për bashkëpunimin ndërmjet policisë, shërbimeve sociale dhe psikiatrisë sociale, si dhe autoriteteve të shëndetit mendor në përpjekjet e tyre për të ndihmuar individët e rrezikuar në aspektin social. Megjithatë, informacioni nuk mund të ndahet për qëllime të hetimeve penale".

81 Qendra e Ekselencës së RVR-së të BE-së, "Doracak për mënyrat e krijimit të strukturave të përbëra nga shumë agjenci"

82 RVR-ja e BE-së, "Sfidat e përbashkëta në parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Evropian", prill 2018, fq. 8, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/ran\\_policy\\_practice\\_common\\_pcvce\\_challenges\\_sofia\\_04042018\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_policy_practice_common_pcvce_challenges_sofia_04042018_en.pdf).

ligjzbatuese, pa e komprometuar ndjeshmërinë e të dhënave bazë ose pa e penguar bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të mekanizmit.<sup>83</sup>

## 5.5. Garantimi i një pjesëmarrjeje të larmishme

Mekanizmat ekzistues të referimit që merren me rastet e EDhRÇT-së në zonën e OSBE-së ndryshojnë në përbërjen e tyre, megjithëse zakonisht përfshijnë OJQ-të dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile. Në to mund të përfshihen një spektër i gjerë agjencish, organizatash, praktikantësh dhe profesionistësh (p.sh., profesionistët e shëndetit mendor, punonjësit socialë, mësuesit, grupet e besimit, profesionistët që punojnë me të rinjtë e, ndonjëherë, edhe policia), si dhe pjesëmarrës që kanë formim dhe aftësi të ndryshme. Për shkak se ky spektër mund të bashkojë organizata, profesionistë dhe praktikantë që nuk janë mësuar të shkëmbejnë informacione ose të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, mund të nevojitet krijimi i kanaleve të reja të komunikimit ose protokolle për shkëmbimin e informacionit. Përveç kësaj, të gjithë pjesëmarrësve duhet t'u jepen kompetenca të caktuara brenda kornizës përkatëse strategjike për parandalimin/kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, qoftë në nivel kombëtar apo vendor. Për aktorët që nuk vijnë nga organet e sigurisë, kjo mund të përfshijë aksesin në informacione sekrete, për t'i bërë ata plotësisht të vetëdijshëm për kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë dhe fushave të tjera. Sipas RVR-së së BE-së, aktorët “duhet ta dinë se çfarë rreziku marrin përsipër [duke u përfshirë në mekanizëm] dhe çfarë ndikimi do të kishte mosadresimi i tij [d.m.th. i kërcënimit ose i rrezikut].”<sup>84</sup>

Në varësi të numrit të aktorëve të interesuar për mekanizmin dhe të aftë për të marrë pjesë në të - dhe në varësi të burimeve në dispozicion - duhet të merret parasysh kufizimi i anëtarësisë në një numër të vogël palësh të interesuara që kanë interesa të gjera institucionale në këtë nismë. Ato mund të përfshijnë njësitë e pushtetit vendor, policinë, dhe punonjësit e kujdesit shoqëror dhe të shëndetit mendor. Në të mund të përfshihen sipas nevojës edhe aktorë të tjerë, si mësuesit, mentorët, punonjësit me të rinjtë, OJF-të dhe prindërit.<sup>85</sup>

Përveç këtyre palëve të interesuara, mund të merret në konsideratë edhe krijimi i një rrjeti të zbatuesve të ndërhyrjeve ose ofruesve të shërbimeve. Këtu mund të përfshihen profesionistë, agjenci dhe/ose organizata që, edhe pse zyrtarisht nuk janë pjesë e mekanizmit, kanë treguar gatishmëri për t'i trajtuar ose për t'u ofruar mbështetje individëve të referuar në mekanizëm.

83 Qendra e Ekselencës së RVR-së të BE-së, “Doracak për mënyrat e krijimit të strukturave të përbëra nga shumë agjenci “

84 Qendra e Ekselencës së RVR-së të BE-së, “Zhvillimi i Kornizës Lokale të Parandalimit dhe Parimet Udhëzuese”, dokument i politikave, nëntor 2016, fq. 9, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/policy\\_paper\\_developing\\_local\\_prevent\\_framework\\_guiding\\_112016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/policy_paper_developing_local_prevent_framework_guiding_112016_en.pdf).

85 Magnus Ranstorp dhe të tjerët, “Parandalimi dhe kundërvënja ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm”.

## 5.6 Garantimi i drejtimit të duhur strategjik dhe mbikëqyrja e politikave

Duke pasur parasysh diversitetin e agjencive dhe organizatave që mund të përfshihen në një mekanizëm referimi, shpesh me prioritete dhe politika të ndryshme institucionale, si dhe me histori të kufizuara (në rastin më të mirë) bashkëpunimi mes shumë agjencive dhe shumë palëve, mund të lindë nevoja për ngritjen e një komisioni ose grupi (p.sh. një komiteti drejtues) për përcaktimin dhe ruajtjen e drejtimit strategjik të mekanizmit. Ky ekip, i cili mund të përfshijë përfaqësues të lartë nga subjektet e përfshira më aktivisht në mekanizëm, si dhe zbatuesit përkatës të ndërhyrjes, mund të shërbejë për disa qëllime njëherësh. Këtu përfshihet:

1. Marrja e masave që mekanizmi të funksionojë në përputhje me çdo dokument themelimi dhe të vazhdojë të jetë në harmoni me kornizat strategjike përkatëse kombëtare dhe lokale;
2. Angazhimi me politikëbërësit, ligjvënësit, praktikantët dhe anëtarët e komunitetit, për të ndihmuar në sigurimin e mbështetjes së nevojshme ligjore, politike, buxhetore dhe në mbështetjen e komunitetit për mekanizmin;
3. Identifikimi dhe mobilizimi i burimeve për garantimin e vazhdimësisë së mekanizmit;
4. Adresimi i të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me shkëmbimin e informacionit ose koordinimin mes atyre që përfshihen në funksionimin e mekanizmit; dhe
5. Mbikëqyrjen e vlerësimeve periodike, si të procesit të mekanizmit ashtu edhe të rezultateve të tij, për të përfshirë një vlerësim të pavarur të ndikimit mbi të drejtat e njeriut.

## 5.7 Integrimi i perspektivës gjinore

Ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar se terrorizmi dhe EDhRÇT-ja janë fenomene gjinore dhe përjetohej ndryshe nga burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat.<sup>86</sup> Burrat dhe gratë mund të përfshihen në terrorizëm dhe në ekstremizëm të dhunshëm për arsye themelore të ndryshme dhe mund të kryejnë role të ndryshme brenda organizatave terroriste. Taktikat e rekrutimit të grave dhe burrave mund të jenë të ndryshme. Më gjerësisht, roli i çështjeve gjinore dhe atyre që lidhen me identitetin mund të ketë ndikim të fortë në trajektoret e radikalizimit drejt dhunës.<sup>87</sup>

86 OSBE dhe ODIHR, "Rekomandime dhe Gjetje: Përfshirja gjinore në përgjigjet operationale ndaj EDhRÇT-së", 22-23 nëntor 2016, <https://www.osce.org/secretariat/305056?download=true>.

87 Qendra e Ekselencës së RVR-së së BE-së, "Zhvillimi i Kornizës Lokale të Parandalimit", fq. 14.

Kjo e bën të domosdoshëm integrimin e perspektivës gjinore në masat e projektuara për parandalimin dhe kundërvënien ndaj terrorizmit dhe EDhRÇT-së në mekanizmat e referimit.<sup>88</sup> FGKT-ja ka theksuar këtë çështje, duke rekomanduar që “përpyekjet për t’ju kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm duhet t’i kushtojnë vëmendje gjinisë së pjesëmarrësve si dhe normave shoqërore dhe pritshmërive shoqërore që lidhen me përkatësinë e një gjinie të veçantë në shoqëri. Duke i kushtuar vëmendje mënyrave se si normat gjinore formësojnë jetën e njerëzve ka të ngjarë të përmirësohen programet për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm me fokus gratë, e po ashtu ka të ngjarë t’u shtohet një dimension i të kuptuarit dhe reagimit ndaj programeve për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm me fokus burrat”.<sup>89</sup>

Integrimi i perspektivës gjinore në mekanizmat e referimit që merren me rastet e EDhRÇT-së mund të përfshijë:

1. Sigurimin e balancës përkatëse gjinore mes profesionistëve dhe praktikantëve që marrin pjesë në mekanizëm, qoftë si anëtarë, qoftë sipas nevojës (ad hoc). Kjo balancë gjinore duhet të reflektohet në të gjithë procesin e mekanizmit të referimit, duke përfshirë edhe rastet kur bëhet vlerësimi i rrezikut, si dhe gjatë projektimit dhe realizimit të planit të ndërhyrjes së duhur ose planit më të gjerë mbështetës;
2. Të kuptuarit e dinamikës gjinore të radikalizimit drejt dhunës, duke përfshirë dallimet në arsyet e radikalizimit të vajzave/grave drejt dhunës krahasuar me djemtë/burrat dhe nevoja për t’iu kundërvënë stereotipeve që lidhen me gjininë, si për shembull lidhja midis ekzagjerimit të sjelljes stereotipike mashkullore dhe dhunës;
3. Zhvillimin ose mbështetjen në faktorët specifikë të gjinisë për të përcaktuar më lehtë se kush është në rrezik ose më i prekshëm nga EDhRÇT-ja dhe zhvillimin e ndërhyrjeve të ndjeshme ndaj aspektit gjinor ose planeve më të gjera mbështetëse për adresimin e rreziqeve dhe dobësive të identifikuar; ►

88 Për një diskutim mbi dinamikën gjinore dhe rolin e grave në EDhRÇT dhe Parandalimit/Kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, shih, për shembull, Irene Ndung’u dhe Motheпа Shadung, “A mund ta përmirësojë qasja gjinore reagimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm?”, Instituti për Studime të Sigurisë, shtator 2017, <https://issafrica.s3.amazonaws.com/site/uploads/aitwr-5.pdf>; Iflat Idris me Ayat Abdelaziz, “Gratë dhe ekstremizmi i dhunshëm: Raporti i Hulumtimit të dhënave të përfituara nga shërbimi për mbështetjen e përdoruesve (Helpdesk)” i GSDRC, 2017, [http://www.gsdr.org/wp-content/uploads/2017/05/HDR\\_1408.pdf](http://www.gsdr.org/wp-content/uploads/2017/05/HDR_1408.pdf); Emily Winterbotham dhe Elizabeth Pearson, “Qytete të ndryshme, Tregime të përbashkëta: Një studim në pesë shtete që sfidon supozimet rreth grave myslimane dhe ndërhyrjeve në fushën e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, *Revista RUSI*, 30 nëntor 2016, <https://rusi.org/publication/rusi-journal/different-cities-shared-stories-five-country-study-challengingassumptions>; dhe Naureen Choudhury Fink, Sara Zeiger dhe Rafia Bulai, *Bota e burrave: Eksplorimi i rolit të grave në kundërvënien ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm*, Hedayah dhe Qendra Globale për Sigurinë e Bashkëpunimit, prill 2016, [http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2016/07/AMansWorld\\_FULLL.pdf](http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2016/07/AMansWorld_FULLL.pdf).

89 FGKT, *Praktikat e mira për gratë dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm*, 29 mars 2016, fq. 2, <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/A/GCTF-Good-Practices-on-Women-and-CVE.pdf>. Për një diskutim të ndikimit që mund të kenë gratë në ndërhyrjet për parandalimin/Kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, shih, për shembull, OSBE, *Roli i shoqërisë civile PËR PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Udhëzues për Evropën Juglindore*, 2018, fq. 28-30, <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>.

4. Ndjeshmërinë ndaj situatave dhe mjediseve kulturore, si për shembull kur vajzat apo gratë nuk duan të qëndrojnë vetëm për vetëm me një profesionist të gjinisë tjetër; dhe
5. Përfshirjen dhe angazhimin e nënave dhe baballarëve, ngritjen e vetëdijes dhe trajnime të tjera për mënyrën e identifikimit dhe përballjen me radikalizimin.

## 5.8 Përfshirja e shoqërisë civile

Me shumë pak përjashtime, OJQ-të dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile luajnë rol të rëndësishëm në llojet e ndryshme të mekanizmeve të referimit që merren me rastet e EDhRÇT-së në zonën e OSBE-së. Në disa raste, janë OJQ-të ato që e menaxhojnë mekanizmin, si në rastin e Organizatës për Parandalimin e Dhunës në Edmonton dhe QPRÇDh-në Montreal, Spitali i Fëmijëve në Boston<sup>90</sup> dhe Universiteti i Denverit<sup>91</sup> në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa OJQ janë bashkëpartnerë në mekanizëm (p.sh. “United Way” në Toronto), ndërsa disa të tjera ofrojnë këshillime ose shërbime të tjera ndërhyrjeje dhe mbështetjeje (p.sh. “Hayat” dhe Rrjeti i Parandalimit të Dhunës në Gjermani).

Përfshirja aktive e shoqërisë civile duhet të jetë e pritshme, duke pasur parasysh kontributet e gjera të OShC-ve në parandalimin e EDhRÇT-në dhe qasjen e tyre në komunitete, si dhe besueshmërinë dhe legjitimitetin në komunitetet, ku ndjenjat e marxhinalizimit dhe mungesës së përkatësisë janë më të theksuara. Siç theksohet në udhëzuesin e OSBE-së *Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Udhëzues për Evropën Juglindore*, “aktorët e shoqërisë janë në pozitë më të mirë, janë të besueshëm dhe me përvojë në punën me grupe të veçanta, për të ndihmuar në identifikimin dhe adresimin e problemeve dhe pakënaqësive që i bëjnë individët më të prekshëm ndaj ndikimit të grupeve ekstremiste të dhunshme.”<sup>92</sup>

Roli i saktë që luajnë aktorët e shoqërisë civile në çdo mekanizëm të caktuar do të jetë specifik në aspekt të kontekstit - dhe do të varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë kontributet e tyre aktuale në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, kapacitetin dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në mekanizmin e referimit.

90 Eric Rosand e të tjerët, *Udhërrëfyes për përparim: Gjendja e axhendës globale për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm*, Projekti i Parandalimit dhe RUSI, shtator 2018, fq. 17, <http://www.organizingagainstve.org/roadmap-progress-state-global-p-cve-agenda/>.

91 Universiteti i Denverit, Colorado Resistance Collaborative, <https://www.du.edu/gssp/resilience-collaborative/about.html>.

92 OSBE-së, *Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm*, fq. 10, <https://polis.osce.org/index.php/role-civil-society-preventing-and-counteracting-violent-extremism-and-radicalization-lead-terrorism>.



Pyetjet kyçe që duhet të parashtrihen për të përcaktuar rolin dhe kapacitetin e tyre përfshijnë çështje si:

1. A janë iniciativat e shoqërisë civile në parandalimin dhe kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm të përshtatshme me objektivat e mekanizmit? Këto iniciativa përfshijnë këshillime psikosociale; rritjen e ndërgjegjësimit rreth pikave të dobëta që ndikohen nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm mes mësuesve, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit, identifikimin e këtyre pikave të dobëta; zbatimin e programeve të artit, dramës dhe programeve sportive për angazhimin e të rinjve të cenueshëm; realizimin e iniciativave të dialogut komunitar që synojnë ndërtimin e besimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve;
2. A ka iniciativa, të udhëhequra nga shoqëria civile, në të cilat mund të integrohet mekanizmi i referimit?
3. A ka ndërhyrje apo lloje të tjera mbështetjeje që mund të jenë të nevojshme për të adresuar dobësitë e një individi ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm; dhe, që garantohen nga aktorët e shoqërisë civile më mirë se aktorët qeveritarë?
4. A ka OShC apo OJQ që kanë lidhje të forta me qeverinë dhe komunitetet përkatëse lokale? dhe
5. A ka OShC apo OJQ që kanë kapacitete dhe burime për të ofruar mbështetje “kyçe” (p.sh. ndihmë administrative, trajnime dhe kontroll të cilësisë) për mekanizmat e referimit në të gjithë vendin?

## 5.9 Qartësimi i rolit të qeverisë qendrore

Mekanizmat e referimit kanë tendencë të funksionojnë në nivel lokal - ku më së shumti gjendet pjesa më e madhe e kapaciteteve për realizimin e ndërhyrjeve dhe aktiviteteve jopenale, parandaluese- shpesh me përfshirje të konsiderueshme të pushtetit vendor. Megjithatë këta mekanizma rrallë udhëhiqen nga aktorët e nivelit kombëtar, qeveria kombëtare mund të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe mbështetjen e platformave të tilla, ku shkalla e përfshirjes së qeverisë qendrore varet nga niveli i decentralizimit në vend.

Roli i qeverisë kombëtare mund të përfshijë:

1. Theksin në strategji kombëtare apo plane veprimi për të garantuar përkushtimin e qeverisë qendrore ndaj mekanizmave të referimit dhe, më gjerësisht, ndaj ndërhyrjeve për parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm – për punën me individë *përpara* ndryshimit radikal të sjelljes drejt dhunës, duke theksuar se ndërhyrje të tilla përbëjnë një komponent thelbësor të strategjisë gjithëpërfshirëse kombëtare për parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm;

2. Përcaktimin e një sërë parimesh që iu përmbahen mekanizmave të referimit, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra dhe duke ofruar liri veprimi aktorëve të tjerë lokalë për zbatimin e këtyre parimeve, në vlerësim të kapaciteteve dhe nevojave të komuniteteve përkatëse;
3. Garantimin e respektimit të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, si dhe mekanizmave të pavarur të mbikëqyrjes ose mekanizmave të tjerë të llogaridhënies, në përputhje me dispozitat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që garantojnë të drejtën e privatësisë. Marrjen e hapave të tjerë të përshtatshëm për të mundësuar shkëmbimin efektiv dhe efikas të informacionit mes agjencive, praktikantëve dhe profesionistëve të përfshirë në mekanizmin e referimit;
4. Marrjen e masave që çdo mekanizëm kombëtar i koordinimit të aktiviteteve në fushën e parandalimit/kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm të përfshijë zyrtarë kombëtarë dhe lokalë, si nga organet ligjzbatuese, ashtu edhe nga organet që nuk i përkasin kësaj fushe, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile;
5. Nxitjen dhe lehtësimin e pjesëmarrjes në mekanizmat e referimit të aktorëve kyçë që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese, ku përfshihen punonjësit socialë, profesionistët e shëndetit mendor dhe mësuesit, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimeve;
6. Shpërndarjen e burimeve për ta mbështetur qëndrueshmërinë e mekanizmave të referimit, për reduktimin e nevojës së burimeve financiare dhe rritjes së ndjenjës së përkatësisë ndaj mekanizmit të aktorëve kombëtarë dhe atyre lokalë;
7. Mundësimin e shkëmbimit të mësimave të nxjerra midis mekanizmave të ndryshëm, si dhe nxitjen, atje ku është e përshtatshme, e zbatimit të këtyre mësimave në kontekstin lokal; dhe
8. Marrjen e masave për sigurimin e kornizës së nevojshme ligjore dhe të politikave që mundësojnë ndërhyrje të përshtatura për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, që përfshijnë rishikimin sistematik dhe të pavarur të tyre sa i përket ndikimit që mund të kenë drejtat e njeriut dhe efekte të tjera të padëshiruara.

Në vitin 2018, FGKT-ja i inkurajoi qeveritë të “rishikonin dhe të ndryshonin kornizën ligjore të vendeve të tyre, sipas nevojës, për realizimin e ndërhyrjeve të përshtatura, si p.sh., krijimin e mekanizmave të referimit për individët në rrezik.”<sup>93</sup> Është e rëndësishme që ndërmerren këto hapa, qeveritë duhet të kujdesen që kadri ligjor të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Qeveritë kombëtare duhet të arrijnë ekuilibrin e duhur midis udhëheqjes në nivel kombëtar dhe ndjenjës së përkatësisë ndaj mekanizmit në nivel lokal, si dhe të shmangin perceptimin e “detyrimit” për krijimin e mekanizmave të tillë nga kryeqyteti në nivel lokal.

<sup>93</sup> Shih FGKT, *Iniciativa për adresimin e terrorizmit në vend*.

Për shembull, në një sistem të centralizuar të qeverisjes siç është ai i Mbretërisë së Bashkuar, mund të jetë e përshtatshme që qeveria kombëtare të nxjerrë ligje për krijimin e një rrjeti mbarëkombëtar të mekanizmave të referimit lokalë; të ofrojë udhëzime kombëtare për autoritetet lokale, praktikantët dhe profesionistët e ngarkuar me menaxhimin dhe pjesëmarrjen në to; si dhe të vendosë detyrim ligjor për punonjësit shtetërorë të shëndetësisë dhe mësuesit të referojnë individët që konsiderojnë të prekshëm për t'u përfshirë në terrorizëm. Megjithatë, kjo qasje mund të mos jetë mënyra më efektive për sistemet më pak të centralizuara ose për mjediset që janë të prirura për konflikte ose të ndjeshme ndaj konflikteve.

## 5.10 Identifikimi i vendndodhjes dhe shpeshtësia e takimeve

Vendi se ku mblihdet mekanizmi dhe shpeshtësia e takimeve të anëtareve të tij për shqyrtimin, vlerësimin e rasteve individual, hartimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve e përshtatura, mund të varen nga një sërë faktorësh. Këta faktorë përfshijnë numrin e rasteve, burimet ekzistuese dhe kapacitetet e tjera të atyre që janë të përfshirë në mekanizëm, si dhe nivelet e besimit që gëzojnë anëtarët e mekanizmit brenda komuniteteve përkatëse.

Në disa raste, si në qytetet e Finlandës, ekipi përbërës i mekanizmit- që përfshin policinë, punonjësit socialë, dhe, në disa raste, profesionistët që punojnë me të rinjtë dhe mjekët psikiatër- punon së bashku, përditë, në të njëjtin mjedis, i cili zakonisht ndodhet në komisariatit policor.<sup>94</sup> Në raste të tjera, si në disa programe lokale në Belgjikë, Kanada dhe Danimarkë, anëtarët e ekipit punojnë secili për organizatën e vet, por mblihdhen periodikisht në tryeza të përbashkëta për shqyrtimin e rasteve në komunat përkatëse, qendrat rinore apo hapësira të tjera “neutrale (p.sh. një herë në javë, muaj ose tremujor) ose sipas nevojës. Veçanërisht në rastet kur anëtarët e mekanizmit që vijnë nga institucionet ose anëtarët individualë nuk njihen me njëri-tjetrin, takimet sistematike ballë për ballë mund të ndihmojnë në krijimin e besimit, i cili bëhet shumë i rëndësishëm për një bashkëpunim efektiv sa i përket trajtimit të rasteve individuale.

## 5.11 Veprimtaria në nivel lokal

Një çështje tjetër e rëndësishme në ngritjen e mekanizmave të referimit është shtrirja gjeografike e programit. Për shembull, nëse një program krijohet në nivel komune apo bashkie, a duhet të krijohen mekanizma në komuna të tjera,

94 RVR-ja e BE-së, “Përmbledhje e qasjeve dhe praktikave”, 2018, fq. 561, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-best-practices/docs/ran\\_collection\\_approaches\\_and\\_practices\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/ran_collection_approaches_and_practices_en.pdf).

në të gjithë vendin apo vetëm aty ku perceptohet të ekzistojë një kërcënim më i madh nga ekstremizmi i dhunshëm, ku ekzistojnë platforma (p.sh., komisione të sigurisë apo të rinisë) që mund të shfrytëzohen, dhe/ose ku komunat (dhe donatorët ndërkombëtarë) kanë vullnetin politik dhe burimet për ta mbështetur programin?

Një mundësi për t'u marrë parasysh është qasja që përdoret në krahinën kanadeze të Kolumbisë Britanike. Në vend që të krijohen mekanizma të përhershëm në qytete të ndryshme anembanë krahinës, krijohet një program i vetëm ("Shift") brenda qeverisë krahinore; ky program punon me komunat, sipas nevojës dhe numrit të rasteve, për të lidhur individët që mund të jenë në rrezik të pranimit të ideologjive të dhunshme me shërbimet lokale për këshillime, me shërbimet sociale ose me organizma të tjerë.<sup>95</sup> Kjo qasje mund të jetë interesante, sidomos në ato vende ku burimet dhe kapacitetet janë të kufizuara dhe numri i pritur i rasteve nuk e justifikon investimin në ngritjen e mekanizmeve të përhershëm në pjesë të ndryshme të vendit apo të krahinës.

Çështje të ngjashme duhet të adresohen nëse është zgjedhur modeli i udhëheqjes së mekanizmit nga OJQ-të ose modeli i partneritetit publik-privat. Për shembull, a ofron një OJQ kapacitet, legjitimitet dhe besim në komunitetet lokale për të punuar në të gjithë vendin apo vetëm në disa pjesë të caktuara të tij? Nëse bëhet fjalë për këtë të dytën, si duhet të zgjidhen ato pjesë? Sa i përket modelit të dytë, a ka një konsorcium ose rrjet OJQ-sh që mund të punojnë me qeverinë kombëtare për t'i mundësuar mekanizmit përfshirjen e të gjithë vendit?

Arsyet përse këto pyetje janë të rëndësishme lidhen me qasje të kufizuara gjeografikisht, që rrisin mundësitë për komunitete të caktuara, të veçuara, të stigmatizuara, ose të izoluara të përfitojnë nga shërbimet që u ofrohen komuniteteve fqinje. Në përgjithësi, një qasje tepër e lokalizuar – sidomos në kushtet e një sistemi të centralizuar që mbulon gjithë vendin - mund t'i kushtojë shumë rëndësi vendndodhjes/ vendbanimit të një individi, në vend që të merret me nevojat e tij në kushte të sjelljes që çon në terrorizëm dhe që mund të adresohet nga një mekanizëm referimi.

Përveç kësaj, nëse komunat apo bashkitë përkatëse marrin rol drejtues në ngritjen e mekanizmeve të tillë (qoftë në zona të kufizuara ose në shkallë vendi), duhet të ndërmerren hapa për arritjen e njëtrajtshmërisë në të gjithë vendin për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave mes komunave dhe për të siguruar përfshirjen e tyre në trajnimin e nevojshëm të specializuar, për mirëfunksionimin e mekanizmit. Siç është përmendur më lart, pikërisht këtu shihet roli që mund ta luajë qeveria qendrore.

95 Qeveria e Kanadasë, "Projektet e financuara në periudhën 2017-2018, Thirrje për paraqitje propozimesh", <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/bt/cc/ fpd-en.aspx>.

## 5.12 Vlerësimi i burimeve dhe kostove

Burimet e nevojshme dhe kostot që lidhen me krijimin dhe funksionimin e mekanizmave të referimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe kundërvënien ndaj tyre varen nga një sërë faktorësh. Ata përfshijnë, për shembull:

1. Vlerësimin për mënyrën e adresimit të çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm si programe ekzistuese apo mekanizma të pavarur;
2. Natyrën dhe shkallën e kapaciteteve ekzistuese institucionale dhe të ekspertizës profesionale. Kjo do të ndikojë në masën në të cilën mekanizmi i ri mund të mbështetet në kapacitetet ekzistuese administrative (duke përfshirë hapësirën për zyrë dhe punonjësit) për të menaxhuar programin; nëse anëtarët e mekanizmit do të kenë nevojë për trajnim të specializuar lidhur me çështje të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, duke përfshirë edhe vlerësimin e shenjave identifikuese; si dhe në ç'masë vlerësohet pjesëmarrja e profesionistëve dhe e praktikantëve në mekanizëm si pjesë e punës së tyre dhe në ç'pjesë duhet konsideruar kompensimi ; dhe
3. Llojet e ndërhyrjeve që mund të ofrojë mekanizmi, përfshi këshillimin, trajnimin profesional, terapinë e artit ose dramën, si dhe programet sportive, të cilat mund të sigurohen nëpërmjet granteve të vogla.

Aty ku parashikohen mekanizma të tjerë, duhet menduar për krijimin dhe mbështetjen e një organizmi të vetëm “kryesor” - qoftë qeveritar apo joqeveritar - për administrimin dhe mbështetjen e mekanizmave në gjithë vendin.<sup>96</sup> Një mbështetje e tillë mund të përfshijë ngritjen e vetëdijes, trajnimin, përgatitjen e protokolleve për shkëmbimin e informacionit, menaxhimin e rasteve, kontrollin e cilësisë, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe menaxhimin e granteve.

## 5.13 Përfshirja në një proces të pavarur shqyrtimi

Duhet të ekzistojë një proces shqyrtimi i jashtëm, i pavarur që ka për qëllim të identifikojë çdo rrezik të mundshëm ndaj të drejtave të njeriut, i cili lidhet me aktivitete të tilla, si p.sh., stigmatizimi i grupeve të veçanta etnike ose fetare, shkëlja e të drejtave të privatësisë, lirisë së shprehjes dhe besimit fetar.

96 Shembuj të zbatimit të kësaj qasjeje janë Sekretariati i MERIT-it (Tryezat e ndërhyrjes së hershme me shumë agjenci - Multiagency Early Risk Intervention Tables), i cili mbështet “tryeza për shqyrtimin e situatës (situation tables) në gjithë Otavën dhe komunat përreth saj (shih <http://globalcommunitysafety.com/sites/default/files/merit-governance-chart.pdf>), dhe Ekipi i Koordinimit të FOCUS-it (Ndihmë për përparimin e komunitetit duke i bashkuar shërbimet - Furthering Our Community by Uniting Services), i cili mbështet katër tryeza të tilla në zonën e gjerë të Torontos (shih <https://www.toronto.ca/community-people/public-safety-alerts/community-safety-programs/focus-toronto/>).



# 6. Elementët kryesorë të procesit të mekanizmit të referimit

Nuk ka qasje që t'i përshtatet çdo situatë ku ngrihen dhe funksionojnë mekanizma referimi të formave dhe madhësive të ndryshme, e shpesh, edhe me terminologji të ndryshme. Megjithatë, siç theksohet në vijim dhe siç përshkruhet në këtë pjesë të raportit, ka disa komponentë themelore në procesin e mekanizmit të referimit që gjenden në pjesën më të madhe të programeve, si dhe disa pyetje themelore të cilave duhet t'i përgjigjet çdo mekanizëm.

## Elementët kryesorë të procesit të mekanizmit të referimit

### 1. PERSONI I REFERUAR

- a. Mënyrat e punës: *online*, linjë e drejtpërdrejtë telefonike, kontakte fizike
- b. Ngritja e vetëdijes
- c. Natyra vullnetare

### 2. VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE I DOBËSIVE

- a. Si bëhet vlerësimi?
- b. Kush vlerësohet?

### 3. EMËRIMI I PERSONIT PËRGJEGJËS PËR RASTET

### 4. ZHVILLIMI I PLANIT TË NDËRHYRJES OSE PLANIT MË TË GJERË TË MBËSHTETJES

- a. Si janë këto plane dhe këto ndërhyrje?
- b. Kush i zbaton?

### 5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

## 6.1 Personi i referuar

Për përcjelljen e një individi problematik në vëmendjen e mekanizmit të referimit, ekzistojnë shumë mënyra. Në disa raste, referimin e bën profesionisti i vijës së parë, që mund të jetë një efektiv policie apo punonjës social, punonjës shëndetësor apo punonjës që merret me të rinjtë. Në raste të tjera, referimin e bën një anëtar i familjes, një bashkëmoshatar, një person nga rrethi shoqëror i individit, mësuesi ose udhëheqësi fetar ose i komunitetit. Palët e interesuara duhet të kuptojnë se ku dhe si t'i paraqesin shqetësimet e tyre. Mekanizmi i referimit duhet t'i ndërgjegjësojë palët e interesuara për qëllimin dhe mandatin e tij, se si aksesohet mekanizmi dhe shërbimet që ofron. Duhet treguar kujdes i veçantë në strukturimin e mekanizmave të tillë, në mënyrë që të mos çojnë drejt raportimit të ekzagjeruar të çdo shqetësimi apo drejt stigmatizimit, si edhe të mos cenojnë besimin mes autoriteteve vendore dhe komuniteteve.

### 6.1.1 Mjetet e referimit: interneti, telefoni, personalisht

Një numër i konsiderueshëm referimesh bëhen kryesisht nga policia ose profesionistë të tjerë të vijës së parë, pavarësisht se përfaqësuesit e mekanizmit shpresojnë të marrin referime nga pjesëtarë të komunitetit. Për të lehtësuar referimet nga komuniteti, mekanizmi duhet të ofrojë mënyra të ndryshme referimi, qoftë edhe anonime, për raportimin e sjelljeve apo shenjave të dukshme të EDhRÇT-së.

Këto mjete mund të përdoren nga organizatorë ose udhëheqës të klubeve sportive apo qendrave fetare ose komunitare, nga profesionistë të vijës së parë si mësuesit, punonjësit socialë apo punonjësit që merren me të rinjtë. Si pjesëtarëve të komunitetit ashtu dhe profesionistëve mund t'u jepet mundësia të bëjnë referime nëpërmjet një formulari *online* në një faqe interneti ku mund të japin informacion, qoftë edhe anonim nëse është nevoja (një model formulari *online* jepet më poshtë).



## Shembull: formular referimi

Formulari *online* në faqen e internetit të organizatës ReDirect - Kalgari ([www.redirect.cpsevents.ca/make-a-referral/](http://www.redirect.cpsevents.ca/make-a-referral/)) ofron informacionin e mëposhtëm:

*Referimi juaj është tërësisht konfidencial dhe çdo informacion që na jepni trajtohet vetëm nga programi ReDirect. Informacioni nuk u vihet në dispozicion organeve ligjzbatuese apo agjencive të shërbimeve sekrete, përveç nëse ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për sigurinë publike (që ndodh shumë rrallë), rast në të cilin jemi të detyruar të bashkëpunojmë me hetuesit e organeve ligjzbatuese.*

*Nëse dëshironi, referimi juaj mund të jetë anonim për personin që referoni, por, na duhen të dhënat tuaja të kontaktit që t'ju kontaktojmë nëse kemi nevojë për më shumë informacion.*

*Pas referimit tuaj, do ta vlerësojmë informacionin që na keni dhënë dhe do të kontaktojmë personin e referuar prej jush.*

Një tjetër mënyrë është një linjë telefonike e dedikuar që menaxhohet nga bashkia, një agjenci shtetërore apo OJF.

Shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë linja telefonike për parandalimin e të gjitha krimeve, ndërkohë që gjithnjë e më shumë vende (si Austria, Kanadaja, Danimarka, Franca, Gjermania dhe Luksemburgu) po vendosin linja telefonike të dedikuara për rastet potenciale të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm.<sup>97</sup> Në varësi të kërkesës, më i përshtatshëm mund të jetë qasja e dyfishtë: një linjë telefonike që administrohet prej autoriteteve shtetërore dhe një tjetër nga OJF0-të, duke plotësuar nevojat e atyre që ndihen më rehat të hapen me autoritetet dhe të atyre që parapëlqejnë të flasin me një OJF me bazë komuniteti.

97 Qendra e Ekselencës e EU RAN, "Puna me Familjet dhe Mbrojtja e Fëmijëve nga Radikalizimi: Dokumenti udhëzues hap pas hapi për praktikantët dhe politikëbërësit", 2-3 shkurt 2017, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran\\_yf-c\\_h-sc\\_working\\_with\\_families\\_safeguarding\\_children\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_yf-c_h-sc_working_with_families_safeguarding_children_en.pdf).

### Shembull: linjë telefonike e dedikuar

Qendra Informuese e Ekstremizmit në Austri u krijua në dhjetor të vitit 2014 dhe administrohet nga bOJA, Rrjeti Federal për Punë të Hapur Rinore. Personeli përbëhet nga një ekip me gjashtë vetë që dinë disiplina dhe gjuhë të ndryshme. Linja telefonike e dedikuar ofron këshillim dhe referim për këshilluesit familjarë, punonjësit që merren me të rinjtë dhe shërbimet e punësimit, por ofron edhe këshillim ballë për ballë. Qendra punon pesë ditët e para të javës me orar 10:00 deri 15:00.

Në varësi të burimeve, ekspertizës dhe kapaciteteve të tjera ekzistuese, por edhe strukturës së mekanizmit të referimit, operatori i linjës telefonike (që duhet të marrë trajnim të posaçëm) mundet të mbajë shënim informacionin që merr nga telefonata dhe t'ia përcjellë ekipit të mekanizmit të referimit që shqyrton rastet individuale. Alternativa tjetër është që operatori të bëjë një vlerësim fillestar bazuar në informacionin që merr prej telefonatës dhe t'ia përcjellë rastin specialistit përkatës të ndërhyrjes ose ndonjë ofruesi tjetër shërbimesh për ndjekje.

Para se të krijohet një **linjë telefonike e dedikuar**, duhen verifikuar disa çështje.

Për shembull:

1. A ekzistojnë linja telefonike të dedikuara (p.sh. për parandalimin e krimit, trafikimin e qenieve njerëzore apo mirëqenien e fëmijëve) që mund të përdoren?
2. A duhet të jetë linja telefonike e re në nivel kombëtar apo vendor?
3. A duhet të jetë linja telefonike në dispozicion gjatë gjithë kohës (24 orë në ditë, 7 ditë në javë) apo vetëm gjatë orarit normal të punës?
4. A duhen pranuar telefonatat anonime?
5. Kush duhet t'u përgjigjet telefonatave? Për të rritur besimin e komunitetit të programi, ndoshta duhet që linja telefonike e dedikuar të funksionojë jashtë organeve ligjzbatuese apo strukturave të tjera të sigurisë; për këtë arsye, telefonatave nuk duhet t'u përgjigjet efektiv i policisë;
6. A duhet operatori të bëjë vlerësim fillestar, edhe në rast kërcënimi real ndaj sigurisë, apo thjesht dhe vetëm të mbajë shënim informacionin përkatës?
7. Në cilat rrethana (nëse ka), operator duhet t'ia përcjellë telefonatën policisë? Çfarë ekspertize duhet të ketë operatori dhe çfarë trajnimi të posaçëm duhet të marrë para se të vihet për të pritur telefonata?
8. Cilat strukturat të ndërhyrjes apo të tjera duhet të lidhen me linjën telefonike të dedikuar?

Siç shpjegohet në udhëzuesin e OSBE-së për policimin në komunitet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe për kundërvënien ndaj tyre, edhe pse “mundësia për të bërë referime në masën më të gjerë të mundshme mund të jetë e dobishme, ka rrezik që mekanizmi të mbingarkohet me referime shumica e të cilave mund të rezultojnë të pajustificuara. Prandaj, është thelbësore të trajnohen personat që pritet të përdorin mekanizmin e referimit, që të kuptojnë rrezikun e VERLT-it, t'i bëjnë oponentë supozimeve dhe stereotipeve si edhe të evidentojnë ndërthurjen e faktorëve që rezultojnë në rrezik për radikalizim të dhunshëm”.<sup>98</sup>

Pavarësisht metodës së referimit, personat e ngarkuar me ngritjen e mekanizmit duhet të mundësojnë që jo vetë referimi të jetë anonim, por edhe të kenë parasysh nevojën për të adresuar pasigurinë e personit që raporton dikë të përfshirë në rrjete sociale ekstremiste dhe që mund të jetë në rrugën e VERLT-it. Kur personi ka frikë për sigurinë e vet, kjo mund të dekurajojë pjesëtarët e komunitetit që të referojnë rastet

### 6.1.2 Rritja e ndërgjegjësimit

Përprjekjet për të zhvilluar mekanizëm referimi duhet të përfshijnë fushatë ndërgjegjësimi që përqendrohet te komunitetet dhe grupet e interesit si punonjësit socialë, mësuesit dhe profesionistët e shëndetësisë, të cilët mund të ngurrojnë të marrin pjesë në këtë nismë. Një fushatë e tillë mund të përfshijë burime *online*, duke përfshirë faqe me pyetje-përgjigje dhe video, si dhe trajnime e forume publike.

Në varësi të formës së mekanizmit, fushata të tilla ndërgjegjësimi mund të ofrojnë informacion në lidhje me:

1. Qëllimin e nismës (p.sh. të krijojë më shumë mundësi për ndërhyrje të hershme parandaluese që largojnë individët nga rruga e VERLT-it apo forma të tjera dhune);
2. Llojet e mbështetjes që ofron mekanizmi;
3. Natyrën vullnetare të programit dhe faktin që në rastet e të miturve, mund të kërkohet miratimi i prindit apo kujdestarit ligjor para se mekanizmi të punojë me personin e referuar;
4. Se si mekanizmi trajton jo vetëm të gjitha format e VERIT-it, por edhe shqetësimet e sigurisë në kontekst të gjerë;

98 OSBE, *Parandalimi i Terrorizmit dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*.

5. Se si programi nuk lejon që personat e referuar të regjistrohen në bazën e të dhënave penale, por edhe masat që merr për të ulur rrezikun që referimet të mund të çojnë në ndjekje penale (apo të hedhin dyshime) për individët e referuar;<sup>99</sup> dhe ndoshta më e rëndësishme
6. Edukimin, përfshirë programet e përshtatura për palë të ndryshme të interesuara (p.sh. për mësuesit, punonjësit socialë dhe të shëndetësisë, familjet dhe shoqërinë civile) për shenjat e dukshme paralajmëruese dhe jodiskriminuese që tregojnë se individi mund të jetë në rrezik apo në rrugën drejt VERLT-it.<sup>100</sup>

Krijimi i besimit brenda komuniteteve vendore (si dhe ndërmjet praktikantëve vendorë, profesionistëve dhe të tjerëve që do të ndërmarrin ndërhyrjet P/VERLT) duhet të jetë objektivi kryesor i punës ndërgjegjësuere. Sa më i fortë besimi i krijuar, aq më shumë qytetarët kontribuojnë dhe bashkëpunojnë me mekanizmin e referimit, pasi kanë bindjen se angazhimi i tyre “sjell rezultate pozitive dhe jo ndëshkim”.<sup>101</sup>

### 6.1.3 Natyra vullnetare

Pjesëtarët e komunitetit dhe institucionet duhet të nxiten që të referojnë individët pranë mekanizmit, sikundër vetë këta individë duhet të nxiten (dhe të stimulohen) që të përfitojnë nga ndërhyrjet apo planet mbështetëse që programi ofron. Në vend të vendosjes së detyrimit ligjor për të referuar, mekanizmi duhet të theksojë natyrën vullnetare të referimeve nga profesionistët, praktikantët dhe pjesëtarët e tjerë të komunitetit (përveç rasteve me fëmijë të mitur, ku Shteti dhe/ose profesione të caktuara si mësuesit apo punonjësit socialë dhe të shëndetit mund të kenë detyrimin të garantojnë mirëqenien apo të mbrojnë fëmijën).

Pas referimit të rastit, angazhimi i individit në kuadrin e ndërhyrjeve të rekomanduara apo paketave mbështetëse duhet të kushtëzohet me dhënien

99 Talene Bilazarian, Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Mësimet nga ndërhyrjet e hershme nga Programi “Channel” i Mbretërisë së Bashkuar, Programi për Ekstremizmin në Universitetin George Washington, tetor 2016, p. 8, <https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191/t/downloads/Channel%20CVE%20UJ.pdf>

100 Për shembull, përmbledhja e qasjeve dhe praktikave e Qendrës së Ekselencës RAN të BE-së ndaj P/CVERLT rekomandon që agjencitë e ndryshme “të pajisen me materiale trajnimi dhe edukimi për ndërgjegjësim. Në këto materiale trajnimi duhet të identifikohen dhe të përcaktohen qartë kërcënimet e radikalizimit dhe të përshkruhen qasje dhe modele pune me individët nga perspektiva e agjencive të ndryshme nga të gjithë sektorët. Trajnim duhet të ofrohet deri diku të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces, sipas specifikave të tyre në lëftën kundër radikalizimit, që nga drejtuesit e lartë deri tek punonjësit e vijës së parë. Aksesi në paketa mjetesh dhe manuale që ofrojnë një kuadër për vlerësimin dhe reagimin ndaj nevojave të individëve të rrezikuar përbën shpesh një ndihmë të rëndësishme.” Shih përmbledhjen e RAN të BE-së të Qasjeve dhe Praktikave, Parandalimi i Radikalizimit që çon në Terrorizëm dhe Ekstremizëm të Dhunshëm: Trajnim për Profesionistë Fillestarë, fq. 5, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-best-practices/docs/creating\\_counter\\_violent\\_extremism\\_infrastructures\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/creating_counter_violent_extremism_infrastructures_en.pdf). Për shembull, Komiteti Ndërmisor i Francës për Parandalimin e Krimin dhe Radikalizimit (CIPDR) ofron trajnime ndërgjegjësimi, ndër të tjera, për radikalizimin për biznesin, shoqatat profesionale, mësuesit, profesionistët e shëndetit mendor dhe për punonjësit socialë.

101 FGKT, *Nisma për ta adresuar terrorizmin e zhvilluar brenda vendit*, Praktika e mir 4.

e pëlqimit nga individit dhe jo si detyrim ligjor. Nëse individit i referuar është i mitur, me shumë gjasa kërkohet pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor që fëmija të vlerësohet dhe të marrë trajtim nëpërmjet mekanizmit. Mekanizmi i referimit funksionon në hapësirë jopenale, ndaj qasja joshtrënguese është e rëndësishme për disa arsye:

1. Vetëm një numër i vogël individësh mund të justifikojnë raportimin e rastit; vendosja e detyrimit ligjor për institucionet shtetërore që të referojnë individët që cilësohen të cenueshëm nga VERLT mund të rezultojë në mbiraportim të rasteve pozitive të rreme, që nxitet nga frika se po të mos e raportojë, personi mund të shkojë të kryejë një krim. Rastet pozitive të rreme mund të ndikojnë për keq në jetën dhe familjet e individëve të raportuar, madje, numri i lartë i tyre mund të minojë besueshmërinë e programit;
2. Raportimi i detyrueshëm mund të rezultojë në mbiraportim që rrezikon të distancojë segmente të caktuara të komunitetit bashkëpunimi dhe besimi i të cilave është thelbësor për efektivitetin e mekanizmit;<sup>102</sup>
3. Imponimi me ligj i detyrimit për zyrtarët publikë që të raportojnë sjellje të dyshimta rrezikon të krijojë mjedise që pengojnë lirinë e fjalës (p.sh. në klasë)<sup>103</sup> ose gërryejnë gatishmërinë e individit që t'i japë informacion një profesionisti të shëndetit mendor apo një figure me autoritet të besueshëm siç është mësuesi; dhe
4. Nëse kërkohet mbështetje komunitare edhe për raportimin e sjelljeve prirjeve edhe atëherë kur nuk është kryer ndonjë krim, duhet garantuar efektivitet, vullnet i lirë, pa forcuar pjesëmarrjen. Pjesëmarrja e detyruar në trajtim apo programe mund të sjellë më shumë dëm se të mira; e, për rrjedhojë, mund të përforcojë qëndrimet e tyre radikale.<sup>104</sup>

## 6.2 Vlerësimi i rreziqeve dhe i dobësive

Siç është përmendur në këtë udhëzues, mekanizmat e referimit duhet të mbështeten në mjete jodiskriminuese për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, me qëllim identifikimin e individëve që shfaqin shenja të radikalizimit drejt dhunës, përfshirë edhe nevojën për programe ndërhyrjeje individuale para se individit të kryejë akte terrorizmi. Rëndësia e mjeteve të tilla është theksuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, FGKT-ja dhe EU RAN.

102 Anne-Lynn Dudenhoefer, "Rezistenca ndaj Radikalizimit: Analizë kritike e programit "Prevent Duty" të Mbretërisë së Bashkuar", Qendra për Kriminologji, Universiteti i Oksfordit, blog, 18 shtator 2017, <https://www.law.ox.ac.uk/centres-institutes/centre-criminology/blog/2017/09/resisting-radicalisation-critical-analysis-uk>.

103 Frank Cranmer, "Liria e fjalës, detyra e parandalimit dhe arsimit i lartë", *Ligji dhe Feja në Mbretërinë e Bashkuar (Law & Religion UK)*, 5 prill 2017, <http://www.lawandreligionuk.com/2017/04/05/freedom-of-speech-the-prevent-duty-and-higher-education/>.

104 Daniel Koehler, *Të kuptuarit e çradikalizimit: Metodrat, Mjetet dhe Programet për t'iu Kundërvënë Ekstremizmit të Dhunshëm* (Routledge, 2016), fq. 232.

Një kuadër i tillë, nëse mbështetet në burime të shumta (p.sh. intervista me individin e referuar, anëtarët e familjes, bashkëmoshatarët dhe mësuesit; vëzhgime të rrjeteve sociale; dhe dosjet e rasteve të punonjësve socialë, profesionistëve të shëndetësisë apo atyre që merren me të rinjtë), mund të ofrojë një vlerësim shumëdimensional dhe objektiv të individit.

Mjetet e vlerësimit të mirëformuluara mund të ndihmojnë që:

1. Të zbutet stigmatizimi i mundshëm i masave parandaluese që perceptohen sikur u adresohen komuniteteve ose grupeve të veçanta, të cilat, nga ana tjetër, nxisin ndjenjën e distancimit dhe marxhinalizimit që mund të ushqejë radikalizimin drejt dhunës;
2. Të përcaktohet cilat ndërhyrje janë potencialisht efektive dhe cilat ndërhyrje të personalizuar janë të mjaftueshme;
3. Të garantohet se burimet zakonisht të kufizuara në dispozicion të ndërhyrjeve P/CVERLT dhe programeve të tjera mbështetëse të shkojnë te individët më të cenueshëm; dhe
4. Të identifikohen faktorët mbrojtës dhe burimet e mbështetjes.

### 6.2.1 Si bëhet vlerësimi?

Një çështje thelbësore për ata që krijojnë një mekanizëm referimi për P/CVERLT është mënyra se si të vlerësojnë rreziqet dhe pikat e dobëta.

Sot ekzistojnë forma dhe mjete të ndryshme për vlerësimin e rreziqeve dhe nevojave si për terroristët dhe autorët e veprave penale ekstremiste në një mjedis burgu, ashtu edhe për *skanimin* e individëve që *tashmë* janë radikalizuar drejt dhunës.<sup>105</sup> Megjithatë, janë të pakta mjetet e posaçme për ekstremizmin e dhunshëm, e madje edhe më të pakta mjetet e testuara dhe të verifikuara.

105 Për shembull, VERA-2 u zhvillua për t'u zbatuar për lloje të ndryshme ekstremistësh të dhunshëm, terroristësh dhe autorësh të veprave penale të dhunës, të motivuar nga ideologji fetare, politike apo shoqërore; po përdoret në disa shtete, kryesisht në mijësitë të sigurisë së lartë me individë të dënuar për dhunë ekstremiste. Modeli "I kthyeri 45" (Returnee 45) i Qendrës së Ekselencës të EU RAN është zhvilluar posaçërisht për vlerësimin e luftëtarëve të huaj terroristë si një kuadër për t'i udhëhequr hetimet e përgjithshme në motivimin, përkushtimin dhe faktorët e tjerë të rrezikut që ekzistojnë te një individ. Mbretëria e Bashkuar e zhvilloi "ERG+22" (Udhëzime për Rrezikun e Ekstremizmit) për përdorim në Programet e saj "Prevent" dhe "Channel", ndërsa IR46 është një mjet holandez që përdoret për vlerësime nga shumë agjenci në "shtëpitë e sigurisë". TRAP 18 (Protokolli i Vlerësimit të Radikalizimit Terrorist) ekziston për ta ndjekur përparimin afatgjatë të aktorëve individualë; ndërsa HCR 20 është një model i përdorur shpesh për ta vlerësuar rrezikun e dhunës pa u fokusuar në mënyrë të veçantë në dhunën ekstremiste. Për një rishikim të plotë të mjeteve relevante për vlerësimin e rrezikut dhe sfidat që lidhen me zbatimin e tyre për ta parashikuar VERT, shih RTI, Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Aplikimi i mjeteve të vlerësimit të rrezikut në drejtësinë penale dhe në procesin e rehabilitimit, rishikim i literaturës i përgatitur për Grupin e reaguesve të parë në Departamentin Amerikan të Sigurisë Kombëtare, Drejtoria e Shkencës dhe Teknologjisë, shkurt 2018, [https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/OPSR\\_TP\\_CVE-Application-Risk-Assessment-Tools-Criminal-Rehab-Process\\_2018Feb-508.pdf](https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/OPSR_TP_CVE-Application-Risk-Assessment-Tools-Criminal-Rehab-Process_2018Feb-508.pdf). Këto dhe mjetet e tjera të ngjashme të vlerësimit të rrezikut kanë pasur teste mjaft të kufizuara, kurse disa i kanë kritikuar se kanë tentuar ta parashikojnë të paparashikueshmen. Shih, për shembull, Rita Augestad Knudsen, "Matja e Radikalizimit: Konceptimet dhe praktikat e vlerësimit të rrezikut në Angli dhe Uells", Shkencat e Sjelljes së Terrorizmit dhe të Agresionit Politik, 2018, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/19434472.2018.1509105>.

Në fakt, vlerësimi i rrezikut nga ekstremizmi i dhunshëm është fushë relativisht e re që kërkon vlerësime dhe hulumtim të mëtejshëm; pra, mjetet e vlerësimit të rrezikut duhet të trajtohen me kujdes, sidomos kur piren të parashikojnë se kush mund të bëhet i dhunshëm.<sup>106</sup>

Një prej sfidave është fakti se nuk ekziston një profil ekstremisti të dhunshëm, një tregues i vetëm apo një kombinim treguesish që të vërtetojë se një individ po radikalizohet apo është radikalizuar drejt VERLT.<sup>107</sup> Në fakt, hulumtimet kanë treguar se disa faktorë i bëjnë të rinjtë të cenueshëm nga VERLT. Këtu bëjnë pjesë ndjesia e përjashtimit, e padrejtësisë dhe diskriminimit; mungesa e aksesit në arsim ose punësim; dhuna në familje ose dhuna shtetërore; si dhe vepra penale të lehta. Treguesit kryesorë që tregojnë se individit po orientohet drejt VERLT mund të jenë: ndryshimet në sjellje, ideologji dhe/ose në rrjetin social të personit.<sup>108</sup>

Së fundmi, një analizë e literaturës ekzistuese mbi mjetet e vlerësimit të rrezikut, vuri re edhe disa sfida të tjera.<sup>109</sup> Konkretisht:

1. VERLT është dukuri e rrallë; edhe pse shumë individë mund të kategorizohen në një profil të caktuar, shumica dërrmuese tyre nuk kryejnë asnjëherë akte dhune;
2. Asnjë prej mjeteve të vlerësimit të rrezikut nuk është vërtetuar në mënyrë empirike - pjesërisht për shkak të numrit të vogël të incidenteve VERLT dhe pjesërisht për shkak se shpesh vriten gjatë aktit terrorist ose arrestohen, kështu që studiuesit nuk mund t'i intervistojnë; dhe
3. Analiza statistikore e faktorëve të rrezikut që lidhen me VERLT është bërë më e ndërlikuar, sepse “motivet për përfshirje në ekstremizëm të dhunshëm mund të varen nga kontekste të ndryshme kulturore dhe historike”, kontekste të cilat nuk pasqyrohen në mjetet e vlerësimit të rrezikut.

Nisur nga këto sfida dhe faktit se mjetet e vlerësimit të rrezikut kanë pak ose aspak vlerë parashikuese, ato prapë mbeten të rëndësishme për procesin P/ CVERLT, ndërkohë që disa mjete ekzistuese apo kuadre të tjera përmbajnë tregues posaçërisht për ekstremizmin e dhunshëm.

106 Qendra Globale për Sigurinë e Bashkëpunimit, “Rekomandime për shqyrtim për Komitetin Kundër Terrorizmit në Miratimin e Shtojcës së vitit 2018 të Parimeve Udhëzuese të Madridit”, nëntor 2018, fq. 3, [https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28\\_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf](https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf).

107 Po aty.

108 FGKT, *Iniciativa për ta adresuar ciklin jetësor të radikalizimit drejt dhunës, Memorandum i Nojshatellit mbi praktikën e mira për drejtësinë për të mitur në kontekstin kundër terrorizmit*, <https://theiij.org/wp-content/uploads/English-Neucha--tel-Memorandum-on-Juvenile-Justice.pdf>.

109 RTI, *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Aplikimi i Mjeteve të Vlerësimit të Rrezikut*.

Për shembull, mjeti i vlerësimit “Channel” i Mbretërisë së Bashkuar<sup>110</sup> analizon dobësitë brenda kritereve të gjera siç është *angazhimi* në ndonjë grup, kauzë apo ideologji; *dashja* për të shkaktuar dëm; dhe *aftësia* për të shkaktuar dëm.<sup>111</sup> Mjeti i Vlerësimit të Rrezikut për Ekstremizmin e Dhunshëm “VERA-2R” përmban 34 tregues të ndarë në pesë fusha: besimet, qëndrimet dhe ideologjitë; konteksti shoqëror dhe qëllimi; historia, veprimi dhe kapaciteti; përkushtimi dhe motivimi; dhe treguesit mbrojtës dhe që zbusin rrezikun. Ekzistojnë edhe 11 tregues të tjerë që bazohen në literaturën shkencore për dhunën e përgjithshme dhe historikun kriminal, historikun personal dhe karakteristikat e shëndetit mendor.<sup>112</sup>

Projekti SAFIRE (Qasja Shkencore për Gjetjen e Treguesve dhe Përgjigjeve ndaj Radikalizimit) që financohet nga BE-ja, krijoi një grup me 21 tregues të vëzhgueshëm të “radikalizimit” të mundshëm, si p.sh., format e frymëzuara nga ekstremizmi i djathtë dhe feja të identifikuar përmes konsultimeve me efektivët e policisë, punonjësit socialë dhe mësuesit e përfshirë në punën P/CVERLT. Treguesit e projektit SAFIRE grupohen në pesë fusha tematike: identiteti dhe kërkimi i identitetit; diferencimi brenda dhe jashtë grupit; ndërveprimet shoqërore pro dhunës; ndryshime personaliteti; dhe lidhjet shoqërore.<sup>113</sup>

Ndërkohë që pranon nevojën për zhvillimin e mjeteve të kontekstualizuara të vlerësimit, FGKT-ja ka vënë në dukje se çdo mjet i tillë duhet të përfshijë “faktorë, variabla dhe tregues të veçantë që lidhen me terrorizmin, të rëndësishëm për t’u marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të një individi, siç është mosha, gjinia, shëndeti mendor dhe përcaktues të tjerë të identitetit.”<sup>114</sup>

Edhe pse personat e ngarkuar me krijimin e mekanizmit të referimit për rastet VERLT duhet të mbajnë parasysh këto dhe të tjera qasje, çdo mekanizëm duhet të bazohet në një qasje për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave që pasqyrojnë kontekstin dhe nevojat specifike të komunitetit ku do të zbatohet.

110 Udhëzime për rrezikun e ekstremizmit (ERG) 22+. Për një diskutim të mjetit të vlerësimit të programit “Channel” të Mbretërisë së Bashkuar, shih, për shembull, Monica Lloyd dhe Christopher Dean, “Zhvillimi i udhëzimeve të strukturuarra për vlerësimin e rrezikut të shkelësve ekstremistë” *Revista e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Kërcënimeve*, 2, nr. 1 (2015): fq. 40-52.

111 Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar, *Udhëzim për programin Channel: Mbrojtja e njerëzve të rrezikuar nga përfshirja në terrorizëm - Udhëzime Statutore për Anëtarët e Panelit të Programit “Channel” dhe Partnerët e Paneleve Lokale*, prill 2015, fq. 11, [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/425189/Channel\\_Duty\\_Guidance\\_April\\_2015.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/425189/Channel_Duty_Guidance_April_2015.pdf).

112 Ministria e Drejtësisë dhe e Sigurisë, Vendet e Ulëta, “VERA-2R,” <https://www.vera-2r.nl/>.

113 Shih “Përmbledhje e Raportit Përfundimtar: SAFIRE (Qasja Shkencore për Gjetjen e Treguesve dhe Përgjigjeve ndaj Radikalizimit)” në faqen e internetit të Cordis, <https://cordis.europa.eu/project/rcn/94537/reporting/en>.

114 FGKT, *Iniciativa për ta adresuar terrorizmin e zhvilluar në vend*, Praktika e mirë 11.



Për shembull, përgatitja e çdo kuadri specifik vlerësimi duhet:

1. Të mbështetet në studime vendore të kontekstualizuara se cilët janë faktorët shtytës dhe tërheqës të VERLT që të garantohet se faktorët e përdorur në vlerësim kanë lidhje me popullatat e synuara;
2. Të zhvilloje konsultime ndër-institucionale dhe multidisiplinare mes praktikuesve dhe profesionistëve që marrin pjesë në konstatimin e individit që referohet te mekanizmi në komunitet;
3. Të evidentojë kontekste politike dhe shoqërore më të gjera dhe plotësuar, që të merren parasysh nga profesionistët që vlerësojnë rrezikun dhe cenueshmërinë ndaj VERLT;
4. “Jo vetëm të bazohet te rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm, por të shqyrtojë edhe faktorët mbrojtës dhe të përballjes,”<sup>115</sup> si p.sh., rrjetet familjare dhe/ose shoqërore pozitive, menaxhimi i pritshmërive, mundësitë për agjencitë dhe fuqizimin, njohuritë fetare, aftësitë e ndërveprimit shoqëror dhe qytetaria demokratike;<sup>116</sup> dhe
5. Të informohet dhe të ketë ndërlidhje me ndërhyrjet dhe shërbimet mbështetëse, me qëllim që të zbatohen trajtimet apo programet e duhura për të trajtuar rreziqet apo cenueshmëritë e identifikuara.

### Elementët kyçë për vlerësimin e rrezikut P/VERLT

1. Mbështetje në studime vendore të kontekstualizuara lidhur me popullatat e synuara;
2. Konsultime me praktikuesit dhe profesionistët vendorë, përfshirë edhe qëllimin për t'u mbështetur në burime informacioni të shumëllojshme.
3. Marrja parasysh e konteksteve më të gjera politike dhe sociale.
4. Evidentimi i faktorëve të mbrojtjes dhe përballjes, si edhe të rreziqeve që lidhen me ekstremizmin.
5. Të informohet dhe të ketë ndërlidhje me ndërhyrjet dhe shërbimet mbështetëse.

Gjithashtu, çdo proces vlerësimi duhet të informohet nga disa burime informacioni, duke përfshirë intervistat me individin, anëtarët e familjes, bashkëmoshatarët dhe mësuesit; vëzhgimet nga rrjetet sociale; si edhe dosjet e rasteve të punonjësve socialë, të shëndetit mendor, atyre që merren me të rinjtë dhe profesionistë të tjerë përkatës.

115 Qendra Globale për Sigurinë e Bashkëpunimit, Rekomandime për shqyrtim për Komitetin Kundër Terrorizmit në Miratimin e Shtojcës së vitit 2018 të Parimeve Udhëzuese të Madridit, nëntor 2018, fq. 3, [https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28\\_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf](https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf).

116 Qendra e Ekselencës e EU RAN, “Faktorët Mbrojtës dhe Promovues për Ndërtimin e Qëndrueshmërisë ndaj Radikalizimit të Dhunshëm”, prill 2018, [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/ran\\_paper\\_protective\\_factors\\_042018\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_paper_protective_factors_042018_en.pdf).

Për më tepër, duke qenë se çdo mjet/kuadër vlerësimi për rrezikun e individit ka më shumë ndikim kur përfshin trajtimin për eliminimin e cenueshmërive të evidentuara, ky kuadër duhet të pasqyrojë informacionin që vjen nga ndërhyrjet dhe shërbimet mbështetëse që ekzistojnë në vend.

Çdo mjet/kuadër vlerësimi duhet të bëjë të mundur që informacioni i mbledhur të paraqitet në një mënyrë të tillë që të lejojë vlerësimin në kohë dhe në mënyrë të strukturuar. Për më tepër, personat e ngarkuar me përdorimin e këtij mjeti/kuadri për vlerësimin e rrezikut apo cenueshmërive, duhet të kenë ekspertizën e duhur për të marrë vendime të informuara për rastet individuale, si edhe të kenë akses në mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional, sipas nevojës dhe në mënyrë sistematike. Ata që administrojnë vlerësimet duhet të jenë të vetëdijshëm se mjetet e vlerësimit kanë kufizimet e tyre dhe të kuptojnë objektin e plotë të çështjeve të të drejtave të njeriut që lidhen me vlerësimin.

Mbi të gjitha, është thelbësore që mekanizmi i referimit (i) të bazohet në një kuadër jodiskriminues që përfshin një grup treguesish të sjelljes që shërbejnë për të vlerësuar rreziqet dhe cenueshmëritë, (ii) të mos përdorë qasjen me listë kontrolli që mund të rritë gjasat e referimeve pozitive të rreme, (iii) si edhe të zbatohet nga ofrues kujdesi psikosocial dhe profesionistë të përshtatshëm që kanë trajnimin e duhur

### 6.2.2 Kush e bën vlerësimin?

Sikundër u përshkrua mungesa e modeleve specifike të mekanizmave të referimit, duhet theksuar mungesa e një qasjeje që do t'i përshtatej çdo situatë kur rekomandohet profesionisti përgjegjës për kryerjen e vlerësimit. Për të garantuar sigurinë, profesionisti përgjegjës për kryerjen e vlerësimit duhet të jetë pjesë e një ekipi të trajnuar si duhet. Megjithatë, siç u theksua nga grupi i punës i shëndetësisë dhe i kujdesit social i RVR-së i BE-së, “një keqkuptim i zakonshëm i vlerësimeve të rrezikut lind kur ato paraqiten si “të ndërlikuara” ose kur kërkojnë trajnime të konsiderueshme formale. Edhe pse praktikantët duhet të njihen me mjete të tilla (dhe mundësisht të përfshihen në përdorimin dhe përmirësimin e tyre me kalimin e kohës), në thelb, këto mjete nuk janë të vështira për t'u përdorur ose për t'u zbatuar. Zakonisht, këto mjete përdoren si udhëzime, të shoqëruara edhe me informacione të tjera orientuese”.<sup>117</sup>

117 RVR-ja e BE-së, “Vlerësimi i rrezikut për autorët e veprave penale që veprojnë vetëm”, fq. 6

Në përgjithësi, mekanizmi duhet të projektohet për të mundësuar shkëmbimin e njohurive, informacioneve dhe ekspertizës mes anëtarëve të një ekipi shumëdisiplinar në lidhje me rastin e referuar për përcaktimin e veprimeve të mëtejshme. Në varësi të kontekstit lokal, kjo mund të përfshijë edhe informacione nga policia, të cilat luajnë rol në vlerësimin e rrezikut. Megjithatë, siç përmendet në këtë udhëzues, përfshirja e tepërt e policisë e dëmton besimin tek profesionistët, praktikantët dhe anëtarët e komunitetit lokal që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese, besim që nevojitet për suksesin e një mekanizmi referimi që vepron në hapësirën jopenale.

Rezultati i vlerësimit duhet të reflektohen, në një mënyrë apo në një tjetër, tek mandati, përshkrimi i aktiviteteve dhe përgjegjësitë e mekanizmit, ose në dokumentet e tjera të themelimit. Për shembull:

1. Vlerësohet se individit nuk paraqet sjellje të orientuara drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm, por ai (individit) mund të përfitojë nga programe të tjera të përgjithshme, si për shembull nga programet mbështetëse për të rinjtë problematikë; e, për pasojë, rasti i referohet agjencisë ose organizatës që ofron mbështetje të tillë;
2. Vlerësohet se individit tregon prirje drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, të cilat mund të adresohen nga ndërhyrje ose programe të tjera ekzistuese, përmes mekanizmit. Në këtë rast, grupi do të bëjë një vlerësim më të hollësishëm për të identifikuar dobësitë dhe faktorët mbrojtës në mënyrë më specifike, dhe më pas do të vendosë për ndërhyrjen e nevojshme ose për planin e mbështetjes dhe, nëse është e nevojshme, do t'i planifikojë këta ndërhyrje ose plane; ose
3. Vlerësohet se individit ka kaluar pragun penal ose paraqet rrezik për të shkaktuar dëm të menjëhershëm. Në këtë rast, çështja i referohet menjëherë policisë.

## 6.3 Emërimi i personit përgjegjës për rastet

Emërimi i një personi përgjegjës për çdo rast orienton përgjegjësinë institucionale për realizimin dhe mbikëqyrjen e ndërhyrjes/programit të mbështetjes. Personi përgjegjës për rastin mund të shërbejë si pika e vetme e kontaktit me individin, familjen dhe komunitetin. Kjo mënyrë garanton ndërhyrje efikase nga ana e mekanizmit, forcon besimin tek ai, dhe prezanton përfaqësuesit e rastit konkret, duke i shmangur kontaktet e tepërta raste specifike.<sup>118</sup>

118 Qendra e Ekselencës e RVR-së e BE-së, "Doracak për mënyrat e krijimit të një strukture me shumë agjenci".

Kështu, për shembull, në një sërë kontekstesh, duke përfshirë Belgjikën, Danimarkën dhe Norvegjinë, një anëtar i familjes ose punonjësi social, së bashku me një përfaqësues të policisë lokale marrin përsipër menaxhimin e rastit dhe realizojnë kontaktin e parë me familjen. Në raste të tilla, Qendra e Ekselencës e RVR-së e BE-së ka rekomanduar që policia lokale të prezantohet pa uniformë, me “veshje civile – duke e bërë situatën më pak kërcënuese dhe duke e shmangur turpin që çon drejt stigmatizimit të personit në rrethin apo lagjen e tij”.<sup>119</sup>

## 6.4 Hartimi i një plani ndërhyrjeje ose i një plani më të gjerë mbështetjeje

Një mekanizëm referimi duhet të jetë në gjendje të ofrojë një ndërhyrje ose një plan më të gjerë mbështetjeje që i përshtatet nevojave të identifikuara dhe që vlerëson moshën, gjininë, formimin kulturor dhe faktorët e rrezikut që paraqet individi. Siç përmendet më sipër, jo të gjitha referimet do të çojnë në hartimin e një trajtimi të përshtatur; për shembull, në disa raste mund të kërkohet përcjellja e drejtpërdrejtë në polici; ndërsa, në raste të tjera, rreziqet apo dobësitë ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm mund të konsiderohen të ulëta, ndaj vendimi për aktivitete parandaluese mund të mos jetë i nevojshëm. Në rastin e dytë, individi i referuar mund të inkurajohet të marrë pjesë në një program ekzistues që vepron në grup ose në komunitet, si për shembull programi që punon me të rinjtë problematikë.

### 6.4.1 Cilat lloje ndërhyrjesh apo planesh më të gjera mbështetjeje ofrohen?

Një mekanizëm referimi mund të ofrojë një sërë ndërhyrjesh dhe planesh mbështetëse për adresimin e dobësive dhe për forcimin e faktorëve mbrojtës të identifikuar gjatë vlerësimit. Diapazoni i shërbimeve që ofron një mekanizëm do të varet nga burimet në dispozicion dhe nga ekspertiza dhe kapacitetet e profesionistëve, praktikantëve dhe institucioneve të përfshira në mekanizëm dhe përfshin një ose më shumë shërbime si më poshtë:

1. Këshillim familjar ose individual psikosocial;
2. Ndërgjegjësim dhe trajtim rehabilitues në rastin e përdorimit të drogave dhe të alkoolit;

<sup>119</sup> Qendra e Ekselencës e RVR-së e BE-së, “Puna me familjet dhe mbrojtja e fëmijëve nga radikalizimi”, fq. 7.

3. Programe mentorimi që përfshijnë mbështetje ideologjike ose teologjike, aty ku është e përshtatshme;
4. Trajnime profesionale dhe ndihmë gjatë punësimit;
5. Trajnime për ndërmjetësim dhe menaxhim konfliktesh;
6. Trajnime për tolerancë ndaj diversitetit ose programe të tjera edukative;
7. Trajtime në rastet e varësisë nga drogat ose ndonjë varësie tjetër; dhe
8. Terapi përmes artit, muzikës ose sportit.<sup>120</sup>

Në disa raste, mund të rekomandohet një ndërhyrje e vetme; në raste të tjera, mund të ofrohet një paketë mbështetjeje. Menaxheri i rastit ose anëtarët e tjerë të ekipit vlerësues mund të projektojnë një ndërhyrje të re për individin dhe/ose të rekomandojnë që individi të marrë pjesë në një program ekzistues parandalimi, si për shembull në programe që fokusohen në ndërtimin e besimit me policinë lokale, krijimin e kundërnarrativave online, trajnimet për të rinjtë mbi pasojat negative të anëtarësimit në grupet të dhunshme ekstremiste dhe ofrimin e alternativave jo të dhunshme për të rinjtë që tregojnë shenja të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Në të gjitha rastet duhen shfrytëzuar kapacitetet dhe burimet ekzistuese institucionale dhe profesionale, duke përfshirë edhe ato që lidhen me qendrat e kujdesit social, këshillat komunalë të sigurisë, bashkësitë fetare dhe qendrat rinore. Kjo tregon rëndësinë e hartëzimit të hollësishëm të kapaciteteve dhe të burimeve të tilla, si dhe diapazonin e programeve ekzistuese të parandalimit/kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm në komunitetin përkatës si dhe fuqizimin (para krijimit të mekanizmit) e një rrjeti ofruesish shërbimesh që mund të jenë partnerë të mekanizmit të referimit.

Kjo qasje mund të përfshijë trajnime dhe seminare për mënyrën e identifikimit dhe adresimit të shenjave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Këto lloj aktivitetesh mund të realizohen për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, duke informuar mbi proceset parandaluese kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Anëtarët e familjes dhe bashkëmoshatarët mund të lidhen me grupet përkatëse ose rrjetet mbështetëse.

---

120 Për të parë shembuj të gamës të shërbimeve që mund të ofrojë një mekanizëm referimi, shih, për shembull, Zyra për Siguri dhe Kundër-Terrorizëm, Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Programi Channel: Mbrojtja e njerëzve të rrezikuar nga përfshirja në terrorizëm, tetor 2012, fq. 17, [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/425189/Channel\\_Duty\\_Guidance\\_April\\_2015.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/425189/Channel_Duty_Guidance_April_2015.pdf); dhe Hemmingsen, Hyrje në qasjen daneze për t'u kundërvënë dhe për ta parandaluar ekstremizmin dhe radikalizimin, fq. 26-27, <https://www.ft.dk/samling/20151/almdel/reu/bilag/248/1617692.pdf>.

## 6.4.2 Kush e realizon ndërhyrjen ose planin e gjerë të mbështetjes?

Në varësi të nevojave dhe dobësive të vlerësuara, si dhe trajtimit të rekomanduar, një grup profesionistësh, praktikantësh dhe aktorësh të tjerë mund të përfshihen në zbatimin e ndërhyrjes ose të planit më të gjerë të mbështetjes. Këtu mund të përfshihen:

1. Punonjësit socialë, punonjësit shëndetësorë dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë;
2. Mentorët fetarë ose mentorë të tjerë;
3. Këshilluesit për drogën dhe/ose alkoolin ose këshillues të tjerë;
4. Trajnerët sportivë, trajnerë çështjesh jetësore ose trajnerë të tjerë;
5. Ish-ekstremistë të dhunshëm;
6. Mësuesit;
7. OShC-të lokale.

Duke pasur parasysh se mekanizmi i referimit duhet të veprojë në hapësirën jopenale, anëtarët e komunitetit duhet të sigurohen që referimet të mos përfshijnë policinë (me përjashtim të rasteve kur rreziku është i menjëhershëm) për adresimin e dobësive të atyre që konsiderohen se janë në rrezik nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm. Përfshirja e policisë, veçanërisht në zonat ku ende nuk zbatohen praktikatat e policimit në komunitet, rrezikon ta cenojë besueshmërinë e programit dhe ta vështirësojë përfshirjen në mekanizëm të profesionistëve dhe të praktikantëve që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese.

## 6.5 Monitorimi dhe vlerësimi

Ashtu si me shumë programe parandalimit/kundërvënije ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, një plan gjithëpërfshirës monitorimi dhe vlerësimi është shumë i rëndësishëm, si për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare, politike dhe komunitare, ashtu edhe për përballimin e sfidës së dëshmimeve të sjelljeve të gabuara.

Një kornizë e mirë monitorimi dhe vlerësimi (M&V) për mekanizmat e referimit jo vetëm që thekson sukseset, por edhe identifikon me transparencë dobësitë dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Çdo kornizë e tillë duhet të vlerësojë procesin e krijimit dhe të funksionimit të mekanizmit të referimit, ndërhyrjet ose planet mbështetëse të ndërmarra në bazë të referimeve të marra, si dhe ndikimin që mekanizmi ka në plan individual. Mësimet e nxjerra duhet të ndahen me partnerët e mekanizmit për ta përshtatur dhe për ta përmirësuar procesin, aty ku është e nevojshme.

Përkundër faktit se parandalimi është një proces afatgjatë, vlerësimet duhet të përqendrohen edhe në rezultatet afatshkurtra dhe afatmesme.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të mbajë në konsideratë gjininë dhe moshën, numrin dhe natyrën e referimeve (duke vënë në dukje llojet e ndërhyrjeve ose komponentët e planeve më të gjera mbështetëse), treguesit e disponueshëm të rezultateve, që lidhen me punësimin, arsimimin, strehimin, shëndetin dhe pjesëmarrjen në klubet rinore ose sportive.<sup>121</sup> Kur është e mundur, të dhënat statistikore për referimet duhet të bëhen të njohura për publikun për të fituar besimin e tij dhe për të nxitur pjesëmarrjen e vazhdueshme të agjencive të tjera në program.<sup>122</sup>

Megjithatë, korniza duhet të ofrojë shumë më tepër sesa vetëm mbledhjen e dhënave statistikore. Ajo duhet të përfshijë të dhëna cilësore për individët e referuar, informacione të mbledhura nga pyetësorët e plotësuar nga individit i referuar, të afërmit dhe bashkëmoshatarët e tij. Ajo gjithashtu duhet të përmbajë histori të individëve dhe të familjeve, jetët e të cilëve kanë pësuar ndikim pozitiv si rezultat i një ndërhyrjeje apo mbështetjeje pas referimit. Për shembull, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar ka botuar tregime anonime të individëve realë që janë mbështetur nga programi Channel.<sup>123</sup> Përveç këtyre historive të vërteta, individët e referuar mund të nxitin dhe inkurajohen të flasin për këtë.<sup>124</sup>

Ndikimet e tjera pozitive të matshme përfshijnë rritjen e besimit mes komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve rreth çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, zvogëlimin e numrit të telefonatave në polici për individë të dyshimtë dhe në bashkëpunim mes ofruesve të shërbimeve rreth çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Korniza mund të përfshijë vlerësime periodike të pjesëmarrjes së institucioneve përkatëse, profesionistëve dhe praktikantëve në mekanizëm; për shembull, mund të shqyrtojë pse disa pjesëmarrës janë më të gatshëm se të tjerët të angazhohen në mekanizëm, si dhe ta shqyrtojë aspektin e trajnimit dhe mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve që u ofrohet profesionistëve të përfshirë në vlerësimin e rreziqeve dhe dobësive. Më tej, mund të monitorohet ndërgjegjësimi dhe përpjekjet për angazhimin e komunitetit, si elementë kyç për të siguruar pjesëmarrje të vazhdueshme dhe mbështetje të komunitetit.

121 Për shembull, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar publikon një buletin vjetor statistikor mbi "individët e referuar në Programin Prevent dhe të mbështetur përmes tij", [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/694002/individuals-referred-supported-prevent-programme-apr2016-mar2017.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/694002/individuals-referred-supported-prevent-programme-apr2016-mar2017.pdf).

122 Rritja e numrit të referimeve mund të jetë tregues i ngritjes së vetëdijes dhe i legjitimitetit të mekanizmit.

123 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, *Programi Channel*, <https://www.gov.uk/government/case-studies/the-channel-programme>.

124 Qendra e Ekselencës e RVR-së e BE-së, "Doracak për krijimin e strukturave me shumë agjenci".

Përveç këtij vlerësimi, korniza ndjek ndërhyrjet dhe planet e gjera të mbështetjes, duke vlerësuar përdorimin e vlerësimeve të efektit të referimit mbi personin e referuar dhe vlerësimeve të rrezikut për personat e referuar. Vlerësimet e efektit të referimit mbi personin e referuar, të cilat bazohen në të njëjtat kritere të vlerësimit të rrezikut që janë përdorur edhe në fillim, janë të rëndësishme për një sërë arsyesh. Së pari, ato mund të na sigurojnë se ndërhyrja po e jep efektin e synuar, e nëse jo, ndërhyrja mund të përshtatet ose, nëse është e nevojshme, të zëvendësohet me një tjetër. Së dyti, ato mund të tregojnë nëse individi shfaq sjellje që mund të çojnë në një rrezik të lartë të përfshirjes në dhunë dhe të kërkojnë referimin e menjëhershëm në polici. Së treti, ato mund të ndihmojnë në vlerësimin e efikasitetit të llojeve të caktuara të ndërhyrjeve dhe “të kontribuojnë për avancimin e shkencës në fushën e parandalimit të radikalizimit dhe të ndërhyrjeve për dhunë ekstremiste”.<sup>125</sup>

---

125 Intervistë telefonike me Casey Tischner, RTI, 25 tetor 2018.







# 7. Konteksti i Evropës Juglindore

Në Evropën Juglindore dhe në gjithnjë e më shumë rajone, politikëbërësit dhe praktikantët po e pranojnë gjithnjë e më tepër rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve P/CVERLT. Gjithnjë e më shumë po pranohet qasja që në qendër të përpjekjeve duhet të përfshihet e gjithë shoqëria. Qeveritë tani janë në faza të ndryshme të hartimit dhe vënies në zbatim të planeve të veprimit P/CVE dhe të mekanizmave të bashkërendimit ndërinstitucional që përfshijnë aktorë të sigurisë dhe jo të sigurisë; një numër gjithnjë e më i madh OShC-sh po përfshihet në aktivitetet e parandalimit/kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm; ndërsa donatorët ndërkombëtarë po i rrisin investimet për studimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe në programet e parandalimit, veçanërisht ato që fuqizojnë palët e interesuara vendore - përfshirë drejtuesit kulturorë, komunitarë, fetarë dhe arsimorë - për adresimin e faktorëve shtytës themelorë të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm dhe për t'u ofruar të rinjve alternativa ndaj dhunës ekstremiste.

Me këtë fokus të shtuar në parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, si dhe duke pasur parasysh nevojën për qasje shumëdisiplinare ndaj parandalimit dhe ndërhyrjes, qeveria qendrore, aktorët vendorë dhe donatorët ndërkombëtarë po mendojnë nëse koncepti i mekanizmit të referimit mund të vihet në zbatim në rajon dhe si. Një pjesë e madhe e pikëpamjeve të paraqitura deri më tani në këtë udhëzues janë të vlefshme për rajonin. Megjithatë, ka edhe faktorë dhe sfida që janë të veçanta për rajone të caktuara, duke përfshirë ato që lidhen me çështjet kulturore, shoqërore ose politike, të cilat duhet të merren parasysh dhe të adresohen.

Në radhë të parë, megjithëse dhuna ekstremiste në Evropën Juglindore paraqitet në forma të ndryshme - si për shembull dhuna etnike-nacionaliste, dhuna e frymëzuar nga islamizmi dhe dhuna neonaziste - ku radikalizimi drejt dhunës është shpesh rezultat i tensioneve historike dhe të hershme etnike, qeveritë në rajon shpesh e kanë kufizuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin

që çon në terrorizëm sikur lidhet vetëm me rrymën islamike dhe fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë që kanë qenë në zonat e konfliktit, veçanërisht në Irak dhe Siri. Format e tjera të dhunës ekstremiste shpesh nuk trajtohen (qoftë nga drejtuesit politikë, politikëbërësit, apo sistemet ligjore) me të njëjtin nivel shqetësimi si ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm i frymëzuar nga islamizmi. Më tej, sipas një raporti rajonal hartëzimi të fundit, donatorët ndërkombëtarë priren t'i fokusojnë shumicën e nismave në rajon për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm në vetëm një formë: atë që lidhet me ISIS-in.<sup>126</sup> Ky fokusim i ngushtë vazhdon edhe pse evidencat tregojnë se ekstremizmi i djathtë përbën kërcënim më urgjent për rajonin, sipas shumë aktorëve të shoqërisë civile, shihet si kërcënim më urgjent për rajonin.<sup>127</sup>

Kjo qasje rrezikon të ndërlikojë përpjekjet për të ngritur një mekanizëm referimi që trajton të gjitha format e dhunës ekstremiste, për të mos përmendur dimensionin e shqetësimeve për sigurinë. Siç theksohet më lart, fokusimi i ngushtë në një formë të vetme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm mund t'i rrisë ndjenjat e përjashtimit dhe të izolimit midis grupeve që ndihen të shënjestruara padrejtësisht. Kjo mund ta nxisë procesin e radikalizimit drejt dhunës teksa shpërfillet fenomeni në rritje i “ekstremizmit reciprok”.<sup>128</sup>

Së dyti, për shkak të një përzierjeje faktorësh, duke përfshirë edhe dekadat e sundimit komunist dhe së fundmi vite të tëra konfliktesh ndëretnike, në të gjithë rajonin është shumë e ulët shkalla e besimit mes qytetarëve dhe institucioneve të reja shtetërore, duke përfshirë edhe policinë - që zakonisht është element kyç në një mekanizëm efektiv referimi, ku institucionet fetare gëzojnë më shumë besueshmëri brenda disa komuniteteve sesa organet e pushtetit vendor apo qendror. Perceptimi mes shumë qytetarëve (sidomos atyre që i përkasin një pakice etnike ose fetare) është se policia e sheh rolin e saj në funksion të mbrojtjes së shtetit e jo për t'u shërbyer komuniteteve vendore. Për më tepër, qytetarëve ndonjëherë u rezulton e vështirë t'u përcjellin shqetësimet e tyre zyrtarëve shtetërorë dhe institucioneve.

126 Po aty.

127 Forumi MNE, “Organizatet e shoqërisë civile në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor: Raporti i hartëzimit”, shkurt 2019, [https://organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2019/02/regional\\_report.pdf](https://organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2019/02/regional_report.pdf).

128 Ky koncept sugjeron se grupet e dhunshme ekstremiste bëhen më ekstremiste në përgjigje të aktiviteteve të grupit tjetër, sepse e justifikojnë dhunën ngaqë e perceptojnë grupin tjetër si ekstremist. Shih Samantha McGarry, “E Djathta Ekstreme dhe Radikalizimi Reciprok”, Qendra për Hulumtime dhe Dëshmi mbi Kërcënimet e Sigurisë, 13 gusht 2018, <https://crestresearch.ac.uk/comment/mcgarry-far-right-reciprocal-radicalisation/>.

Së treti, politizimi i qeverisjes, sidomos edhe në nivel vendor, ku rivaliteti mes partive politike mund të jetë i ndezur dhe ku disa grupe etnike ndonjëherë stigmatizohen, përbëjnë sfida për të ngritur një mekanizëm referimi të drejtuar nga pushteti vendor për adresimin e të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm.<sup>129</sup> Këto sfida janë veçanërisht të vështira në komunitetet me grupe të pakicave etnike.

Shkalla e lartë e politizimit të qeverisjes vendore në disa pjesë të rajonit, me largime të shpeshta të punonjësve të administratës publike pas zgjedhjeve vendore, mund të jetë argument kundër alternativës që mekanizmi i referimit të drejtohet nga komuna/bashkia. Përveç se politizimi i problematikave tashme delikate rrit rrezikun e politizimit të tyre, kjo qasje që mund të varet nga partia politike që është në pushtet në komunë/bashki në një moment të caktuar, mund ta vështirësojë angazhimin afatgjatë të donatorëve dhe financuesve të tjerë potencialë.

Së katërti, ka dallime mes strukturave politike dhe qeverisëse në rajon. Disa kanë sisteme më të decentralizuara ku shumica e burimeve dhe kapaciteteve janë përqendruar në nivel komune/bashkie ose në nivel rajonal, ndërsa vende të tjera kanë sisteme më të centralizuara ku burimet dhe kapacitetet janë të përqendruara në nivel kombëtar. Këto dallime duhen mbajtur parasysht në diskutimet në mbarë Evropën Juglindore nëse dhe si duhet vënë në funksion koncepti i mekanizmit të referimit, sepse theksojnë faktin se nuk ka një zgjidhje shabllon për të gjitha situatat.

Së pesti, në rajon kemi kapacitete të pabarabarta të institucioneve, organizatave dhe strukturave që do të kontribuonin në suksesin e çdo mekanizmi referimi, sidomos ato jashtë agjencive ligjzbatuese. Për shembull, është e kufizuar vetëdija mes punonjësve publikë në fushën e sigurisë se si evidentohen rreziqet dhe dobësitë lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm, pa i hyrë këtu aftësisë së tyre nëse dinë se çfarë duhet bërë në rast se konstatojnë këto rreziqe dhe dobësi. Prandaj, çdo përpjekje për të ngritur një mekanizëm referimi duhet të përfshijë trajnimin e posaçëm të punonjësve, por edhe për shkollat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale dhe kujdesit psikosocial; nga ana tjetër, duhen hartuar protokollet e duhura për trajtimin e rasteve të tilla.

---

129 Roland Gjoni, "Politika etnike në Ballkanin Perëndimor: Situata aktuale dhe mënyrat për të ecur përpara", punim i prezantuar në konferencën e sponsorizuar nga Instituti Aspen, Gjermani, qershor 2016, <http://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/Conference-Reader-Aspen-Durres.pdf>.

Ka mangësi kapacitetesh psikosociale në këtë rajon që ka përjetuar aq shumë konflikte dhe trauma pas konflikteve; ky aspekt mund të meritojë vëmendje parësore, dike ditur që këto trupa mund të intensifikojnë ndjenjën e përjashtimit dhe të marxhinalizimit, e për pasojë shton rreziqet dhe cenueshmërinë ndaj EDhRÇT-së.<sup>130</sup>

Ndoshta një pengesë edhe më e madhe sesa mungesa e ekspertizës për trajtimin e rasteve EDhRÇT është se këto institucione vuajnë nga mungesa kronike e personelit. Duke pasur parasysh se punonjësit aktualë tashmë janë të mbingarkuar me punë, vështirë të imagjinohet ngritja e një mekanizmi referimi pa burime shtesë, siç janë fondet për të mbështetur rekrutimin dhe trajnimin e punonjësit të dedikuar për mbrojtjen sociale që udhëheq nismën e referimit. Përveç mangësive të konstatuara në institucione të veçanta, pjesërisht sepse këto struktura shpesh janë relativisht të reja, koncepti i bashkëpunimit ndërinstitutional që është kyç për një mekanizëm referimi, ende nuk ka zënë vend në rajon.

Po kështu, ende është në zhvillim e sipër kultura e bashkëpunimit mes agjencive dhe institucioneve me mandate të ndryshme dhe që veprojnë në fusha të ndryshme.

Së gjashti, mjaft komplekse në Evropën Juglindore është edhe sfida për të siguruar që mekanizmi i referimit të fokusohet te personat në rrezik apo të cenueshëm ndaj EDhRÇT dhe jo tek ata që shprehin bindje ideologjike, politike ose fetare, që mbrohet nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo vjen kryesisht nga fakti se shoqëritë në rajon po përjetojnë ringjallje të mobilizimit fetar pas gjysmë shekulli komunizëm dhe tradite laike, si dhe vazhdimin të tensioneve ndëretnike dhe fetare. Si rrjedhojë, ka më shumë gjasa që disa profesionistë laikë të perceptojnë gabimisht shprehjet e dukshme fetare (p.sh. shaminë e kokës) ose shfaqjen e besimit fetar si rrezik i shtuar EDhRÇT, duke shtuar kështu rrezikun e diskriminimit ose stigmatizimit gjë që rezulton në numër të lartë rastesh pozitive të rreme. Rrjedhimisht, kjo mund të tkurrë ose të vështirësojë mbështetjen nga institucionet dhe organizatat fetare në rajon për mekanizmin e referimit që trajton rastet EDhRÇT. E gjithë kjo panoramë tregon sa e rëndësishme është që në ngritjen e një mekanizmi të tillë të shmangët perceptimi se po shënjestrohet një komunitet i vetëm, si dhe të mos ndiqet një qasje e ftohtë me listë kontrolli për rreziqet dhe dobësitë, e cila e keqinterpreton shprehjen e besimit fetar, ndërkohë që duhet vërtet të fokusohet tek mirëqenia e individit dhe se si nevojat e tij dhe të komunitetit mund të mbështeten më së miri.

130 Cara Richardson, Katherine M. Berlouis dhe Paul A. Cameron, "Radikalizimi i të rriturve të rinj në vendet e Ballkanit: Kundërmasat, ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe përfshirja e komunitetit", *Revista e çradikalizimit*, nr. 11 (Verë 2017), [https://www.researchgate.net/publication/318039124\\_Radicalisation\\_of\\_Young\\_Adults\\_in\\_the\\_Balkan\\_States\\_Counter-Measures\\_Healthcare\\_Provision\\_and\\_Community\\_Involvement](https://www.researchgate.net/publication/318039124_Radicalisation_of_Young_Adults_in_the_Balkan_States_Counter-Measures_Healthcare_Provision_and_Community_Involvement).

Si faktor i shtatë është mungesa e dakordësisë mes komuniteteve të ndryshme në rajon se çfarë përbën ide dhe sjellje “ekstremiste” apo “radikale”. Për shembull, disa komunitete dhe familjet brenda tyre mund të promovojnë vlera fetare dhe shoqërore konservatore si “hegjemonizmin mashkullor” dhe “të drejtën e burrave për të kontrolluar gratë” që mund të konsiderohen ekstremiste nga individët jashtë komuniteti, por të zakonshme nga pjesëtarët e komunitetit.<sup>131</sup> Si rrjedhojë, mund të jetë e vështirë të trajtosh çështjet EDhRÇT me komunitete të caktuara, pale të kërkosh mbështetjen e tyre për një mekanizëm referimi që trajton mes të tjerash edhe çështjet EDhRÇT.

Prandaj, çdo përpjekje e tillë duhet të bëjë dallimin mes personave që në mënyrë legjitime kanë ide radikale apo ekstremiste por që nuk janë të prirur për dhunë, si dhe atyre që idetë ekstremiste i kanë të lidhura me interesin dhe qëllimin për të kryer akte të dhunshme.<sup>132</sup>

Së teti, edhe vetë përpjekjet aktuale për P/KEDhRÇT-në në hasin sfida si p.sh.: fokusi i ngushtë i programeve të P/KEDhRÇT-së në vetëm një formë të saj (ajo që lidhet me islamizmin) dhe ndaj komuniteteve ku perceptohet kërcënimi nga kjo formë EDhRÇT; shterpësia e mekanizmave që mundësojnë bashkëpunim për P/KEDhRÇT-në ndërmjet qeverisë qendrore dhe bashkive, OShC-ve dhe aktorëve të tjerë vendorë; gatishmëria dhe kapacitetet e kufizuara të OShC-ve për t'u angazhuar me çështjet P/KEDhRÇT, me shumë pak mundësi për të punuar posaçërisht me individë (sesa me komunitete); dhe perceptimi në rajon se qasja e donatorëve ndaj P/KEDhRÇT-së orientohet më shumë nga prioritetet e donatorëve sesa nga prioritetet vendore dhe i mungon koherenca.<sup>133</sup>

Mes të tjerash, ky realitet komplikon përpjekjet që mekanizmat e referimit në rajon të shfrytëzojnë programet ekzistuese të P/KEDhRÇT-së dhe të pozicionohen në një ekosistem më të gjerë P/KEDhRÇT.

131 Edina Bećirević, “Kundërvënia dhe parandalimi i ekstremizmit në Bosnjë-Hercegovinë: Mësimet nga përpjekjet ndërkombëtare”, raport i shkurtër i politikave, Ballkani Perëndimor: Forumi për Hulumtime të Ekstremizmit, Këshilli Britanik, shtator 2018, fq. 7, [https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/policy\\_brief\\_bih.pdf](https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/policy_brief_bih.pdf).

132 Vlado Azinović, “Të kuptuarit i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor”, raport rajonal, *Ballkani Perëndimor: Forumi për Hulumtime të Ekstremizmit* (Këshilli Britanik, qershor 2018, fq. 10, [https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/erf\\_report\\_western\\_balkans\\_2018.pdf](https://www.britishcouncil.ba/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf)).

133 Forumi MNE, “Organizatet e shoqërisë civile në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm”.

Si pikë e fundit, çdo përpjekje për të ngritur mekanizma referimi në Evropën Juglindore duhet të ketë parasysh rolin e sfidave strukturore në fushat e mirëqeverisjes, administratës publike dhe ekonomisë – sepse shërbejnë si faktorë shtytës të fuqishëm për EDhRÇT në disa pjesë të rajonit.<sup>134</sup> Në planin afatgjatë, efektiviteti i mekanizmit të referimit ose nismave të tjera që fokusohen në largimin e individëve nga EDhRÇT varet shumë nga përparimi që bëhet në trajtimin e këtyre sfidave strukturore të cilat, nëse mbeten të patrajtuara, do të vazhdojnë të bëjnë disa të rinj në rajon të prekshëm ndaj EDhRÇT. Kjo nënvizon rëndësinë që përpjekjet për mekanizma referimi të shihen si pjesë integrale e një kuadri të plotë që trajton P/KEDhRÇT-në.

---

134 Shih, për shembull, Azinović, "Të kuptuarit i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor" dhe përmbledhja e literaturës për Evropën Juglindore e rrjetit RESOLVE, nëntor 2018, <https://www.resolvenet.org/research/what-we-are-reading/november-2018-western-balkans>.







## 8. Përfundim

Në kontekste të caktuara, mekanizmat shumëdisiplinarë të referimit mund të japin kontribut të rëndësishëm për vënien në funksion të një qasjeje të plotë ndaj P/KEDhRÇT-së që përfshin të gjitha segmentet e shoqërisë. Duke u mbështetur edhe në përvojat përkatëse në hapësirën e OSBE-së, ky Udhëzues është hartuar për të vënë në pah jo vetëm përfitimet nga mekanizmat e referimit, por edhe qasjet e ndryshme për ngritjen e tyre. Gjithashtu, Udhëzuesi shtjellon sfidat që mund të duhet të kapërcehen dhe problematikat që duhet të trajtohen sidomos në Evropën Juglindore. Për më tepër, Udhëzuesi synon t'u vijë në ndihmë politikëbërësve dhe profesionistëve – të cilët mund të jenë të interesuar për të zhvilluar këto programe – që të kuptojnë dhe të zbutin pasojat negative të mundshme.

Siç theksohet shpesh në këtë Udhëzues, nuk ka një model shabllon të zbatueshëm në të gjitha situatat. Megjithatë, nisur nga përvojat relevante në të gjithë hapësirën e OSBE-së, Udhëzuesi shpjegon disa parime themelore të ndërlydhura që duhet të jenë në themel të çdo mekanizmi i tillë. Për shembull:

1. Asnjë mekanizëm nuk duhet të imponohet nga jashtë. Përkundrazi, vendimi për të ngritur mekanizëm referimi dhe modeli i zgjedhur duhet të bazohet në informacionet e marra mes konsultimeve me palët e interesuara vendase, duke pasur parasysh kapacitetet dhe gatishmërinë e institucioneve, organizatave dhe aktorëve që duhet të përfshihen, si dhe të pasqyrojë kontekstin dhe kulturën vendase.
2. Mekanizmi duhet të përmbledhë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm - në vend që të fokusohet ngushtësisht tek EDhRÇT - dhe duhet t'i shohë ato si pjesë e kontekstit të gjerë që përfshin shqetësimet për dhunën si dhe shqetësimet për sigurinë në komunitetin përkatës. Një program me bazë të gjerë ka më shumë gjasa të pranohet nga komunitetet përkatëse, profesionistët dhe praktikantët, sesa një program që fokusohet te vetëm një problematikë EDhRÇT që mund të rezultojë madje stigmatizuese.
3. Çdo mekanizëm referimi duhet të jetë pjesë integrale e përpjekjeve për të vënë në funksion një kuadër të plotë të P/KEDhRÇT-së që përfshin të gjitha segmentet e shoqërisë, i cili nga njëra anë e trajton EDhRÇT-në nën lupën e shëndetit publik duke shkuar përtej modelit që konturohet vetëm brenda agjencive ligjzbatuese, si dhe nga ana tjetër evidenton dëmet që EDhRÇT-ja mund t'i shkaktojë shoqërisë në tërësi. Kjo qasje ofron mundësinë për të hartuar programe shumëqëllimëshe, duke shmangur stigmatizimin dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e sektorit të shëndetit publik, përfshirë profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit socialë – avantazhe këto që nuk i gjen te qasja bazuar në agjencitë ligjzbatuese.

4. Mënyra më efektive dhe më efikase për të ngritur një mekanizëm referimi për P/KEDhRÇT-në është të shfrytëzohen subjektet dhe shërbimet - ku ato ekzistojnë - dhe të riorganizohen në mënyrë holistike, sesa të krijohen mekanizma të rinj nga e para. Strukturat ekzistuese ndërinstucionale apo shumëdisiplinare mund të përshtaten duke brendësuar fokusin ndaj EDhRÇT.
5. Është thelbësore të ndiqet qasje e plotë që përfshin profesionistët dhe praktikantët e fushave të ndryshme, bashkë me punonjësit socialë, punonjësit e shëndetit mendor dhe ata që merren me të rinjtë, me qëllim që të arrihet në vlerësim gjithëpërfshirës të rreziqeve dhe dobësive të individit ndaj EDhRÇT dhe të ofrohen shërbime holistike për trajtimin e tyre.
6. Nevojitet një marrëveshje ose protokoll transparent që mundëson shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim më të gjerë mes agjencie, organizatave, profesionistëve dhe praktikantëve të përfshirë në mekanizëm, duke mbrojtur njëkohësisht jetën private të individit dhe të dhënat personale. Marrëveshja transparente mund të specifikojë qartë edhe rrethanat e kufizuara në të cilat informacioni në një rast individual duhet t'i referohet policisë. Besimi mes praktikantëve dhe profesionistëve nga fusha të ndryshme është thelbësor për funksionimin efektiv të mekanizmit të referimit. Por, besimi mund të krijohet me vështirësi, sidomos kur përfshihet edhe policia. Përveç kësaj, besimi ndërmjet mekanizmit dhe komunitetit është themelor. Në varësi të kontekstit, mund të duhet që përpjekjet për krijim besimi t'i paraprijnë apo të shoqërojnë punën për ngritjen e një mekanizmi referimi.
7. Profesionistët dhe praktikantët e përfshirë në mekanizma duhet të zotërojnë ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar individët në rrezik potencial ose të cenusur ndaj EDhRÇT, të cilëve duhet t'u sigurohen ndërhyrjet e nevojshme për parandalimin/kundërvënien ndaj tyre. Pajisja e praktikantëve me njohuritë e nevojshme mund të kërkojë trajnime dhe masa të tjera që forcojnë kapacitetet në një sërë disiplinash; programet e trajnimit duhet t'u ofrojnë pjesëmarrësve njohuritë për të kuptuar grackat dhe efektet anësore negative të programeve të ideuara dhe të zbatuara keq.
8. Çdo mekanizëm duhet të mbështetet në një plan jodiskriminues, bazuar në të drejtat e njeriut dhe të ndjeshëm ndaj aspektit gjinor, me qëllim identifikimin e individëve që shfaqin shenja objektive të dukshme të sjelljes radikale që çon në dhunë. Ky kuadër, i cili duhet të përfshijë si faktorët e rrezikut ashtu edhe faktorët mbrojtës kryesorë për komunitetin për të cilin synohet, do t'i zvogëlojë gjasat që programi të synojë grupe të caktuara mbi baza fetare apo ideologjike dhe do të ndihmojë në shpërndarjen e përshtatshme të burimeve të kufizuara.

9. Çdo mekanizëm duhet të përmbajë një strategji komunikimi që ndihmon komunitetet përkatëse ta kuptojnë objektin e nismës dhe llojet e rasteve që trajton.
10. Nevojitet një kuadër rigoroz monitorimi dhe vlerësimi, sepse e ndihmon mekanizmin të kuptojë se çfarë ka funksionuar e çfarë jo, ku qëndrojnë mangësitë dhe çfarë mund të përmirësohet. Kuadri rigoroz i monitorimit dhe vlerësimit si edhe një vlerësim i jashtëm periodik dhe i pavarur i mekanizmit do të promovojë ndër të tjera besimin e komunitetit te mekanizmi si dhe garanton se po funksionon në konsistencë me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe kuadret e tjera ligjore dhe të politikave.

Në fund të fundit, krijimi i një mekanizmi referimi duhet të paraprihet nga një proces këshillimor me përfshirjen e palëve të interesuara kyçe në nivel kombëtar dhe vendor, aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, si dhe profesionistët nga organet ligjzbatuese dhe ata që nuk vijnë nga kjo fushë. Procesi nuk duhet të nxitohet: krijimi i mbështetjes së nevojshme shumëdisiplinare dhe shumëpalëshe për një mekanizëm referimi kërkon kohë dhe durim, sidomos edhe nga politikanët, politikëbërësit, praktikantët dhe anëtarët e publikut, të cilët mund të kërkojnë një zgjidhje të shpejtë në kontekstin e kërcënimeve të vazhdueshme të terrorizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Ky Udhëzues synon të kontribuojë në këtë proces dhe nënvizon angazhimin e OSBE-së për të mbështetur qasje gjithëpërfshirëse, të lokalizuara, shumëdisiplinare dhe të bazuara në të drejtat e njeriut ndaj sfidave të ndërlikuara që paraqet EDhRÇT në hapësirën e OSBE-së.

# Shtojcë: Shembuj të qasjeve të ndryshme

## Qasja nga lart-poshtë: Programi “Channel”, Mbretëria e Bashkuar

I nisur në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2012, Channel është një “program mbrojtjeje konfidencial, vullnetar, ndërinstytucional, i cili i mbështet njerëzit e cenusshëm nga radikalizimi” të cilët mund të përfshihen në aktivitete terroriste nëse nuk mbështeten.<sup>135</sup> Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar drejtoi krijimin e “paneleve Channel” në çdo autoritet vendor në Angli dhe Uells. Panelet përbëhen nga përfaqësues të fushave të ndryshme që lidhen me mbrojtjen e popullatës, duke përfshirë shëndetin, arsimin dhe policinë. Këto panele takohen për ta diskutuar mbi natyrën dhe shkallën e cenusshmërisë së individit të referuar. Pas shqyrtimit të kujdesshëm, paneli mund të vendosë se individit nuk ka nevojë për ndihmë, ose i duhet ofruar një “paketë mbështetëse” që mund të përfshijë ndihmë në arsim ose punësim, mbështetje shëndetësore dhe këshillim ideologjik. Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga viti 2012 deri në dhjetor të vitit 2018, programi “Channel” mbështeti me sukses 1 267 persona.<sup>136</sup>

Referimet mund të bëhen *online* në adresë të posaçme e-mail-i, ose nëpërmjet linjës telefonike të dedikuar kundër terrorizmit që menaxhohet nga policia, ku referimi bëhet anonim. Referim mund të bëjë kushdo që ka shqetësime rreth individëve që mund të jenë tërhiqen drejt terrorizmit nga të preکشëm për t’u përfshirë në terrorizëm. Shumica e referimeve bëhen nga shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore, policia dhe institucionet arsimore, si për shembull shkollat. Në vitin 2015, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar vendosi një detyrim ligjor (i ashtuquajtur “detyrimi i parandalimit”) për mësimdhënësit dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor për të evidentuar të gjithë nxënësit dhe fëmijët që mund të jenë të cenusshëm nga radikalizimi dhe për t’i referuar pranë autoriteteve vendore.

<sup>135</sup> Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, *Programi “Channel”*.

<sup>136</sup> Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, “Skeda e të dhënave: Statistika për programet Prevent dhe Channel 2017/2018”, 13 dhjetor 2018, <https://homeofficemedial.blog.gov.uk/2018/12/13/factsheet-prevent-and-channel-statistics-2017-2018/>.

## Qasja nga lart-poshtë: Parandalimi i radikalizimit dhe njësitë e mbështetjes familjare, Francë

Sipas Planit Kombëtar për Parandalimin e Radikalizimit të shkurtit të vitit 2018, çdo distrikt (ose prefekturë) francez ka ngritur një strukturë parandaluese ndërinstitucionale që i përfshin njësitë territoriale të ministrive të arsimit, drejtësisë (mbrojtjes gjyqësore të të rinjve), shëndetësisë dhe të rinisë, të cilat pastaj krijojnë partneritete me shoqatat dhe OJF-të vendore, profesionistët e shëndetit mendor dhe mësimdhënësit për të ofruar mbështetje të përshtatur për individët e referuar nga policia e të tjerë për shfaqje shenjash të dukshme të radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Qasja synon përfshirjen e anëtarëve të familjes në proces sa më herët të jetë e mundur. Përfshirja e policisë kufizohet zakonisht vetëm te referimet që i përcjellë njësisë.<sup>137</sup>

## Futja e P/KEDhRÇT-së në një mekanizëm ekzistues: Shtëpitë e Sigurisë, Holandë

Secila nga 25 zonat e sigurisë kombëtare në Holandë drejtojnë “shtëpi të sigurisë” ku përfaqësuesit e pushtetit vendor (përfshirë ata të ndihmës sociale dhe të agjencive të strehimit), punonjësit që merren me të rinjtë dhe policia, mund të ulen në të njëjtën tryezë dhe të diskutojnë çështjet komplekse që përfshijnë individë që ua kanë tërhequr vëmendjen (kryesisht për shkak të “familjeve me shumë probleme, krimin dhe/ose shkeljeve të rënda”<sup>138</sup>) dhe të cilët kanë nevojë për mbështetje nga një ekip shumëpalësh në gjendje t’i vlerësojë dobësitë e tyre dhe të përgatisë një plan trajtimi. Çdo shtëpi e sigurisë zakonisht gjendet brenda një bashkie në zonën përkatëse të sigurisë. Edhe pse shtëpitë drejtohen dhe administrohen në nivel vendor, në diskutimin e rasteve specifike mund të marrin pjesë edhe autoritete kombëtare, duke përfshirë organet e ligjzbatuese dhe shërbimet informative, kur marrin ftesë nga drejtuesit vendorë.

Policia është e pranishme për ta përcjellë informacionin tek autoritetet përkatëse nëse një individ i referuar në shtëpinë e sigurisë paraqet kërcënim për sigurinë kombëtare. Roli i kufizuar i policisë lehtëson marrëdhëniet e ngushta me komunitetet fetare, drejtuesit e komunitetit dhe qendrat rinore.

137 Për detajet e kësaj qasjeje, shih “Katalogu i Programit për Luftëtarët e Huaj të Terrorizmit: Krijimi i strukturave administrative vendore përgjegjëse për radikalizimin”, në ueb-faqen Hedayah, <http://www.hedayahcenter.org/ftfprograms/program/creation-of-local-administrative-structures-in-charge-of-radicalization/>.

138 *Shtëpitë e Sigurisë*, film i animuar, Ministria e Sigurisë dhe Drejtësisë, Holandë, [https://www.veiligheidshuizen.nl/nieuws/2016/120516\\_engelse-versie-animatiefilm-veiligheidshuizen#.W\\_1mZfZFw2x](https://www.veiligheidshuizen.nl/nieuws/2016/120516_engelse-versie-animatiefilm-veiligheidshuizen#.W_1mZfZFw2x).

Çdo shtëpi e sigurisë ka marrëveshje ligjore të nënshkruar me agjencitë pjesëmarrëse që u mundëson të shkëmbejnë informacione për personat që shfaqin problematika, duke kapërcyer kështu barrierat tradicionale për shkëmbimin e informacionit mes profesionistëve që nuk vijnë nga organet ligjzbatuese dhe policisë.

Edhe pse shtëpitë e sigurisë fillimisht nuk ishin të ideuara ose të pajisura që të trajtonin raste EDhRÇT, në vitin 2014, katër qytete kërkuan që shtëpitë e sigurisë në zonën e tyre të pranojnë raste individësh të identifikuar se janë në fazë të hershme të radikalizimit drejt dhunës. Koordinatori Kombëtar Holandez për Siguri dhe Kundërterrorizëm ofron udhëzime dhe fonde për ta mbështetur trajtimin e rasteve EDhRÇT në shtëpitë e sigurisë. Kjo qasje shumëdisiplinare dhe e lokalizuar ndaj P/KEDhRÇT-së u theksua në Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit të vitit 2014.

### Qasja ad hoc:

#### Takime shumëdisiplinare për shqyrtimin e rasteve, Holandë

Zyrtarët bashkiakë dhe partnerët vendorë ku mund të bëjnë pjesë prokurorët, policia, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, punëtorë bashkiakë të kujdesit social, zyrtarë të sigurisë dhe punonjësit që merren me të rinjtë, etj., takohen sipas nevojës për të diskutuar për individët që shfaqin shenja të radikalizimit. Në këto takime, ata e shqyrtojnë informacionin që kanë mbi personin dhe hartojnë plane të përshtatura veprimi për ta parandaluar radikalizimin e mundshëm të mëtejshëm. Paketa e përshtatur e ndërhyrjeve në planet e tilla mund të përfshijë një kombinim të masave parandaluese, të drejtësisë penale dhe të integritit shoqëror. Takimet për shqyrtimin e rasteve janë një mënyrë për të siguruar bashkëpunim efektiv dhe shkëmbim të njohurive në një mjedis ku partnerët mund të bashkohen për të bërë plane brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre dhe në kuadër të udhëzimeve të komunës. Qëllimi i mjedisit shumëdisiplinar është të mundësojë sintetizimin e njohurive dhe të ekspertizës përkatëse. Këto takime për shqyrtimin e rasteve zakonisht mbahen vetëm në zonat e sigurisë ku shtëpia e sigurisë nuk është e pajisur ose ngurron për t'i trajtuar rastet e radikalizimit.<sup>139</sup>

<sup>139</sup> Për hollësi të kësaj qasjeje, shih *Koordinatori kombëtar për Siguri dhe Kundërterrorizëm* (KKSKT), Qeveria e Holandës, Strategjia kombëtare kundër terrorizmit për periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2020, fq. 14, [https://english.nctv/binaries/LR\\_100495\\_rapportage\\_EN\\_V3\\_tcm32-251878.pdf](https://english.nctv/binaries/LR_100495_rapportage_EN_V3_tcm32-251878.pdf).



## Qasja nga poshtë-lart: Gjilan, Kosovë

I krijuar në vitin 2016, mekanizmi i referimit të P/KEDh në Gjilan të Kosovës,<sup>140</sup> është pjesë e përpjekjes së drejtuar nga komuna për t'i parandaluar largimin kryesisht të të rinjve drejt zonave të konfliktit në Irak dhe Siri.<sup>141</sup> Mekanizmi administrohet nga zyra e kryetarit të komunës dhe ka 15 anëtarë që vijnë nga institucione të ndryshme vendore, duke përfshirë policinë, arsimin, punën sociale, spitalet dhe çështjet fetare. Në varësi të natyrës së rastit, mekanizmi pranon referime nga anëtarët dhe familjet e komunitetit dhe krijon një grup prej dy deri në tre anëtarë për të punuar në secilin rast. Anëtarët e mekanizmit nuk mund të flasin publikisht për rastet dhe as t'i diskutojnë ato me kolegët e tyre. Sipas drejtuesve të programit, janë trajtuar dhjetë raste që nga viti 2018, ku pothuajse të gjithë personat janë larguar nga rruga e ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, mekanizmi është në fazë fillestare dhe me burime të kufizuara për ndërhyrje dhe paketa mbështetëse të gjera.<sup>142</sup>

## Qasja hibride: Rrjeti i këshillimit rreth radikalizimit, Gjermani

Zyra Federale e Migracionit dhe e Refugjatëve në Gjermani në vitin 2011 krijoi një linjë telefonike kombëtare për radikalizimin.<sup>143</sup> Linja telefonike e dedikuar pranon telefonata nga të afërmit dhe personat e tjerë të interesuar dhe ofron vlerësim fillestar para se t'i përcjellë rastet te partnerët joshtetërorë vendorë që kanë ekspertizë në punën me të rinjtë, shërbimin publik, këshillimin dhe parandalimin e dhunës. OJF-të partnere, të cilat përqendrohen në ekstremizmin “fetar”, “islamik” dhe “selefist”, janë të informuar falë përvojës nga programet shumëvjeçare të parandalimit të neo-nazizmit gjerman. OJF-të, duke përfshirë edhe Rrjetin e Parandalimit të Dhunës, kanë edhe linja të tyre të drejtpërdrejta dhe të pavarura telefonike të referimit, që t'i përfshijnë sa më shumë që është e mundur grupet e synuara që janë të prekura, pasi disa familje preferojnë t'i kontaktojnë strukturat qeveritare, ndërsa të tjerat preferojnë të kontaktojnë një organizatë me bazë komunitare.

140 Të gjitha referencat për institucionet e Kosovës, qoftë sa i përket territorit, institucioneve apo popullsisë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

141 Florian Qehaja, Skënder Përteshi dhe Mentor Vrajolli, *Hartëzimi i gjendjes aktuale të përfshirjes Institucionale dhe komunitare në kundërvënien kundër ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë*, Rrjeti për Paqeruajtësit Fetarë dhe Tradicionalë, shkurt 2017, [http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS\\_Needs\\_Assesment\\_final\\_42754.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS_Needs_Assesment_final_42754.pdf).

142 Bazuar në një intervistë me F. Tony Bislimi, Komuna e Gjilanit, 6 nëntor 2018.

143 Për hollësi të këtij programi, shih Hayat-Germany, <https://hayat-deutschland.de/english/>; dhe Rrjeti i Parandalimit të Dhunës <http://www.violence-prevention-network.de/en/about-us>.

Çdo OJF e ndjek qasjen e saj, dhe ky rrjet fleksibël mund t'i shpërndajë rastet në organizatën që është më e përshtatshme, si në aspekt të qasjes ashtu edhe në aspekt të këshilltarit. Pa udhëzime të rrepta për t'i ndjekur, OJF-të që marrin pjesë në rrjet duhet të mbajnë komunikim dhe koordinim të qëndrueshëm për t'i ndarë mësimet e nxjerra dhe për të siguruar se këshilltarët e OJF-ve janë trajnuar në mënyrë adekuate.<sup>144</sup>

### Qasja e drejtuar nga një OJF: Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që çon në Dhunë, Montreal, Kanada

I nisur në vitin 2015, fillimisht si përgjigje ndaj shqetësimeve për shkuarjen e kuebekasve të rinj në Siri dhe Irak, Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që çon në dhunë ka një staf prej 18 psikologësh, punonjësish socialë dhe hulumtuesish që merren me të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm, por përqendrohen në sjelljen që është tregues i rrezikut të dhunës, e jo vetëm në praninë e ideve “radikale”.<sup>145</sup> Linja telefonike 24-orëshe ka pranuar mbi 2 500 thirrje që nga marsi i vitit 2015. Veçanërisht, që nga të sulmi vdekjeprurës me armë në një xhami në qytetin e Kebekut në janar të vitit 2017, Qendra ka regjistruar rritje të madhe në thirrjet për ekstremizmin e të djathtës ekstreme dhe krimet e urrejtjes, dhe ka nisur iniciativa të fokusuara në këto çështje.<sup>146</sup>

Qendra gjithashtu organizon seminare për policët dhe mësimdhënësit e shkollave, dhe ofron këshillim psiko-social për individët e radikalizuar dhe u ndihmon atyre të riintegrohen në shoqëri. Sipas drejtorit të saj, një nga çelësat e suksesit të Qendrës ka qenë të binden familjet se ajo vepron në mënyrë të pavarur nga organet ligjzbatuese dhe nga agjencitë informative, dhe se fokusi i saj është t'i ndihmojë familjet, duke përfshirë edhe prindërit, fëmijët e të cilëve kanë shkuar ose kanë dashur të shkojnë për t'iu bashkuar ISIS-it.<sup>147</sup>

144 Daniel Koehler, “Përdorimi i këshillimit familjar për parandalimin dhe ndërhyrjen kundër luftëtarëve të huaj: Perspektivat operacionale, metodologjia dhe praktikat më të mira për zbatimin e kodeve të sjelljes” (Instituti i Lindjes së Mesme, 2016), <http://www.mei.edu/sites/default/files/Koehler.pdf>.

145 Qendra për Parandalimin e Radikalizimit që Çon në Dhunë, *Raporti vjetor: Parandalimi i radikalizimit që çon në dhunë*. Shih gjithashtu ueb-faqen e qendrës, <https://info-radical.org/en/cprlv/approach/>.

146 “Qendra kundër radikalizimit regjistron rritje të madhe në thirrjet për të djathtës ekstreme, krimet e urrejtjes”, CJAD News Talk Radio, 4 dhjetor 2016, <http://www.iheartradio.ca/cjad/news/anti-radicalization-centre-sees-spike-in-calls-linked-to-the-far-right-hate-crimes-1.2247204>; dhe Kate McKenna, “Me përjashtimin e mundësisë për financim vendor, Qendra kundër radikalizimit shqyrton mundësinë për të hapur zyrë në qytetin e Kuebekut”, CBC News, 23 korrik 2017, <https://www.cbc.ca/news/canada/montreal/deradicalization-centre-quebec-city-funding-1.4217375>

147 Catherine Solyom, “Sheffa e Qendrës së re për parandalimin e radikalizimit zotohet për pavarësi nga policia”, Montreal Gazette, 14 korrik 2015, <http://montrealgazette.com/news/local-news/head-of-new-radicalization-prevention-centre-vows-independence-from-police>. Rastet mund t'i referohen policisë vetëm në rrethana të kufizuara dhe të përcaktuara qartë. Njëzet e katër raste të tilla u referuan në vitin 2017.

## Qasje vendore e drejtuar nga organi ligjzbatues: Aarhus, Danimarkë

Programi Aarhus, sikurse qasja në bashkitë e tjera daneze, merret me të gjitha llojet e ekstremizmit dhe të radikalizimit të dhunshëm dhe bazohet në bashkëpunimin sistematik të shumë agjencive që ka evoluar brenda më shumë se një dekade midis ofruesve të shërbimeve të ndryshme sociale, sistemit arsimor, sistemit të kujdesit shëndetësor, policisë, shërbimeve të fshehta informative dhe të sigurisë. Policia vendore është agjencia që drejton zbatimin e programit edhe pse programi përfshin bashkëpunim midis qytetit dhe policisë.

Programi fokusohet si te komuniteti, ashtu edhe te individi. Sa i përket të parit, gjegjësisht komunitetit, programi e ngrit vetëdijen në mesin e publikut dhe profesionistëve që nuk janë nga organet ligjzbatuese dhe institucioneve lidhur me atë se si të identifikohen shenjat e radikalizimit drejt dhunës dhe përpiqet ta thellojë bashkëpunimin me komunitetet vendore rreth çështjeve të radikalizimit. Në nivelin individual, ai e vlerëson rrezikun e individëve, e këshillon stafin profesional dhe familjet se si të merren me rastet e radikalizimit, i mentoron individët që konsiderohen në rrezik nga radikalizimi ose që tashmë janë të përfshirë në ekstremizmin e dhunshëm, dhe ofron programe këshillimi dhe “programe dalje” për ata që mendojnë të shkojnë në Irak apo Siri. Pjesëmarrja është plotësisht fakultative.

Në qendër të qasjes Aarhus dhe të qasjes më të gjerë daneze është struktura e “shtëpive të informacionit”: korniza për bashkëpunim vendor mes policisë, administratave komunale të shërbimeve sociale dhe ofruesve të këtyre shërbimeve, dhe Qendrës Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit. Këto korniza ekzistojnë në të gjitha 12 rrethet e policisë daneze. Shtëpitë e informacionit i vlerësojnë shqetësimet rreth radikalizimit dhe ekstremizmit që mund të vijnë nga agjencitë, shërbimet, profesionistët ose civilët; e koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë; dhe i referohen mbështetjes parandaluese të ofruar nga policia ose komuna që është e projektuar posaçërisht për këtë qëllim ose që janë zhvilluar për qëllime të tjera ose për qëllime të përgjithshme.<sup>148</sup>

148 Ramboll (për Ministrinë Daneze të Imigracionit dhe Integritit, *Përpjekjet për ta parandaluar ekstremizmin në vendet nordike*, dhjetor 2017, fq. 15, <http://uim.dk/publikationer/efforts-to-prevent-extremism-in-the-nordic-countries/@@download/publication>.

### Qasja e drejtuar nga bashkia: Bordo, Francë

Qendra për Veprim dhe Parandalim kundër Radikalizimit të Individëve (CAPRI) është një partneritet midis qytetit të Bordosë dhe federatës myslimane vendore. Ajo bashkon një grup të vogël terapistësh, psikiatristh, ekspertësh ligjorë dhe imamësh për të siguruar një qasje shumëdisiplinare ndaj radikalizimit islamik.

Çdo anëtar i komunitetit mund ta referojë ndonjë individ të programi në rast se ka shqetësim për radikalizim drejt dhunës. Ekipi shumëdisiplinar e shqyrton çdo rast në mënyrë konfidenciale për ta përcaktuar trajtimin adekuat, nëse ka nevojë. Trajtimi mund të përfshijë terapi ose seanca këshillimi fetar, shpesh me anëtarët e familjes përkatëse. Pjesëmarrja është vullnetare dhe CAPRI nuk i trajton individët “thellësisht të radikalizuar”, të cilët zakonisht referohen në sistemin e drejtësisë penale.<sup>149</sup>

### Qasja rajonale: Federata e Valonisë-Bruksel, Belgjikë<sup>150</sup>

Rrjeti kundër radikalizimit, i cili e përfshin Qendrën për Ndihmë dhe Kujdes ndaj të gjithë Personave të Prekshëm nga Ekstremizmi dhe Radikalizimi i Dhunshëm dhe Qendrën për Burime dhe Mbështetje, ofron mbështetje për qytetarët dhe profesionistët në rajonet frankofone të Belgjikës në parandalimin e dhunës, ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm. Rrjeti i pranon referimet individuale, edhe ato që vijnë përmes linjës së saj të drejtpërdrejtë telefonike, dhe përpiqet të nisë një proces të shkëputjes; gjithashtu zhvillon dhe siguron mjete për OJF-të, shkollat dhe institucionet e tjera që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë e prekshëm dhe popullatën më gjerë.

“Nëpunës për referim të radikalizimit” që punojnë me orar të plotë në një numër qytetesh në të gjithë rajonin, janë përgjegjës për vlerësimin, diagnostikimin dhe këshillimin e njerëzve që kanë vështirësi në sjellje dhe vështirësi emocionale që mund të lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm.<sup>151</sup>

149 Qendra për Veprim dhe Parandalim kundër Radikalizimit të Individëve (CAPRI), <http://radicalisation.fr/>.

150 Federata e Valonisë - Bruksel, “Parandalimi i Radikalizimit të Dhunshëm dhe Ekstremizmit në Komunitetin Frankofon në Belgjikë”, 2018, <https://extremismes-violents.cfwb.be/>.

151 Observatori Ndërkombëtar i Kryetarëve të Komunave, “Protokolli për Parandalimin e Radikalizimit”, <https://observatoirevivreensemble.org/en/protocol-for-the-prevention-of-radicalization>.

## Qasje që fokusohet vetëm te EDhRÇT: ReDirect, Kanada

ReDirect punon, përmes edukimit, vetëdijesimit, parandalimit dhe ndërhyrjes, për t'i parandaluar të rinjtë dhe të rriturit e rinj në Kalgari nga radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm.<sup>152</sup> Është një partneritet midis Shërbimit të Komunitetit dhe të Fqinjësisë të Qytetit Kalgari, Shërbimit policor të Kalgarit (ShPK), dhe partnerëve të tjerë profesionalë. Strategjitë e programit ReDirect shtrihen nga edukimi mbi rreziqet e radikalizimit deri te ndihma për individët për t'u larguar nga grupet radikale, ku tentohet të arrihen qëllimet gjithëpërfshirëse, gjegjësisht të trajtohen shtytësit themelorë të sjelljes së tyre potencialisht të dhunshme dhe të mbahen individët jashtë sistemit të drejtësisë penale.

ReDirect mbështetet në programet shumëvjeçare të Shërbimit policor të Kalgarit, që kanë të bëjnë me dhunën e bandave, mbështetjen e të rinjve dhe policimin në komunitet. Programi filloi kur udhëheqësit vendorë islamikë kërkuan nga SHPK-ja të krijojë një program për t'i trajtuar rastet e mundshme të radikalizimit brenda komunitetit. SHPK-ja përqendrohet në aktivitetet e “shkëputjes”, ku drejtuesit fetarë që janë partnerë në këto aktivitete i trajtojnë të gjitha aspektet “ideologjike”. Referimet trajtohen në mënyrë konfidenciale; informacioni nuk ndahet me organet ligjzbatuese apo me agjencitë informative, përveçse nëse ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për sigurinë publike.

152 Për hollësi në lidhje me këtë qasje, shih Programin ReDirect, “Mësoni se si e ndalim dhunën te të rinjtë përmes programit ReDirect”, <http://redirect.cpsevents.ca/>.

# Bibliografija

Azinović, V. "Understanding Violent Extremism in the Western Balkans." Western Balkans: Extremism Research Forum. 2018.

Bećirević, E. "Countering and Preventing Extremism in BiH: Learning from International Efforts." Western Balkans Extremism Research Forum. 2018.

Bilazarian, T. *Countering Violent Extremism: Lessonson Early Intervention from the United Kingdom's Channel Program*. Program on Extremism at George Washington University. 2016.

Centre for the Prevention of Radicalization to Violence. *Annual Report: Preventing Radicalization Leading to Violence*. 2017.

Challgren, J., T. Kenyon, L. Kervick, S. Scudder, M. Walters, K. Whitehead, J. Connor, and C. R. Flynn. *Countering Violent Extremism: Applying the Public Health Model*. Center for Security Studies, National Security Critical Issues Task Force. 2016.

Choudhury Fink, N., S. Zeiger, and R. Bulai. *A Man's World: Exploring the Roles of Women in Countering Terrorism and Violent Extremism*. Hedayah; Global Center on Cooperative Security. 2016.

City of Copenhagen. "Less Radicalisation through an Effective and Coherent Effort Recommendations of the Expert Group to Prevent Radicalisation". 2015.

Eisenman, D., and L. Flavahan. "Canaries in the Coal Mine: Interpersonal Violence, Gang Violence, and Violent Extremism through a Public Health Prevention Lens." *International Review of Psychiatry* 29, no. 4. 2017.

European Commission, High-Level Commission Expert Group on Radicalisation (HLCEG-R). *Final Report*. 2018.

European Commission Radicalization Awareness Network (RAN). "Common P/ CVE Challenges in the Western Balkans and European Union." 2018.

———. "Risk Assessment around Lone Actors." 2017.

———. "Handbook on How to Set Up a Multi-Agency Structure that Includes the Health and Social Care Sectors?" 2016.

———. “Preventing Radicalisation to Terrorism and Violent Extremism: Approaches and Practices.” 2018.

———. “Protective and Promotive Factors Building Resilience against Violent Radicalization.” 2018.

———. *The RAN Declaration of Good Practices for Engagement with Foreign Fighters for Prevention*. 2014.

Forum MNE. “Civil Society Organisations in Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans—Mapping Report.” 2019.

Gjoni, R. “Ethnic Politics in the Western Balkans: The State of Play and Ways Forward.” Punimi i paraqitur në Institutin Aspen. 2016.

Glazzard, A., and M. Zeuthen. “Violent Extremism.” 2016.

Global Center on Co-operative Security. *Recommendations for the Consideration of the Counter-Terrorism Committee in the Adoption of the 2018 Addendum to the Madrid Guiding Principles*. 2018.

Global Counterterrorism Forum. *Initiative to Address Homegrown Terrorism: Rabat — Washington Good Practices on the Prevention, Detection, Intervention and Response to Homegrown Terrorism*. 2018.

———. *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence: Neuchâtel Memorandum on Good Practices for Juvenile Justice in a Counterterrorism Context*. 2017.

Hemmingsen, Anne-Sophie. *An Introduction to the Danish Approach to Countering and Preventing Extremism and Radicalization*. Danish Institute for International Studies. 2015.

Holmer, G., and P. Bauman. “Taking Stock: Analytic Tools for Understanding and Designing P/CVE Programs.” United States Institute of Peace. 2018.

Idris, I., with A. Abdelaziz. “Women and Violent Extremism: Helpdesk Research Report.” GSDRC. 2017.

Khalil, J., and M. Zeuthen. “Countering Violent Extremism and Risk Reduction: A Guide to Programme Design and Evaluation.” Royal United Services Institute (RUSI), Whitehall Report. 2016.

Koehler, D. *Understanding Deradicalization: Methods, Tools and Programs for Countering Violent Extremism*. Routledge. 2016.

———. “Using Family Counseling to Prevent and Intervene against Foreign Fighters: Operational Perspectives, Methodology and Best Practices for Implementing Codes of Conduct.” Middle East Institute. 2015.

Knudsen, R., “Matja e radikalizmit: Risk Assessment Conceptualisations and Practice in England and Wales.” *Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression*. 2018.

Meines, Marije. *Local Strategy: Elements of an Effective Local Action Plan to Prevent Radicalisation and Violent Extremism*. EU RAN Centre of Excellence. 2017.

McGarry, S. “The Far Right and Reciprocal Radicalisation.” Centre for Research and Evidence on Security Interests. 2018.

National Coordinator for Security and Counterterrorism, Government of the Netherlands. *National Counterterrorism Strategy for 2016 to 2020*. 2016.

Neumann, P., *Countering Violent Extremism and Radicalisation That Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region*. Organization for Security and Co-operation in Europe. 2017.

Organization for Security and Co-operation in Europe. “Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings” (MC.DEC/2/03, 2003).

———. Chairmanship’s Perception Paper. “Recommendations from the 2017 OSCE-wide Counter-Terrorism Conference on ‘Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism.’” 2017.

———. “Declaration on Strengthening OSCE Efforts to Prevent and Counter Terrorism” (MC.DOC/1/16, 2016).

———. “Ministerial Declaration on Preventing and Countering Violent

Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism” (MC.DOC/4/15, 2015).

———. *Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach*. 2014.

———. “The Chairmanship Interlaken Recommendations.” 2014.

Organization for Security and Co-operation in Europe, and OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights. *Referral Mechanisms—Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook*. 2004.



Ottis, P. “The Promises and Limitations of Using Municipal Community Policing Programs to Counter Violent Extremism: Calgary’s Re-Direct as a Case Study.” Master’s thesis, Norwegian University of Life Sciences. 2016.

Prevention Project, and Royal United Services Institute. *A Roadmap to Progress: The State of the Global P/CVE Agenda*. 2018.

Qehaja, F., S. Perteshi, and M. Vrajolli. *Mapping the State of Play of Institutional and Community Involvement in Countering Violent Extremism in Kosovo*. Kosovo Center for Security Studies. 2017.

Ramboll, and Danish Ministry of Immigration and Integration. *Efforts to Prevent Extremism in the Nordic Countries: Mapping*. Danish Ministry of Immigration and Integration. 2017.

Roelen, K., S. Long, and J. Edström. *Pathways to Protection—Referral Mechanisms and Case Management for Vulnerable Children in Eastern and Southern Africa: Lessons Learned and Ways Forward*. Institute of Developmental Studies Centre for Social Protection. 2012.

Rosand E. “Multi-Disciplinary & Multi-Agency Approaches to Preventing & Countering Violent Extremism: An Emerging P/CVE Success Story?” In *Global Terrorism Index 2017: Measuring and Understanding the Impact of Terrorism*. 2018.

Royal United Services Institute, and CIVIPOL. *European Commission, EU Operational Guidelines on the Preparation and Implementation of EU Financed Actions Specific to Countering Terrorism and Violent Extremism in Third Countries*. 2017.

RTI International. *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: The Application of Risk Assessment Tools in the Criminal Justice and Rehabilitation Process*. 2018.

———. “Stakeholder Perceptions of Risk Assessment for Terrorism Prevention.” 2018.

Swedish Defence University. “Preventing and Countering Violent Extremism: An Initial Rapid Evidence Assessment and Analysis Plan Examining Local Authority Action Plans and Programming Elements.” 2016.

United Kingdom Home Office. *Channel Duty Guidance: Protecting Vulnerable People from Being Drawn into Terrorism — Statutory Guidance for Channel Panel Members and Partners of Local Panels*. 2015.

- United Nations Development Programme. *Journey to Extremism in Africa: Drivers, Incentives, and the Tipping Point for Recruitment*. 2017.
- United Nations General Assembly. Seventieth Session. *Plan of Action to Prevent Violent Extremism: Report of the Secretary-General (A/A/70/674)*.
- United Nations Security Council. Resolution 2396 (2017, S/RES2396).
- United Nations Security Council, Counter-Terrorism Committee. *Addendum to the 2015 Madrid Guiding Principles*. 2018.
- United States Agency for Aid and Development (USAID), PEPFAR, and 4Children. “Referral Mechanisms for Children Orphaned or Made Vulnerable by HIV.” 2018.
- University of Maryland, and National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START). “Supporting A Multidisciplinary Approach to Addressing Violent Extremism: What Role Can Mental Health Professionals Play?” 2015.
- Washington Institute for Near East Policy. *Defeating Ideologically Inspired Violent Extremism: A Strategy to Build Strong Communities and Protect the U.S. Homeland*. 2017.
- Weine, S., et al. “Supporting a Multidisciplinary Approach to Violent Extremism: The Integration of Mental Health in Countering Violent Extremism (CVE) and What Law Enforcement Needs to Know.” University of Maryland; National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START). 2015.
- Weine, S., and D. Eisenman. “How Public Health Can Improve Initiatives to Counter Violent Extremism.” University of Maryland National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START). 2016.
- Weine, S., D. Eisenman, D. Glik, J. Kinsler, and C. Polutnik. *Leveraging a Targeted Violence Prevention Program to Prevent Violent Extremism: A Formative Evaluation in Los Angeles*. University of Illinois at Chicago and University of California, Los Angeles. 2015.
- Winterbotham E., and E. Pearson. “Qytete të ndryshme, Tregime të përbashkëta: A Five-Country Study Challenging Assumptions around Muslim Women and CVE Interventions.” *RUSI Journal*. 2016.
- Youth Power, and United States Agency for International Development. “Promising Practices in Engaging Youth in Peace and Security and P/CVE.” 2017.



**Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë**

Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vjenë, Austri  
Tel.: +43 1 514 360

pm@osce.org  
www.osce.org

**Ndiqni OSBE-në**

